



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I EKONOMISË  
DEPARTAMENTI I EKONOMIKSIT



DISERTACION

**PROVIGJIONIMI I HUMBJEVE NGA  
HUATË NË SEKTORIN BANKAR  
SHQIPTAR**

*Në kërkim të gradës shkencore “Doktor”*

**Punoi:**

Elona DUSHKU

**Udhëheqës shkencor:**

Prof. Dr. Dhori KULE

Tiranë, 2016

## **ABSTRAKT**

Kriza e fundit financiare solli edhe njëherë në fokus marrëdhëniet e rëndësishme midis përfitimit të bankave, aktivitetit kreditues, mjaftueshmërisë së kapitalit dhe praktikave të provigjionimit të humbjeve nga huatë. Debati i fundit mbi rolin e politikave makroprudenciale në zvogëlimin e efektit prociklik të huadhënies bankare fokusohet në dy burimet kryesore të saj që janë: rregulloret mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe skemave të provigjionimit të humbjeve nga huatë. Politikat e provigjionimit të humbjeve nga huatë janë politika të rëndësishme për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Qëllimi i këtij punimi është investigimi i faktorëve përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë të bankave në Shqipëri. Për më tepër në material është testuar se si karakteristikat e bankave dhe kriza e fundit financiare kanë ndikuar sjelljen e bankave ndaj provigjionimit të humbjeve nga huatë. Vlerësimet e marra nga metoda e GMM-së (*Generalized Method of Moments*) bazuar në të dhënat tremujore të bankave, për periudhën 2004-2014 tregojnë se skema e provigjionimit të humbjeve nga huatë të bankave në Shqipëri udhëhiqet kryesisht nga komponenti *jo-diskrecionarë* dhe luhatjet ekonomike. Për më tepër është gjetur një rezultat pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm ndërmjet të ardhurave para interesave, taksave dhe provigjioneve dhe provigjionimit të humbjeve nga huatë, duke konfirmuar hipotezën e zbutjes së të ardhurave, i cili zvogëlon deri diku efektin prociklik të bankave. Rezultatet empirike nuk mbështesin hipotezën e manaxhimit të kapitalit dhe hipotezën e fortësisë financiare. Gjithashtu është gjetur se kriza e fundit financiare globale ka ndikuar në prociklikalitetin e provigjionimit të humbjeve nga huatë. Rezultatet empirike tregojnë se skemat e provigjionimit të humbjeve nga huatë në Shqipëri janë *backward-looking* (prapa vepruese), prandaj materiali sugjeron adaptimin e skemave *forward-looking* (largpamëse), të cilat do të jenë më efektive në reduktimin e rrezikut të kredisë.

**Fjalët kyçe:** Provigjionimi i humbjeve nga huatë, Prociklikaliteti, Politikat Makroprudenciale, *GMM Dinamik*.

**Klasifikimi JEL:** C33, G21

## ***ABSTRACT***

The latest financial crisis has brought into focus the important relationships among banks profitability, lending activity, capital adequacy, and provisioning practices. The recent debate over the role of macro prudential policies in reducing the procyclical behavior of bank lending focuses on two fundamental sources of it: capital adequacy regulations and loan loss provisioning system. Loan loss provisions policies are critical to assess the stability of financial system. In this paper we have used a panel of Albanian banks to study the main determinants of loan loss provisions. In addition we have tested how bank characteristics and the latest crisis have affected provisions behavior of the banks. GMM estimations based on quarterly banks data for the period 2004-2014 show that loan loss provisions of banks are drive from *non-discretionary components* and economic fluctuations. Furthermore we find a positive and significant result between earnings before interest, taxes and provisions and loan loss provisions, confirming income smoothing hypothesis, which mitigate the procyclical behavior of the banks. Our estimated results do not support capital management and signaling hypotheses. We also find that global crisis has contributed significantly to the procyclicality of loan loss provisions in Albania. We show evidence that loan loss provisioning model of banks in Albania is backward-looking thus we suggest the use of *forward-looking* provisioning schemes, which will be more effective in the reducing credit risk.

***Key words:*** Loan loss provisions, Pro-cyclicality, Macroprudential Policy, Dynamic GMM.

***JEL Classification:*** C33, G21

## **PËRMBAJTJA**

<i>ABSTRAKT</i> .....	2
<i>ABSTRACT</i> .....	3
Lista e Figurave.....	5
Lista e Tabelave.....	5
Lista e Shkurtimeve.....	6
<b>KAPITULLI 1</b> .....	7
<b>HYRJE</b> .....	7
1.1 Qëllimi i punimit.....	9
1.2 Të dhënat dhe metodologjia kërkimore.....	9
1.3 Përmbledhje e rezultateve.....	10
1.4 Struktura e materialit.....	12
<b>KAPITULLI 2</b> .....	13
<b>VËSHTRIM MBI LITERATURËN</b> .....	13
2.1 Hyrje.....	13
2.2 Literatura teorike.....	17
2.3 Literatura empirike.....	27
2.4 Përcaktimi kontabël i provigjionimit të humbjeve nga huatë.....	36
2.5 Klasifikimi i kredisë dhe provigjionimi në disa vende të Evropës dhe në Shqipëri.....	42
<b>KAPITULLI 3</b> .....	48
<b>METODOLLOJIA, TË DHËNAT DHE REZULTATET EMPIRIKE</b> .....	48
3.1. Metodologjia.....	48
3.2 Fakte të stilizuara mbi sistemin bankar në Shqipëri.....	54
3.3 Rezultatet empirike.....	76
3.3.1. Të Dhënat.....	76
3.3.2. Rezultatet e modelit bazë.....	80
3.3.3. Rezultate të tjera.....	85
3.3.4. Testimi i qendrueshmërisë së rezultateve.....	89
<b>KAPITULLI 4</b> .....	92
<b>KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b> .....	92
Referenca.....	98
Aneks 1.....	107

## Lista e Figurave

Figura 1: Kontributi i sektorit financiar në PBB .....	61
Figura 2: Ecuria e raportit të kredisë ndaj PBB-së .....	61
Figura 3: Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (%).....	66
Figura 4: Kthyeshmëria nga fondet e veta dhe aktivet (%).....	67
Figura 5: Ecuria e pasiveve ndër vite (milion lekë).....	68
Figura 6: Kontributi në rritjen vjetore të pasiveve.....	68
Figura 7: Struktura e depozitave sipas monedhës dhe agjentëve .....	70
Figura 8: Ecuria e aktiveve ndër vite (milion lekë).....	71
Figura 9: Kontributi në rritjen vjetore të aktiveve.....	72
Figura 10: Kredia për ekonominë në milion lekë.....	73
Figura 11: Kontributi në normën vjetore të rritjes së kredisë (%).....	74
Figura 12: Ecuria e kredisë me probleme (%).....	74
Figura 13: Provigjionimi i humbjeve nga huatë si përqindje ndaj kredisë me probleme.....	75
Figura 14: Norma reale tremujore e vjetorizuar e prodhimit të brendshëm bruto.....	77

## Lista e Tabelave

Tabela 1: Vështrim i përgjithshëm i literatures.....	34
Tabela 2: Ekzistenca e sistemeve të klasifikimi të aktiveve.....	43
Tabela 3: Numri i ditëve të vonesave për ta klasifikuar kredisë në kategoritë e mëposhtme.....	44
Tabela 4: Kriteret e klasifikimit të kredisë si kredi të këqija.....	45
Tabela 5: Fondet rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë .....	58
Tabela 6: Peshat e segmenteve të sistemit financiar si përqindje të PBB-së.....	60
Tabela 7: Sistemi bankar në Shqipëri.....	63
Tabela 8: Përqëndrimi dhe konkurrenca.....	64
Tabela 9: Ecuria e numrit të transaksioneve për instrumentat e pagesave të sektorit bankar.....	65
Tabela 10: Statistika përshkruese të treguesve kryesorë.....	78
Tabela 11: Matrica e korrelacionit.....	79
Tabela 12: Testi i rrënjës njësi ( <i>unit root</i> ).....	80
Tabela 13: Përcaktuesit e provigjionimit të humbjeve nga huatë të bankave në Shqipëri.....	81
Tabela 14: Rezultatet e testit Sargan.....	84
Tabela 15: Rezultatet e testit Arellano-Bond të autokorrelacionit.....	85
Tabela 16: Impakti i karakteristikave të bankave në LLP.....	86
Tabela 17: Impakti i krizës financiare në LLP.....	89
Tabela 18: Rezultatet nga tregues alternativë të rritjes ekonomike dhe kapitalit.....	91
Tabela 19: Pikëpamja Makroprudenciale përkundrejt Pikëpamjes Mikroprudenciale.....	107
Tabela 20: Politikat makroprudenciale dhe instrumentat makroprudencialë.....	108
Tabela 21: Përmbledhje e instrumentave makroprudencialë globalë.....	109

## Lista e Shkurtimeve

BCBS	<i>Komiteti i Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare, (Basel Committee on Banking Supervision)</i>
BIS-	<i>Bank for International Settlements,</i>
CG	<i>Credit Growth Ratio</i>
CGFS	<i>Komiteti i Sistemit Global Financiar, (Committee on the Global Financial System)</i>
CTC	<i>Counter Cycle Capital Measures</i>
DP	<i>Dynamic Provisions</i>
DTI	<i>Debt To Income Ratio</i>
EJL	<i>Europa Jug-Lindore</i>
FASB	<i>Financial Accounting Standards Board</i>
FC	<i>Foreign Credit</i>
FMN	<i>Fondi Monetar Ndërkombëtar</i>
FSB	<i>Bordi i Stabilitetit Financiar (Financial Stability Board)</i>
GMM	<i>Generalized Method of Moments</i>
IAS	<i>International Accounting Standards</i>
IASB	<i>International Accounting Standards Board</i>
IFRS	<i>International Financial Reporting Standards</i>
Instat	<i>Instituti i Statistikës</i>
IRB	<i>Internal Ratings Based Approach</i>
LTV	<i>Loan To Value Ratio</i>
LLP	<i>Provigjionimi i Humbjeve Nga Huatë</i>
OECD <i>Development</i>	<i>The Organisation for Economic Co-operation and Development</i>
PBB	<i>Prodhimi i Brendshëm Bruto</i>
RR	<i>Reserve Requirements</i>

## KAPITULLI 1

### HYRJE

---

Kriza e fundit financiare solli edhe njëherë në vëmendje se si kreditimi mund të rëndojë akoma edhe më shumë ciklin e biznesit të ekonomisë duke shkaktuar paqëndrueshmëri të sistemit financiar (Bouvatier dhe Lepetit, 2008). Kjo pasi bankat e nënvlerësojnë rrezikun e kredisë gjatë periudhave të rritjes ekonomike dhe e mbivlerësojnë atë gjatë periudhave të rënies ekonomike (Borio et al, 2001).

Periudhat me rritje pozitive ekonomike karakterizohen nga norma të larta të rritjes së kredisë, rritje të vlerës së kolateralit, një ulje të diferencave të normave të interesit, si dhe nivel më të ulët të kapitalit dhe të provigjioneve. Ndërsa, gjatë periudhave të rënies ekonomike, ku rreziku dhe mos kthimi i kredisë është në nivele të larta, bankat fillojnë të bëhen më agresive dhe fillojnë të shtrëngojnë kushtet e dhënies së kredisë. Veprime këto që ndikojnë në ofertën e kredisë në ekonomi, në thellimin e mëtejshëm të krizës ekonomike dhe në paqëndrueshmëri financiare.

Kjo natyrë prociklike e sistemit financiar bëri thirrje për ndryshime të rëndësishme rregullative, të standarteve kontabël të bankave, të praktikave të matjes së rrezikut të kredisë dhe të drejtimit të politikës monetare. Ndryshime këto që kishin si qëllim të vetëm forcimin e sistemit financiar dhe stabilitetin makroekonomik të vendit. Mbas krizës financiare të vitit 2008, midis vendimmarrësve pati një konsensus të gjerë se për të adresuar çështjen e prociklikalitetit të sistemit financiar, për të përmirësuar dhe për të mbrojtur qëndrueshmërinë financiare të vendit, politikat duhet të orientohen drejt politikave makroprudenciale dhe forcimit të mbikqyrjes bankare.

Kështu në 2009, Bordi i Stabilitetit Financiar (*Financial Stability Board*) indentifikoi si prioritet tre politika të rëndësishme makroprudenciale që kishin të bënim me; regjimin e kapitalit të bankave, praktikat e provigjionimit të humbjeve nga huatë, si dhe lidhjen që ekziston midis levës financiare dhe vlerësimit të rrezikut.

Një vështrim i literaturës mbi efektin prociklik të sjelljes së bankave tregon që ajo është e ndarë kryesisht në dy drejtime kryesore. Drejtimi i parë i literaturës, ku

përmendim punën e Ayuso et. al, (2004), Jokippii dhe Milne, (2008), etj, vlerëson impaktin që ka luhatshmëria makroekonomike në nivelin rezervë (*buffer*) të kapitalit të bankave, për të parë nëse rezerva e kapitalit është prociklike me ciklin e biznesit. Kjo nënkupton që bankat janë të detyruara për të plotësuar normat minimale të mjaftueshmërisë së kapitalit për të mbuluar rrezikun e kredisë. Duke qenë se kërkesat për kapital rregullator janë të bazuara tek rreziku, kjo bën që bankat të jenë më *rrezik-averse*. Gjatë periudhave të rënies ekonomike, bankat shfaqin tendencën të rrisin kapitalin dhe të ulin e ofertën së kredisë duke u sjellë kështu në mënyrë prociklike.

Ndërsa, drejtimi i dytë i literaturës analizon faktorët përcaktues të luhatshmërisë së kredisë bankare. Literaturë bazë për të shpjeguar këto luhatje të kredisë është mbështetur kryesisht në punën kërkimore të Bernanke dhe Blider, (1988) dhe Bernanke dhe Gertler, (1995). Këta autorë nëpërmjet zgjerimit të modelit *IS-LM* me tregun e kredisë, analizuan ndërlidhjen midis politikës monetare dhe kredisë bankare, duke theksuar rolin që ka kanali i kredisë për të transmentuar ndryshimet e politikës monetare dhe ndikimin e tij në ekonominë reale. Një tjetër element që ndikon në luhatshmërinë e kredisë ka të bëjë me kanalin e kapitalit të bankave, ku oferta e kredisë ndikohet nga ndryshimet rregullative mbi kërkesën për kapital (Van den Heuvel, 2002).

Ky material investigon një tjetër faktor që ndikon në amplifikimin e sjelljes prociklike të bankave, që ka të bëjë me provigjionimin e humbjeve nga huatë. Investigimi i faktorëve përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë nga ana tjetër është po aq i rëndësishëm për të studiuar natyrën prociklike të sistemit financiar. Ndër materialet e parë që kanë evidentuar rolin prociklik të provigjionimit të humbjeve nga huatë përmendim ato të Borio dhe Lowe, (2001), Leaven dhe Majnoni, (2003), Cavallo dhe Majnoni, (2001), Bikker dhe Metzmakers, (2005), etj.

Rregullat e provigjionimit dhe manaxhimi i kapitalit janë të lidhura së bashku nëpërmjet rrezikut të kredisë, ku humbjet e pritshme duhet të mbulohen nga provigjionimi i humbjeve nga huatë, ndërsa humbjet e papritura duhet të mbulohen nga kapitali i bankave. Kështu për bankat është shumë e rëndësishme të manaxhojnë provigjionimin e humbjeve nga huatë, në mënyrë që të kundërbalancojnë rritjen e kredive të këqija sidomos gjatë krizave financiare. Një manaxhim i mirë i rrezikut të



kredisë, nënkupton një sistem provigjionimi të tillë që të parandalojë sjelljen prociklike të rrezikut të kredisë me ciklin e biznesit.

Funksioni kryesor i provigjionimit të humbjeve nga huatë është që të mbulojë humbjet e pritshme, por nga ana tjetër ato janë një mjet i rëndësishëm për të përmbushur edhe objektiva të tjera manaxheriale si: zbutja e të ardhurave (*income smoothing*), sinjalizimi (*signaling*) dhe manaxhimi i kapitalit (*capital management*). Këta faktorë së bashku me zhvillimet ekonomike përcaktojnë politikën e provigjionimit të bankave.

### 1.1 Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi kërkimor është investigimi i faktorëve përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë. Një çështje kjo, mjaft e rëndësishme për stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri, si dhe për efektin që provigjionet kanë në fitimin, kapitalin e bankave, si dhe në ofertën e kredisë. Për më tepër është testuar empirikisht nëse provigjionimi i humbjeve nga huatë është përdorur për të zbutur të ardhurat, për të manaxhuar kapitalin apo për të sinjalizuar fortësinë financiare të bankave.

Gjithashtu është testuar se si karakteristikat e bankave ndikojnë në politikat e provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe është parë nëse kriza e fundit financiare e ka ndryshuar apo jo sjelljen e bankave ndaj provigjionimit.

Bazuar në informacionin e deritanishëm ky është ndër punimet e para që investigon politikat e provigjionimit të humbjeve nga huatë në Shqipëri duke aplikuar *Metodën e Përgjithshme të Momenteve, (GMM)*, duke kontribuar nëpërmjet evidencave empirike mbi faktorët përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë. Për më tepër kjo temë ka rëndësi të veçantë për mbikqyrësit bankarë dhe për bankën qendrore, pasi i ndihmon ata për të kuptuar më së miri bilancet e raportuara të bankave, informacionin e mbartur prej tyre, si dhe politikat prociklike apo kundërciklike të tyre.

### 1.2 Të dhënat dhe metodologjia kërkimore

Vlerësimi i faktorëve përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë për bankat në Shqipëri është bazuar në modelin e propozuar nga Bouvatier dhe Lepetit (2008) dhe Packer dhe Zhu (2012). Të dhënat për bankat individuale janë marrë nga Banka e

Shqipërisë, ndërsa të dhënat makroekonomike janë marrë nga Instat. Periudha e vlerësimit është 2004-2014.

Me qëllim ekzaminimin e faktorëve përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë në këtë material janë përdorur të dhënat individuale të 15 bankave, që përfaqësojnë 90 % e totalit të aktiveve të sistemit bankar në Shqipëri. Gjithashtu ky material është ndër studimet e para, që duke përdorur *Metodën e Përgjithshme të Momenteve (Generalized Method of Moments, GMM)*, të Arellano and Bond (1991) vlerëson politikën e provigjionimit të bankave në Shqipëri, duke kontribuar edhe në vlerësimet empirike për një vend të Europës Jug-Lindore. *Metoda e Përgjithshme e Momenteve* ose *GMM* është një vlerësim alternativ i të dhënave në panel dhe më efiçente se metodat e tjera, kur modeli vuan nga heteroskedasticiteti dhe nga korrelacioni serial. Për më tepër, metoda e *GMM*-së për të dhënat në panel, është me efektive se modelet me efekte fikse dhe rastësore (*random*), në rastin kur nuk plotësohet në mënyrë rigoroze supozimi i të dhënave ekzogjene.

### 1.3 Përmbledhje e rezultateve

Rezultatet empirike tregojnë se sistemi i provigjionimit të humbjeve nga huatë i bankave në Shqipëri është prociklik, që do të thotë se një rritje e nivelit të provigjionimit gjatë periudhave të rënies ekonomike mund të sjellë një ulje të konsiderueshme të ofertës së kredisë, e cila ndikon në rënien e mëtejshme të rritjes ekonomike. Vlerësimet e marra konfirmojnë se sjellja e provigjionimit të humbjeve nga huatë e bankave udhëhiqet më së shumti nga faktori makroekonomik dhe *komponenti jo-diskrecionarë*.

Në linjë me pritshmëritë teorike është gjetur një lidhje pozitive dhe statistikisht e rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë me normën e kredive me probleme ndaj totalit të kredisë dhe me diferencën e normës së kredisë me probleme. Ky rezultat tregon që bankat në Shqipëri rrisin më shumë provigjionet kur kanë një rrezik të lartë aktual dhe të pritshëm të kredisë. Për më tepër është gjetur një lidhje pozitive dhe statistikisht e rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë me raportin e kredive ndaj totalit të aktiveve, që tregon për disa elementë *forward-looking* (largpamës) të sjelljes së bankave në lidhje me provigjionimin e humbjeve nga huatë.

Në material është ekzaminuar nëse bankat i kanë përdorur provigjionet si mjet për të realizuar objektivat e tyre manaxheriale. Evidencat empirike tregojnë për një lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe fitimit para taksave, interesave dhe provigjioneve. Ky rezultat tregon se bankat kanë rritur më shumë provigjionet kur kanë patur fitime të larta, si dhe kanë krijuar më pak provigjione kur fitimet e tyre para taksave, interesave, taksave dhe provigjioneve kanë qenë të ulta. Rezultat ky që konfirmon që bankat në Shqipëri kanë bërë zbutje të të ardhurave (ose *income smoothing*), pra ato kanë përdorur provigjionimin e humbjeve nga huatë, LLP si një mjet për të manaxhuar fitimet. Ndërkohë, që rezultatet empirike nuk konfirmojnë se provigjionimi i humbjeve nga huatë është përdorur si mjet për të manaxhuar kapitalin apo për të sinjalizuar fortësinë financiare të bankave.

Në linjë me pritshmërinë teorike është gjetur një lidhje negative dhe statistikisht e rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve dhe huasë dhe normës reale të rritjes së PBB-së, duke konfirmuar ekzistencën e ciklikitetit të sjelljes së provigjioneve me ciklin e biznesit. Ky rezultat konfirmon që politikat aktuale të provigjionimi të humbjeve nga huatë janë *backward-looking* (prapa-vepruese), pra bankat në Shqipëri nuk duket se kanë krijuar rezerva të mjaftueshme gjatë pikave të larta të ciklit ekonomik.

Për më tepër është testuar edhe se si karakteristikat e bankave ndikojnë në sjelljen e bankave ndaj provigjionimit, duke gjetur se bankat e mëdha mbajnë një nivel më të ulët provigjionesh se bankat e vogla. Bankat e mëdha më së shumti i kanë përdorur provigjionet për të zbutur të ardhurat se sa për të zvogëluar prociklikalitetin e tyre në lidhje me ciklin e biznesit. Ndërsa, në lidhje me bankat e mirë-kapitalizuara është gjetur se ato sillen në mënyrë kundërciklike dhe nuk kanë bërë zbutje të të ardhurave.

Në lidhje me impaktin që ka patur kriza financiare, vihet re se bankat gjatë kësaj periudhe kanë krijuar më shumë provigjione se sa para krizës, si dhe nuk kanë bërë as zbutje të të ardhurave dhe as janë sjellje në mënyrë prociklike.

## 1.4 Struktura e materialit

Materiali është organizuar si më poshtë: Kapitulli i dytë paraqet një përshkrim të detajuar të literaturës teorike mbi faktorët përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë. Në vazhdim është paraqitur një përmbledhje e literaturës empirike mbi provigjionimin e humbjeve nga huatë duke paraqitur qëllimin e secilit studim, të dhënat e përdorura, metodologjinë, si dhe rezultatet e marra. Në fund kapitulli vazhdon me një përshkrim të dy përqsjeve kryesore të përcaktimit të provigjionimit të humbjeve nga huatë, duke paraqitur nga ana konceptuale diferencat dhe ngjashmëritë të këtyre përqsjeve.

Në vijim kapitulli i tretë vazhdon me një prezantim të metodologjisë, të të dhënave dhe të rezultateve empirike. Bazuar në literaturën empirike dhe teorike është identifikuar modeli që përcakton faktorët përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë, duke paraqitur në mënyrë të detajuar treguesit e përdorur në model për të shpjeguar provigjionet, si dhe lidhjen teorike që presim midis treguesve. Më pas kapitulli vazhdon me një përshkrim më të detajuar mbi metodën *GMM* dhe të avantazheve të përdorimit të saj. Në kapitull janë pasqyruar edhe zhvillimet e sistemit bankar në Shqipëri duke dhënë një përmbledhje të karakteristikave të përgjithshme të tij. Më pas është vazhduar me paraqitjen e rezultateve të vlerësimeve empirike, si dhe interpretimin e tyre. Kapitulli i katërt konkludon me një përmbledhje të rezultateve dhe të rekomandimeve të nxjerra nga ky punim shkencor.

## KAPITULLI 2

### VËSHTRIM MBI LITERATURËN

---

#### 2.1 Hyrje

Gjatë dekadës së fundit zhvillimet në sistemin financiar kanë luajtur një rol të rëndësishëm në luhatshmërinë ekonomike të vendeve, duke theksuar akoma më shumë natyrën prociklike të sistemit financiar (Borio et al, 2001). Kjo natyrë prociklike e sistemit financiar bëri thirrje për ndryshime të rëndësishme rregullative, ndryshime të standarteve kontabël, ndryshime të praktikave të matjes së rrezikut dhe të drejtimit të politikës monetare me qëllim forcimin e sistemit financiar dhe stabilitetin makroekonomik të vendit. Ndryshime rregullative këto që u kërkuan nga Bordi i Stabilitetit Financiar, (*Financial Stability Board, FSB*) në 2009, të cilët risollën në vëmendje adaptimin e politikave makroprudenciale. Këto politika kishin si qëllim adresimin e natyrës prociklike të sistemit financiar dhe u adaptuan në masë nga shumë vende, si në zhvillim ashtu edhe të zhvilluara.

Borio (2009), ka treguar që termi makroprudencial është një përkufizim i ri për të përmbledhur në fakt një ide që ka ekzistuar që në fund të viteve 1970. Fillimisht është përmendur në një dokument të papublikuar të Komitetit të Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare, (*Basel Committee on Banking Supervision*), si dhe në një dokument të përgatitur nga Banka e Anglisë. Gjatë asaj periudhe termi makroprudencial përdorej kryesisht për të përmbledhur ato rregullore dhe skema të mbikëqyrjes bankare që kishin si fokus kryesisht rrezikun individual të institucione financiare dhe lidhjen e tij me makroekonominë. Fokusimi në fakt vetëm në fuqinë financiare të institucioneve të veçanta cënon një dimension të rëndësishëm të politikave makroprudenciale, atë të detyrës së sigurimit të stabilitetit financiar në tërësi.

Në publik, diskutimi i politikave makroprudenciale u shfaq vetëm në mes të viteve 1980, nga *Bank for International Settlements*, BIS (1986) si një politikë që ka si qëllim dhe të mbështesë “sigurinë dhe shëndetin e sistemit financiar në tërësi, si edhe një mirëfunksionin të mekanizmit të pagesave”. Ndërsa në fillim të viteve 2000, termi i përjasjes makroprudenciale mbi rregullat dhe mbikëqyrjen bankare mori disa inpute

shtesë, ndikuar kryesisht nga fjalimi shumë influencues i Andrew Crockett, Manaxher i Përgjithshëm i BIS në atë kohë.

Më së shumti termi makroprudencial gjen përdorim gjatë krizës së fundit financiare dhe viteve në vazhdim, ku politika makroprudenciale shikohet si një përqsasje që ka si objektiv të vetëm stabilitetin financiar të vendit. Megjithatë duket se akoma nuk ka një konsensus të gjerë për përcaktimin e stabilitetit financiar në vetvete. Dy janë përqsasjet kryesore në lidhje me përkufizimin e stabilitetit financiar. Përqsasja e parë e përkufizon stabilitetin financiar në terma të qëndrueshmërisë të sistemit financiar nga goditjet e jashtme, (Allen dhe Wood, 2006). Ndërsa, përqsasja e dytë e vë theksin tek natyra endogjene e sistemit financiar duke e përshkruar stabilitetin financiar në terma të rezistencës ndaj goditjeve me origjinë, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë sistemit financiar (Borio dhe Drehman, 2009).

Qëllimi i kryesor i politikave makroprudenciale është kufizimi i rreziqeve dhe kostove të krizave sistemike, si dhe veprimi si një forcë kundërbalancues si gjatë periudhave të pikut, ashtu edhe gjatë periudhave të rënies ekonomike, Brunnermeier et al., (2009).

Në 2009, Banka e Anglisë e përcakton politikën makroprudenciale si një politikë që ka për qëllim sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm të ndërmjetësimit financiar, të sistemit të pagesave, të kreditimit, si dhe të shmangë ciklet e ofertës së kredisë dhe të likuiditetit, fenomene këto të shfaqura gjatë krizës së fundit financiare.

Një tjetër përcaktim i qëllimeve të politikës makroprudenciale sipas Borio dhe Drehmann, (2009) është kufizimi i episodeve të stresit financiar në tërësi ose të rrezikut sistematik, të cilat kanë kosto të mëdha makroekonomike. Një përmbledhje e diferencave kryesore që ekzistojnë midis prespektivës makroprudenciale dhe asaj mikroprudenciale të trajtuara kryesisht nga Borio, (2003) është paraqitur në tabelën 19 (Aneks 1).

Në ditët e sotme, përqsasja makroprudenciale i referohet asaj përqsasje që merr në konsideratë jo vetëm sistemin financiar në tërësi, por ka si qëllim dhe kufizimin e kostove makroekonomike të shkaktuar nga episode të krizës financiare. Për më tepër në përqsasjen makroprudenciale, rreziku sistematik trajtohet si një rrezik i varur nga

sjellja kolektive e institucioneve financiare, pra konsiderohet *endogjen*, në kundërshtim me atë që agjentët individuale mendojnë për të.

FSB, BIS dhe FMN, ( nëntor 2011) e kanë përcaktuar politikën makroprudenciale si një: *“politikë që përdor mjetet prudenciale për të kufizuar rrezikun sistemik ose rrezikun e sistemit në tërësi, duke kufizuar rastet e ndërprerjes së ofrimit të shërbimeve kryesore financiare që mund të kenë pasoja të rënda për ekonominë reale duke:*

- *Zvogëluar krijimin e zhbalancimeve financiare dhe efektet e tyre në ekonomi, si dhe krijimin e mbrojtësve të përshtatshme gjatë ngadalësimeve të ardhshme ekonomike.*
- *Identifikimin dhe adresimin e ekspozimeve të përbashkëta, përqëndrimet e rrezikut, lidhjet dhe ndërvarësitë që janë burime të rrezikut të përhapjes dhe të infektimit që mund të kërcënojnë funksionimin e sistemit financiar në tërësi.”*

Në këtë mënyrë përjasja makroprudenciale ka si qëllim të adresojë dy dimensione të rrezikut sistemik: (i) *dimensionin ndërsektorial* dhe (ii) *dimensionin kohor*. *Dimensioni ndërsektorial*, shikon se si rreziku i sistemit financiar shpërndahet në sistemin financiar gjatë një momenti të caktuar në kohë dhe merret kryesisht me ekspozimin e përbashkët (apo të korreluar) të rrezikut midis institucioneve financiare. Këto ekspozime lindin ngaqë institucionet financiare fokusohen në aktive të ngjashme ose për shkak të lidhjeve të ndërmjetme që kanë institucionet midis tyre. Ekspozimet janë të rëndësishme për tu analizuar pasi ata shpjegojnë se përse disa institucione mund të dështojnë së bashku. Çështja kryesore që trajton *dimensioni ndërsektorial* ka të bëjë me reduktimin e rreziqeve të përqëndrimit, të cilët siç e përmendëm edhe më sipër rezulton nga ekspozimet e ngjashme të institucioneve financiare, si dhe nga lidhjet direkte të bilanceve të tyre. Kështu në sajë të *dimensionit ndërsektorial* synohet që të sigurohet një mbrojtje individuale e institucioneve në përputhje me kontributin që kanë ata në rrezikun sistemik. Prandaj është i nevojshëm përcaktimi i një kuadri të kujdesshëm makroprudencial për të kufizuar rrezikun e humbjeve, si një pjesë e rëndësishme e sistemit financiar.

*Dimensioni kohor* ka të bëjë me mënyrën se si rreziku sistemik zhvillohet me kalimin e kohës, i cili mund të amplifikohet nga ndërveprimet brenda sistemit financiar, ashtu edhe nga ndërveprimet e sistemit financiar me ekonominë reale. Kjo është ajo që shumë ekonomistë, si Borio et al (2001), Brunnermeyer et al, (2009) e cilësojnë si prociklikalitet të sistemit financiar, ku në qendër të së cilit qëndron efekti ndërveprues (*feedback effects*) dhe natura endogjene e rrezikut sistemik. Kështu periudhat ekspansioniste (zgjeruese) karakterizohen nga ulje të perceptimit të rrezikut dhe rritje të tolerancës ndaj tij, rritje të kreditimit, nivel më të lartë të likuiditetit në treg, rritje të çmimit të aktiveve dhe një rritje reciproke të shpenzimeve, të cilat çojnë në një rritje të bilanceve të bankave. E kundërta ndodh gjatë periudhave të rënies ekonomike, të cilat karakterizohen nga rritje të presioneve financiare dhe amplifikimit të stresit financiar. Si rezultat, veprimet racionale të agjentëve mund të sjellin një rezultat agregat të padëshiruar duke ndikuar në paqëndrueshmërinë e sistemit financiar në tërësi, shkaktuar nga një reduktim i kreditimit dhe i shërbimeve financiare kryesore. Prandaj si çështje kryesore lind minimizimi apo zvogëlimi i natyrës prociklike të sistemit financiar. Vëmendje e veçantë i kushtohet vënies në përdorim e formave të ndryshme të rezervave (*buffers*), të cilat veprojnë në mënyrë kundërciklike për të kufizuar krijimin e rrezikut sistemik.

Ashtu siç e përmendëm edhe më sipër diskutimi dhe përdorimi i politikave makroprudenciale e ka filluesën shumë më përpara fillimit të krizës së fundit financiare. Vendimmarrësit makroprudencialë kërkojnë që rreziku sistemik të monitorohet në të dyja dimensionet e tij. Kështu që nga fillimi i krizës financiare janë ndërmarra hapa të rëndësishëm për adaptimin e atyre politikave, që kanë për qëllim adresimin e prociklikalitetit të sistemit financiar.

Bordi i Stabilitetit Financiar (*Financial Stability Board*, 2009) e ka adresuar çështjen e prociklikalitetit të sistemit financiar nëpërmjet forcimit të politikave të mbikëqyrjes dhe të orientimit të politikave drejt politikave makroprudenciale. Ndër politikat më të rëndësishme makroprudenciale për të zbutur efektin prociklik të sistemit financiar përmenden: politikat mbi kapitalin e bankave, politikat mbi praktikën e provigjionit të humbjeve nga huatë, si dhe lidhjen midis vlerësimit (*valuation*) dhe levës financiare, (*FSB*, 2009). Një përmbledhje e detajuar mbi politikat makroprudenciale dhe instrumentat e secilës prej tyre është paraqitur në aneksin 1, (Tabela 20 dhe 21).



Në këtë punim duke qenë se trajtohet dimensionin ndërkohor i rrezikut sistemik, më konkretisht praktikën e provigjionimit të humbjeve nga huatë në nënçështjet në vazhdim do të trajtohet përcaktimi nga ana kontabël i provigjionimit të humbjeve nga huatë, si dhe faktorët përcaktues të tyre.

## 2.2 Literatura teorike

Termi “*prociklikalitet*” i referohet ndërveprimeve dinamike midis sektorit financiar dhe real të ekonomisë, të cilat tentojnë të amplifikojnë luhatshmërinë e ciklit të biznesit duke shkaktuar paqëndrueshmëri të sistemit financiar, (FSB, 2009). Kriza e fundit financiare ilustron më së mirë efektet që shkaktoi prociklikaliteti i sistemit financiar, ku institucionet me humbje të mëdha patën vështirësi në rritjen e kapitalit, të cilat nga ana tjetër sollën një ulje të kreditimit dhe shitje të aktiveve. Nga ana tjetër një sistem financiar i dobësuar nuk është në gjendje që të absorbojë humbjet e pritshme, duke bërë që më së shumti ai të veprojë si një amplifikues i goditjeve se sa si absorbues i goditjeve.

Bankat thuhet se sillen në mënyrë prociklike, pasi veprimet e ndërmarra prej tyre tentojnë që të përforcojnë ciklin e biznesit nëpërmjet kreditimit, sistemeve të provigjionimit dhe politikave të vlerësimit të kredive. Gjatë fazave të rritjes ekonomike, sektori bankar është më optimist në lidhje me zhvillimet makroekonomike dhe me gjëndjen financiare të huamarrësve. E kundërta ndodh gjatë periudhave të rënies ekonomike, ku një rënie e aktivitetit ekonomik, rrit pesimizmin për të ardhmen e afërt duke ndikuar menjëherë edhe në sjelljen e bankave. Ato në kushtet e rënies ekonomike, e rëndojnë akoma edhe më shumë situatën duke ulur ndjeshëm kreditimin, që mund të sjellë edhe një stopim të kreditimit ose (*credit crunch*). Për më tepër bankat mund të rrisin shumë provigjionet, duke ndikuar kështu negativisht fitimet e bankave dhe pozicionin e kapitalit të tyre, ku në kushte ekstreme sjellja prociklike e bankave mund të ndikojë në krijimin e një krize gjithë përfshirëse të bankave.

Një ndër faktorët që ndikon në prociklikalitetin e sistemit financiar lidhet me asimetrinë e informacionit midis huadhënësve dhe huamarrësve (Borio et al, 2001). Kështu gjatë fazave të rënies ekonomike, të cilat shoqërohen me kushte të përkeqësuar kreditimi dhe vlera të ulta kolaterali, asimetria e informacionit do të

thotë që edhe huamarrësit me projekte fitimprurëse e kanë të vështirë që të sigurojnë financim. Ndërsa, kur kushtet ekonomike janë të mira dhe vlerat e kolateralit të larta, këto firma janë në gjendje të marrin akoma edhe më shumë financim duke ndikuar në stimulimin e ekonomisë. Ndryshe kjo lidhje midis sektorit real dhe atij financiar njihet si përshpejtuesi financiar “*financial accelerator*” i Bernanke dhe Gertler, (1995).

Një tjetër faktor që ndikon në prociklikalitetin i sistemit financiar lidhet me pamundësinë e përgjigjes së pjesmarrësve të tregut financiar ndaj ndyshimeve në kohë të rrezikut. Ndër arsyt kryesore përmendim jo vetëm vështirësitë në matjen në kohë të rrezikut, por lidhet edhe me agjentët e tregut dhe incentivat e tyre ndaj rrezikut. Vështirësitë në matjen e rrezikut vijnë nga vështirësitë për të parashikuar aktivitetin e përgjithshëm ekonomik si dhe lidhjen e tij me humbjet e kredive, vështirësitë në vlerësimin e korrelacionit midis humbjes së kredisë midis huamarrësve dhe midis institucioneve financiare.

Rreziku është një koncept multi-dimensional, prandaj është e rëndësishme të indentifikohen dimensionet dhe përcaktimet e shumta të tij. E rëndësishme kështu është ndarja midis humbjeve të pritshme dhe humbjeve të papritura, rrezikut relativ dhe rrezikut absolut, rrezikut sistemik dhe rrezikut jo-sistemik apo *idiosyncratic* dhe midis rrezikut të gjithë sistemit financiar dhe rrezikut të portofoleve individuale.

Borio et al, (2001) konfirmojnë se rreziku dhe për më tepër rreziku i kredisë nënvlerësohet gjatë periudhave të rritjes ekonomike dhe mbivlerësohet gjatë periudhave të rënies ekonomike. Ndërsa, gjatë periudhave të rënies ekonomike ku rreziku dhe mos kthimi i kredisë është në nivele të larta, bankat fillojnë të bëhen më agresive dhe fillojnë të shtrëngojnë kushtet e dhënies së kredisë. Kështu vështirësitë në parashikimin e aktivitetit të ardhshëm ekonomik lidhet me atë që ekonomistët e cilësojnë si “*modeli i gabuar*” për të pasqyruar zhvillimet makroekonomike. Disa nga arsyt kryesore që gjenden në literaturë për një mosvlerësim të saktë të rrezikut të kredisë, lidhet me fenomene të njohura si: *Miopia fatkeqe (disaster myopia)*, *sjellja e turmës (herd behaviour)*, *problemi klasik i agjentit (principal agent problem)* dhe *hipoteza e kujtesës institucionale (institutional memory hypotheses)*.

*Disaster myopia* (ose *miopia fatkeqe*) rrjedh si rezultat i mosparashikimit të ngjarjeve që mund të ndodhin në të ardhmen (Guttentag dhe Herring, 1984, 1986). Ngjarja

mund të rezultojë nga ndryshimet në regjimin ekonomik, ndryshimet rregullative ose si rrjedhojë e një fatkeqësie. Nëse manaxherët nuk marrin në konsideratë një ngjarje të tillë të mundshme ato zgjerojnë kreditimin dhe në momentin e ndodhjes së ngjarjes ato reduktojnë ndjeshëm kreditimin.

Një tjetër element që ndikon në mosvlerësim të saktë të rrezikut ka të bëjë me *Herd behaviour* (ose *sjellja e turmës*) (Rajan, 1994). Manaxherët nuk udhëhiqen nga objektiva të qarta dhe afatgjatë, por duke parë sjelljen dhe ecurinë e konkurrentëve të tyre veprojnë në të njëjtën mënyrë. Kjo bën që bankat të gabojnë në vlerësimin e kredisë duke nxitur kreditimin dhe financimin e projekteve që mund të rezultojnë në të ardhmen në projekte me kthim negativ, duke sjellë rritjen e kredive të këqija në periudhat e rënies ekonomike.

Problemi klasik i agjentit (*principal-agent problem*) që rezulton midis aksionerëve dhe manaxherëve të bankës, mund të sjellë një rritje të luhatshmërisë të normës së rritjes së kredisë. Kështu manaxherët udhëhequr nga sjellja e tyre për të siguruar më shumë fitime personale dhe për të rritur influencën e tyre në organizatë ndikojnë në rritjen e kreditimit. Literatura identifikon rastet midis marrjes përsipër të rrezikut dhe stimujve të manaxherëve (Saunders et al, (1990), Gorton dhe Rosen, (1995) dhe Esty (1997)).

Berger dhe Undell (2003) nëpërmjet *hipotezës së kujtesës institucionale* (*institutional memory hypothesis*) tentojnë të shpjegojnë ciklin midis kredisë dhe humbjeve që vijnë nga kreditë e këqija. Në themel të kësaj hipoteze qëndron ideja që sa më shumë kohë të kalojë nga periudha ku ka patur një rënie drastike të kreditimit, aq më pak të aftë bëhen kredidhënësit për të dhënë një kredi me rrezik të ulët. Ndër arsyet kryesore, përmendet marrja e stafit të ri pa eksperiencën e duhur në vlerësimin e rrezikut të kredisë, si dhe humbja e eksperiencës së fituar nga kriza e kaluar nga ana e stafit me më shumë përvojë.

Në këtë material do të analizojmë një tjetër faktor që amplifikon sjelljen prociklike të kredisë së bankave që është sistemi i provigjionimit të humbjeve nga huatë. Shqetësimi në lidhje me impaktin që ka provigjionimi i humbjeve nga huatë në ciklin e kredisë është relevant për debatin mbi sistemet *backward-looking* (prapa-vepruese) të provigjioneve, të cilët amplifikojnë sjelljen ciklike të kredisë bankare. Bordi i

Stabilitetit Financiar (*FSB*) në vitin 2009 thekson se një identifikim i hershëm i humbjeve nga kreditë mund të kishte ulur luhatshmërinë e cikleve gjatë krizës së fundit financiare. Sipas standarteve aktuale të kontabilitetit, një provigjion për kreditë e humbur krijohet në momentin kur ajo kredi identifikohet si e humbur. Identifikimi i një humbjeve është një proces i vështirë dhe subjektiv, që e bën të vështirë identifikimin e humbjeve të kredisë që në fillim të ciklit të kredisë. Gjithashtu mënyrat dhe praktikatat e ndjekura për të përcaktuar humbjet nga huatë duhet të bëhen transparente dhe në kohë për të gjithë përdoruesit e pasqyrave financiare.

Rregullat e provigjionimit dhe kërkesat për kapital janë të lidhura ngushtë nëpërmjet rolit që ato kanë për të mbuluar rrezikun e kredisë, ku supozohet që humbjet e pritshme të mbulohen nga provigjionimi i humbjeve nga huatë, ndërsa humbjet e papritura të mbulohen nga kapitali i bankës (Cavallo dhe Majnoni, 2001). Ndarja ndonjëherë midis kapitalit dhe provigjioneve duket artificiale përsa kohë që së bashku sigurojnë bankat nga humbjet. E rëndësishme është që shuma e kapitalit dhe e provigjioneve të jetë e mjaftueshme për të mbuluar totalin e humbjeve të pritshme dhe të papritura. Nëse bankat mbajnë nivel të ulët të provigjioneve, kjo do të thotë që bankat duhet të mbajnë kapital shtesë të mjaftueshëm për të mbuluar humbjet dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit financiar.

Bouvatier dhe Lepetit, (2008) shprehen që nëse rritja e kreditimit ka një efekt të drejtpërdrejtë në kapital, provigjionimi i humbjeve nga huatë ndikon direkt fitimet e bankave. Kështu që një manaxhimi i mirë i rrezikut të kredisë, nënkupton një sistem provigjionimi të tillë që të parandalojë sjelljen prociklike të tij me ciklin e biznesit.

Literatura ekonomike indentifikon dy komponentë të provigjionimit të humbjeve nga huatë që synojnë të mbulojnë aspekte të ndryshme të tij. Komponenti i parë është ai që quhet *komponenti jo-diskrecionar*, i cili ka për qëllim mbulimin e humbjeve të pritshme të kredisë në portofolin e kredisë së bankës (Whalen, 1994, Beaver dhe Engel, 1996). Ky lloj sistemi provigjionimi është cilësuar të jetë *backward-looking* (prapa vepruese) pasi bankat lidhin sjelljen jo-diskrecionare të provigjioneve kryesisht me humbjet e identifikuara të kredisë. Kështu gjatë periudhave të rritjes ekonomike, numri i kredive të humbura është i ulët duke sjellë që edhe niveli i provigjionimit të humbjeve nga huatë të jetë i ulët. Ndërsa, gjatë periudhave të rënies ekonomike

bankat fillojnë të provigjionojnë më shumë pasi rastet e kredive të humbura janë më të larta.

*Komponenti jo-diskrecionar* udhëheq në këtë mënyrë sjelljen ciklike të provigjionimit të humbjeve nga huatë. Si rezultat, *komponenti jo-diskrecionar* është një forcë udhëheqëse e ciklikalitetit të provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe sjell një vlerësim jo të saktë të humbjeve të pritshme të kredisë. Keeton, (1999) dhe Jimenez dhe Saurina, (2005) kanë treguar që një rritje në normën e rritjes së kredisë gjatë një periudhe ekspansioniste sjell humbje më të mëdha gjatë periudhës së rënies ekonomike, kjo pasi humbjet e kredisë nënvlerësohen gjatë periudhës së rritjes ekonomike dhe mbivlerësohen gjatë periudhave të rënies ekonomike. Ciklikaliteti i provigjionimit të humbjeve nga huatë ndikon direkt fitimet e bankave dhe kapitalin e tyre, duke ndikuar në ciklikalitetin e dhënies së kredisë.

Komponenti i dytë, i quajtur *komponenti diskrecionar* ka të bëjë me atë pjesë të provigjionimit të humbjeve nga huatë që përdoret për objektiva manaxherial. Sipas Liu et. al, (1997), Ahmed et. al, (1999), Lobo dhe Yang, (2001) tre janë objektivat që mund të arrihen nëpërmjet përdorimit të provigjionimit të humbjeve nga huatë: zbutja e luhatshmërisë së të ardhurave (*income smoothing*), hipoteza e manaxhimit të kapitalit (*capital management hypotheses*) dhe sinjalizimi (*signalling*).

*Income smoothing* ose zbutja e luhatshmërisë së të ardhurave, i referohet sjelljes së bankave për të zbutur fitimin e tyre gjatë gjithë kohës, element ky që pritet të jetë kundërciklik. Kështu pritet që bankat të rrisin provigjionet kur gjenerojnë fitime më të larta se zakonisht dhe të ulin ato kur gjenerojnë fitime të ulta. Një sjellje e tillë nënkupton rritjen e provigjionimit të humbjeve nga huatë gjatë periudhave ekspansioniste dhe uljen e tyre gjatë periudhave të rënies ekonomike. Rrjedhimisht pritet që zbutja e fitimeve (*income smoothing behavior*) të ndikojë pozitivisht ofertën e kredisë bankare.

Manaxherët e bankave tentojnë të ulin luhatshmërinë e të ardhurave për të ulur në një mënyrë edhe perceptimin e rrezikut mbi bankat, pasi luhatshmëria e të ardhurave apo fitimeve konsiderohet edhe si një tregues rreziku. Megjithatë kjo sjellje e vështirëson gjithashtu edhe debatin në lidhje me liberalizimin e bankave, pasi zbutja e të

ardhurave mund të ndikojë aftësinë e ligjvënësve, rregullatorëve dhe investitorëve për të ndikuar në efektin e papritur të rrezikut që vijnë nga kompetencat e zgjerimit të bankave. Ndërsa arsye të tjera potenciale se përse bankat tentojnë të zbusin të ardhurat e tyre lidhet me: (1) dividendët dhe kufizimet e kapitalit vendosur nga autoriteti rregullator, (2) teoria e agjensisë dhe (3) teoria e kompesimit.

Pagesat e dividendëve të bankave janë të kufizuara nga fitimet aktuale dhe nga fitimet e realizuara gjatë viteve të fundit. Këto kufizime bëjnë që bankat të mbajnë portofole me rrezik të ulët në mënyrë që të shmangin efektin negativ, që vjen si rezultat i mos shpërndarjes së dividendit. Zbutja e të ardhurave nga ana tjetër bën që bankierët të mbajnë protofole me më rrezik dhe të mbajnë nivelin e dividendëve.

Ashtu si e përmendëm edhe më sipër, teoria e agjensisë sugjeron një tjetër arsye se pse bankat bëjnë zbutje të të ardhurave. Sipas Lambert, (1984) në kushte të caktuara, skema e kompesimit e ofruar nga aksionerët bën që manaxherët e bankave të bëjnë zbutje të të ardhurave kryesisht për shkak të *moral hazard* (rrezikut të moralit) që shoqëron veprimet e pavëzhguara të manaxherëve. Nga ana tjetër, aksionerët zgjedhin që të ofrojnë një plan kompesimi që maksimizon dobinë e tyre.

Arsyeja e tretë se përse bankat bëjnë zbutje të të ardhurave lidhet me teorinë e kompesimit, ku Healy (1985) e lidh sjelljen e manaxherëve për të përfituar bonuse. Nga vlerësimet e tij empirike, Healy (1985) konkludoi që kur fitimet e manaxherëve bien poshtë një kufiri të poshtëm, atëherë manaxherët janë të prirur për të bërë zbutjen e të ardhurave (*income-decreasing discretionary accruals*<sup>1</sup>). Nga ana tjetër kur fitimet ose të ardhurat janë mbi kufirin e sipër, atëherë manaxherët mund të zgjedhin të përdorin axhustimin e të ardhurave (*income-decreasing discretionary accruals*), duke bërë që ato të kursejnë në periudha kur kanë vështirësi. Së fundi, kur të ardhurat bien brenda kufinjve të caktuar, atëherë manaxherët zgjedhin që të rrisin alternativat e rritjes së të ardhurave. Kështu nëse hipoteza e zbutjes së të ardhurave dhe hipoteza e

---

<sup>1</sup>Quhen axhustimet që i bëhen: 1) të ardhurave të cilat janë fituar por që akoma nuk janë pasqyruar në llogari (2) shpenzimeve të cilat kanë ndodhur por që nuk janë akoma pasqyruar në llogari. Llogaritë *accruals* janë llogari që paraqesin detyrime dhe aktive jo monetare bazuar në kontabilitetin e *accruals*. Këto llogari përfshijnë ndër të tjera, llogaritë e pagueshme, llogaritë e arkëtueshmë, detyrimin tatimor të ardhshëm dhe shpenzimet e ardhshme të interesit.

kompesimit parashikojnë që manaxherët do të tentojnë të përdorin axhustimin e të ardhurave (*income-decreasing accruals*) në një vit kur të ardhurat janë jashtëzakonisht të larta, teoria e kompesimit parashikon axhustimin e të ardhurave (*income-decreasing accruals*) kur të ardhurat janë jashtëzakonisht të ulta, në kundërshtim me hipotezën e zbutjes së të ardhurave.

Bankat ose shoqëritë e sigurimeve janë më shumë të prirura për të bërë manipulim të të ardhurave, si për shembull zbutja e të ardhurave për shkak të gjykimeve subjektive të manaxherëve në lidhje me rezervat për humbjet e pritshme, në lidhje me falimentimet bankare apo dhe kreditë e këqija. Sipas Greenawalt dhe Sinkey, (1988) në sistemin bankar, analiza e provigjionimit të humbjeve nga huatë është e rëndësishme, pasi provigjionimi i humbjeve nga huatë ndikon sasinë dhe kohën e fitimeve të raportuara. Ndërsa nga ana tjetër rezerva e provigjionimit të humbjeve nga huatë reflekton gjykimin e pritshëm të manaxherëve për humbjet nga huatë, një tregues bruto i cilësisë së kredisë.

Sipas hipotezës së manaxhimit të të ardhurave, manaxherët tentojnë të reduktojnë luhatshmërinë e të ardhurave të raportuara nëpërmjet veprimeve kontabël. Kështu reduktimi i të ardhurave apo fitimeve realizohet duke zhvendosur disa zëra të ardhurash ose shpenzimesh nga viti në vit, më qëllim që fitimet të jenë më pak të luhatshme. Literatura ekonomike përmend që ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në zbutjen e të ardhurave janë; tregu, rregullat e vendosura apo përqsjet kontabël.

Copeland, (1968) e përshkruan *zbutjen perfekte të të ardhurave* si një veprim që ka këto karakteristika: (1) pasi përdoret njëherë, nuk e detyron firmën të angazhohet në një veprim të ardhshëm të veçantë; (2) përbën një gjykim profesional që i nënshtrohet parimeve kontabël gjerësisht të pranuar; (3) prodhon zhvendosje të zërave në bilanc nga viti në vit ku shfaqen diferenca të të ardhurave; (4) nuk kërkon një transaksion real me një palë tjetër, por vetëm një riorganizim të llogarive të brendshme si dhe (5) mund të përdoret për periudha të njëpasnjëshme.

Kështu sipas Greenawalt dhe Sinkey, (1988) vlerësimet kontabël të humbjeve nga kreditë bankare e plotësojnë këtë kriter, prandaj ato përfaqësojnë një rast interesant

për të testuar hipotezën e zbutjes së të ardhurave. Gjykimi i manaxherëve është baza për të përcaktuar nivelin e kompesimit të humbjeve nga huatë (*allowance for loan losses*), vlerësimin e shumës aktuale të kredisë që nuk do të mblidhet. Provigjionimi i humbjeve nga huatë përfaqëson një detyrim ndaj shpenzimeve operacionale të nevojshme për të mbajtur një nivel të konsiderueshëm të kompesimit të humbjeve nga huatë (*loan loss allowance*). Ndërsa, vlerësimi i shumës të pambledhshme është një proces alokimi brenda firmës. Për më tepër, pjesa *write-off* (e humbur) e kredive të veçanta të pambledhshme është thjesht një riklasifikim i llogarive të bilanceve të firmës se sa rezultat i transaksioneve të tjera. Natyra diskrecionare e procesit të vlerësimit dhe përdorimit të tij gjatë periudhave në vazhdimi i jep manaxherëve mundësinë për të bërë *income-smoothing* ose zbutje të të ardhurave. Një sjellje e tillë mund të shfaqet nëpërmjet rritjes së shpenzimeve të humbjeve nga huatë gjatë periudhave kur fitimet arrijnë vlera maksimale, si dhe uljen e provigjionimit të humbjeve nga huatë ose njohjen në një moment të dytë (ose me vonesë) të pjesës së humbur të kredisë (*write-off*), kur të ardhurat janë në nivele të ulta.

Një vështrim i hershëm i literaturës para ndryshimeve rregullative të viteve 1990, tregon se provigjionimi i humbjeve nga huatë është përdorur si një mjet për të zbutur të ardhurat. Më konkretisht Ma, (1988) ka parë nëse bankat i kanë përdorur provigjionimet e humbjeve nga huatë, si mjet për të ulur luhatshmërinë e fitimeve të bankave. Rezultatet e studimit të tij treguan që provigjionimi i humbjeve nga huatë së bashku me *loan charge-off* (humbjet e kredisë) janë përdorur si mjete për zbutjen e të ardhurave.

Për më tepër Collins et. al., (1995) gjejnë një lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe fitimeve para taksave dhe të ardhurave. Gjithashtu këta autorë gjejnë se provigjionet janë përdorur edhe si mjet për të bërë manaxhimin e kapitalit.

Greenawalt dhe Sinkey, (1988) analizuan nëse provigjionet e humbjeve nga huatë janë përdorur për të zbutur të ardhurat dhe se si karakteristikat e bankave ndikojnë në manaxhimin e të ardhurave. Këta autorë gjejnë që bankat rajonale janë më shumë të angazhuara për të përdorur të ardhurat për zbutjen e tyre përkundrejt bankave të qendrës së parasë (*money-centred banks*).



Ndërsa Bhat, (1996) ka gjetur se bankat më pak të shëndetshme kanë përdorur në mënyrë agresive provigjionimin e humbjeve nga huatë, si mjet për të zbutur të ardhurat përkundrejt bankave të tjera. Studimet e sipër përmenduar janë studime të ndërmarrë para ndryshimeve rregullative të vitit 1990. Ahmed et. al., (1999), në studimin e tyre të ndërmarrë pas ndryshimeve rregullative të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në vitin 1990, nuk e konfirmojnë hipotezën e manaxhimit të të ardhurave.

Dy mënyrat e tjera të përdorimit të provigjionimit të humbjeve nga huatë lidhen me hipotezën e manaxhimit të kapitalit dhe hipotezën e sinjalizimit.

Rregulloret mbi kapitalin e bankave kanë për qëllim që të zbusin problemet e rrezikut të moralit (*moral hazard*), që vijnë nga sigurimi që ofron sigurimi i depozitave, lehtësirat për të qenë huadhënësi i fundit (*lender of last resort*) dhe skema të tjera garantuese të ofruara nga qeveritë. Para ndryshimeve rregullative të kapitalit të njohur, si ndryshimet e bëra nga Bazeli I, kërkesat për kapital rregullator nuk bënë ndryshim nëpërmjet bankave që kishin aktive me nivele të ndryshme rreziku. Ndërsa me ndryshimet rregullative të bëra nga Bazeli I, bankave iu kërkua që ti klasifikonin aktivitetet dhe aktivitetet e tyre në pesë kategori me një peshë të caktuar rreziku. Gjithashtu kapitali total rregullator u nda në kapitalin që bën pjesë në Tier 1 (nivele të parë) dhe në kapitalin që bën pjesë në Tier 2 (nivele të dytë).

Kapitali që bën pjesë në Tier 1 ose kapitali bazë përfshin kapitalin e vetë të aksionerëve, si dhe rezervat e deklaruara si përshembull rezervat e humbjeve nga huatë<sup>2</sup>, të cilat vendosen mënjanë për të marrë parasysh humbjet e ardhshme ose për të zbutur luhatshmërinë e të ardhurave. Kapitali i përfshirë në Tier 2 ose kapitali shtesë përfshin pjesën tjetër të kapitalit, si fitimet e marra nga investimet e aktiveve, borxhin afatgjatë me afat maturimi më të madh se 5 vjet dhe rezervat e fshehura si për

---

<sup>2</sup>Provigjionet e përgjithshme ose rezervat e përgjithshme të humbjeve nga huatë janë krijuar kundër mundësisë të krijimit të humbjeve akoma të pa identifikuar. Kur këto humbje nuk reflektojnë një përkeqësim të njohur të vlerësimit të aktiveve të vecanta, këto rezerva përfshihen në pjesën e kapitalit të vendosur në Tier 2. Megjithatë kur provigjionet apo rezervat janë krijuar për humbjet e identifikuar ose për vlerën e humbur të një aktivi apo një grupi të caktuar aktivesh, ata nuk janë të lira për të përmbushur humbjet, të cilat mund të gjenerohen kudo në portofol dhe nuk zotërojnë cilësinë kryesore të kapitalit, prandaj këto provigjione apo rezerva nuk duhet të përfshihen në kapitalin bazë.

shembull kompensimi për humbjet në kredi dhe qeratë (*allowance for losses on loans and leases*).

Në kushtet e vendosura nga Bazeli I, kapitali i vendosur në Tier 1 mund të kalojë 4 % të vlerës së aktiveve të peshuara me rrezik dhe kapitali total (shumë e kapitalit të vendosur në Tier 1 plus Tier 2) mund të jetë më i madh se 8 % e vlerës së aktiveve të peshuar me rrezik. Gjithashtu kapitali i vendosur në Tier 1 mund të kalojë 3 % e vlerës totale të aksioneve, por kapitali i vendosur në Tier 2 nuk mund të kalojë vlerën e aksioneve të vendosur në Tier 1. Kështu të paktën 50 % e kapitalit bën pjesë kryesisht në Tier 1.

Sipas Ahmed et. al., (1999), ndryshimet rregullative mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit panë të rëndësishëm rolin që do të kishte eliminimi i rezervave të humbjeve nga huatë nga kapitali i përfshirë në Tier 1, si dhe kufizimin që vjen nga përdorimi i rezervave të humbjeve nga huatë në plotësimin e kërkesave për kapitalin rregullator. Eliminimi i rezervave të humbjeve nga huatë në Tier 1 sjell që një rritje me një dollar e provigjionimit të humbjeve nga huatë, ul kapitalin në Tier 1 me shumën e provigjioneve pas heqjes së taksës. Por duke qenë se rezervat e humbjeve nga huatë vazhdojnë të jenë pjesë e kapitalit në Tier 2 deri në 1.25 % e aktiveve të peshuara me rrezik, një rritje me një dollar e provigjionimit të humbjeve nga huatë rrit kapitalin total me normën e taksës shumëzuar me një dollar. Kështu rritja e provigjionimit të humbjeve nga huatë në Bazeli I ka efekte të kundërta në kapitalin e përfshirë në Tier 1 dhe Tier 2, e cila do të varet nga shumën e kapitalit të vendosur në Tier 1 dhe Tier 2, Fonseca dhe Gonzales, (2008).

Bazuar në hipotezën e manaxhimit të kapitalit, ne presim një lidhje negative midis normës së kapitalit dhe provigjionimit të humbjeve nga huatë për bankat, të cilat kanë kosto më të lartë të plotësimit të kufizimeve të kapitalit, duke përdorur provigjionet si mjet për të plotësuar këto kufizime. Ndër studimet, të cilat kanë testuar hipotezën e manaxhimit të kapitalit përmendin studimin e Ahmed et. al., (1999), Anandarajan et. al., (2006), Bouvatier dhe Lepetit, (2008) etj. Këto studime kanë parë mbi implikimet e përdorimit të provigjionimit të humbjeve nga huatë kryesisht për të plotësuar kriteret e vendosura mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Ndërsa, sjellja e fundit diskrecionare, sinjalizimi ka të bëjë më përdorimin e provigjionimit të humbjeve nga huatë për të sinjalizuar forcën financiare që ata kanë. Teoria e sinjalizimit pohon që një rritje e provigjionimit të humbjeve nga huatë shikohet si një lajm pozitiv për të sinjalizuar mbi fitimet e ardhshme. Gjithashtu bankat rrisin provigjionimin e humbjeve nga huatë për të treguar se janë institucione financiare të shëndetshme për të absorbuar humbjet potenciale të ardhshme. Ndër studimet që kanë testuar përdorimin e LLP si mjet për të sinjalizuar forcën financiare përmendim studimet e; Beaver et. al., (1989), Wahlen, (1994), Beaver dhe Engel, (1996), Ahmed et. al., (1999).

### 2.3 Literatura empirike

Shkatërrimi i cilësisë së portofolit të kredisë së bankave gjatë periudhave të rënies ekonomike sjell në mënyrë të pashmangshme rritjen e ekspozimit të rrezikut të bankave dhe për më tepër rritjen e kërkesës për kapital rregullator (Leaven dhe Majnoni, (2003). Diskutimi i kësaj temë u bë akoma edhe më relevant sidomos gjatë rishikimit të Bazeli I dhe implementimit të Bazeli II. Një përmbledhje e detajuar e literaturës mbi përdorimin e provigjionimit të humbjeve nga huatë është paraqitur edhe në tabelën 1.

Ahmed et al., (1999) kanë analizuar ndryshimet që pasqyrojnë rregullorja mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit në vitin 1990, si dhe testuan efektet e manaxhimit të kapitalit dhe të ardhurave në provigjionimin e humbjeve nga huatë të bankave. Duke analizuar sjelljen e 113 bankave në SHBA, gjatë periudhës 1986-1995 rezultatet konfirmojnë që bankat kanë përdorur provigjionimin e humbjeve nga huatë për të manaxhuar kapitalin, por nuk gjejnë që bankat kanë bërë manaxhim të të ardhurave nëpërmjet provigjionimit të humbjeve nga huatë. Për më tepër Ahmed et. al., (1999) nuk konfirmojnë që bankat kanë bërë sinjalizim, si dhe gjejnë një lidhje negative midis provigjionimit të humbjeve nga huatë si me ndryshimet e pritshme të fitimeve, ashtu edhe nga kthimet e njëkohshme të aksioneve.

Puna kërkimore e udhëhequr nga Cavallo dhe Majnoni, (2001) sugjeron që mungesat në kapitalin e bankave mund të mos rezultojnë nga kërkesa për kapital për rrezikun e shtuar, por mund të vijë edhe si rezultat i praktikave të provigjionimit të humbjeve

nga huatë dhe nivelit të pamjaftueshëm të tyre. Cavallo dhe Majnoni, (2001) kanë testuar empirikisht lidhjen që ekziston midis provigjionimit të humbjeve dhe huatë dhe efektit prociklik të kërkesës për kapital rregullator mbi një zgjedhje prej 1,176 banka në 36 vendeve, gjatë periudhës 1988-1999. Autorët vlerësojnë se niveli i zhvillimit institucional të vendeve ndikon praktikën e provigjionimit të humbjeve nga huatë, rezultat ky që nuk konfirmohet për bankat që bëjnë pjesë në grupin G10 të vendeve. Rezultat ky që vjen nga një provigjionim jo i përshtatshëm në fazat e zgjerimit ekonomik, duke bërë që këto institucione të rrisin provigjionimin gjatë periudhave të stresit financiar. Më konkretisht autorët gjejnë një lidhje pozitive midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe fitimit (ose të ardhurave) para taksave dhe provigjioneve. Për më tepër autorët gjejnë lidhje pozitive midis rrezikut të kredisë dhe provigjionimit të humbjeve nga huatë, si dhe një lidhje negative midis normës reale të rritjes ekonomike dhe provigjionimit të humbjeve nga huatë, si dhe të borxhit ndaj PBB-së me provigjionimin e humbjeve nga huatë

Materiali i Leaven dhe Majnoni, (2003) konsiderohet si një nga materialet e para, që ka kontribuar me evidencat empirike mbi rolin që kanë rezervat e humbjeve të huasë, si komponent i kapitalit rregullator. Shqetësimi kryesor i autorëve ka ardhur si rezultat i; *së pari* kalimi në një regjim të ri rregullator mund të ndikojë negativisht ofertën e kredisë, *së dyti* kërkesat shtesë mbi kapitalit rregullator mund të rrisin shanset e mungesës së kapitalit sidomos gjatë rënies ekonomike duke ndikuar kështu në uljen e ofertës së kredisë së ekonomisë. Kështu shprehja “ngërçi i kreditimit” ose “*capital crunch*” u përdor për herë të parë në fillim të shekullit të 19 për të karakterizuar në mënyrë të njëkohshme mungesën e kapitalit dhe kontraktimin në ofrimin e kredive të reja.

Leaven dhe Majnoni, (2003) testojnë që bankat shfaqin sjellje jo të kujdesshme në krijimin e provigjionit të humbjeve nga huatë duke ndikuar në prociklikalitetin e kapitalit të bankave nëse plotësohen një nga tre kushtet e mëposhtme: a) provigjionimet e humbjeve nga huatë janë të lidhura negativisht me fitimet e bankave, b) provigjionimet e humbjeve nga huatë janë të lidhura negativisht me normën e rritjes së kredisë, c) provigjionimet e humbjeve nga huatë janë të lidhura negativisht me rritjen reale të PBB-së. Ata analizuan sjelljen e 1,419 bankave nga 45 vende të ndryshme gjatë periudhës 1988-1999. Autorët gjejnë një lidhje pozitive midis

provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe fitimit të bankave duke sugjeruar që bankat mesatarisht kanë bërë zbutje të të ardhurave (*income-smoothing*). Gjithashtu ata gjejnë një lidhje negative midis normës reale të rritjes së kredisë dhe provigjionimit, pra bankat duket sikur nuk kanë qenë shumë të kujdesshme gjatë periudhave të rritjes së shpejtë të kreditimit. Leaven dhe Majnoni, (2003) konfirmojnë lidhjen negative midis normës reale të rritjes së PBB-së dhe provigjionimit duke sugjeruar që bankat provigjionojnë më shumë gjatë periudhave të rënies ekonomike, përkundrajt periudhave të rritjes së aktivitet ekonomik.

Bikker dhe Metzemakers, (2005) investigojnë lidhjen midis sjelljes së provigjionimit të bankave dhe varësinë e tyre nga cikli i biznesit në një zgjedhje prej 8,000 banka që veprojnë në 29 vende të OECD-së. Kjo përjasje lejon të bëhet një krahasim i sjelljes së provigjionimit të bankave nëpërmjet vendeve të ndryshme, për të parë se si specifikat e vendeve ndikojnë në këtë sjellje. Rezultatet treguan për një lidhje të rëndësishme midis rritjes reale të PBB-së dhe provigjioneve. Kështu nëse norma e rritjes së PBB-së është poshtë nivelit të 3 %, atëherë rezultatet treguan që provigjionet janë 60 % më të larta se kur rritja është mbi nivelin të 3 %. Rezultat ky që konfirmon sjelljen prociklike të provigjionimit të humbjeve nga huatë me ciklin e biznesit. Nëse rezervat për provigjionet do të rriten më shumë gjatë periudha të rënies ekonomike, kjo do të sjellë një nivel më të ulët fitimesh për të plotësuar kapitalin, duke bërë që bankat të reduktojnë nivelin e dhënies së kredisë. Prociklikaliteti që Bikker dhe Metzemakers, (2005) gjejnë midis rritjes ekonomike dhe provigjionimit zbehet pak nga efekti i zbutjes së fitimeve (*income-smoothing*). Autorët gjejnë që provigjionet janë të lidhura pozitivisht me rrezikun e kredisë, kështu bankat me norma më të larta të raportit të kredisë ndaj aktiveve krijojnë më shumë provigjione. Gjithashtu Bikker dhe Metzemakers, (2005) konfirmojnë hipotezën e manaxhimit të kapitalit, pra bankat provigjionojnë më shumë kur normat e kapitalit të tyre janë të ulta. Rezultatet konfirmohen edhe kur autorët përdorin rezervat e humbjeve nga huatë si variabël i varur, duke forcuar edhe njëherë konkluzionin që bankat duhet të jenë më larg-pamëse (*forward-looking*) në krijimin e provigjioneve.

Anandarajan et. al., (2006) kanë parë nëse dhe në çfarë mase bankat në Australi përdorin provigjionimin e humbjeve nga huatë për manaxhimin e kapitalit, manaxhimin e të ardhurave dhe sinjalizimin. Gjithashtu këta autorë kanë parë nëse

ndryshimet në përdorimin e provigjionimit të humbjeve nga huatë, ka ardhur apo jo si rezultat i ndryshimeve rregullative, kalimi para Bazel I dhe mbas Bazel I. Anandarajan et. al., (2006) gjejnë evidenca se bankat në Australi i kanë përdorur provigjionet e humbjeve nga huatë për manaxhimin e kapitalit, sjellje që nuk është ndikuar nga ndryshimet rregullative. Gjithashtu autorët gjejnë që provigjionimi i humbjeve nga huatë është përdorur si mjet për të manaxhuar të ardhurat, kryesisht mbas ndryshimeve rregullative të Bazelit, duke reflektuar që të ardhurat e raportuara mund të mos reflektojnë aktivitetin real ekonomik të bankave. Së fundmi Anandarajan et. al., (2006) gjejnë që bankat në Australi nuk i përdorin provigjionimet e humbjeve nga huatë si mjet për të treguar fortësinë e tyre financiare.

Fonseca dhe Gonzales, (2008) kanë analizuar zbutjen e të ardhurave të bankave nëpërmjet manaxhimit të provigjionimit të humbjeve nga huatë duke përdorur të dhënat në panel të 4,546 banka, në 41 shtete gjatë periudhës 1995-2002. Vlerësimet e marra nga aplikimi i metodës së GMM (*General Method of Moments*) të Arellano dhe Bond, (1991) tregojnë që zbutja e të ardhurave nga ana e bankave varet shumë nga institucionet, rregulloret, politikat mbikqyrëse, struktura financiare dhe zhvillimi financiar i vendit ku kryejnë veprimtarinë këto bankave.

Bouvatier dhe Lepetit, (2008) kanë analizuar të dhënat e 186 bankave, përkatësisht në 15 vende të Evropës dhe kanë analizuar jo vetëm faktorët përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë, por dhe impaktin e tyre në ofertën e kredisë. Rezultatet e marra nga Bouvateri dhe Lepetit, (2008) tregojnë që bankat e kanë përdorur provigjionimin e humbjeve nga huatë për të mbuluar humbjet e indentifikuara të kredisë duke ndikuar akoma më shumë në ciklikalitetin e sistemit financiar. Gjithashtu autorët gjejnë që bankat më pak të kapitalizuara kanë bërë manaxhimin e kapitalit, por përdorimi i provigjionimit të humbjeve nga huatë për objektiva manaxheriale duket se nuk e ka ndikuar ofertën e kredisë. Bouvateri dhe Lepetit, (2008) kërkojnë në këtë mënyrë implementimin e sistemit dinamik të provigjionimit të humbjeve nga huatë në Europë.

Packer dhe Zhu, (2012) bazuar në një zgjedhje të përbërë nga 240 banka në 12 vende të Azisë, kanë analizuar faktorët përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë gjatë viteve 2000-2009. Shumë vende të Azisë gjatë krizës financiare në Azi

implementuan kërkesa më të forta në lidhje me provigjionimin e humbjeve nga huatë, me qëllim rritjen e provigjionimit në përputhje edhe me rritjen e rrezikut të pritshëm. Këto masa të ndërmarra bënë që bankat në Azi, përkundrajt bankave të vendeve të tjera, të ishin më të qëndrueshme dhe ta përballonin më me sukses krizën e fundit financiare. Rezultatet si për grup vendesh, ashtu edhe për vendet në mënyrë individuale, treguan që provigjionimi i humbjeve nga huatë në mënyrë kundërciklike ka dominuar vendet në Azi, duke u përforcuar më së shumti edhe gjatë krizës së fundit financiare. Nga ana tjetër provigjionimet e humbjeve nga huatë ndihmuan në përmirësimin e ritmit të fitimeve të bankave dhe si rrjedhojë edhe në rritjen ekonomike të këtyre vendeve.

Skala, (2014) ka analizuar zbutjen e të ardhurave dhe prociklikalitetin e provigjionimit të humbjeve nga huatë të bankave në Europën Qëndrore gjatë periudhës 2004-2012. Rezultatet e gjetura nga Skala, (2014) konfirmojnë hipotezën e manaxhimit të të ardhurave, megjithatë vlerësimet nuk konfirmojnë hipotezën që bankat kanë qenë të kujdesshme për të “kursyer për një ditë me shi”. Vlerësimet kanë treguar një sjellje prociklike të provigjioneve me rritjen ekonomike dhe se bankat në Europën Qëndrore nuk kanë përfituar nga avantazhet e kushteve të mira makroekonomike për të krijuar më shumë provogjione. Gjithashtu bankat në Europën Qëndrore në kushtet e rënies ekonomike kanë përdorur kapitalin për të mbuluar humbjet nga kreditë. Për më tepër bankat kanë ulur provigjionimin e humbjeve nga huatë gjatë periudhave me ritme të larta të rritjes së kredisë, që ka treguar për mungesën e elementëve largpamës (*forward-looking*) në politikat e tyre të kreditimit.

Alesi et.al., (2014) kanë analizuar përcaktuesit e provigjionimit të humbjeve nga huatë të bankave në Itali gjatë periudhës 2006-2012, fokusuar kryesisht në nënkomponentët e provigjionimit të humbjeve nga huatë. Vlerësimet e marra nga këta autorë tregojnë që provigjionimi i humbjeve nga huatë për bankat në Itali duket se është udhëhequr më së shumti nga *komponenti jo-diskrecionar* i tij. Ndërkohë nuk evidentohet që kushtet ekonomike të kenë luajtur një rol të rëndësishëm në provigjionimin e humbjeve nga huatë. Gjithashtu Alesi et. al., (2014) nuk konfirmojnë që bankat në Itali të kenë bërë zbutje të të ardhurave apo sinjalizim të fortësisë financiare të tyre. Ndërsa nga një analizë më e detajuar nga ana e autorëve mbi bankat kooperative

tregon që strategjitë e provigjionimit të këtyre bankave janë ndikuar më së shumti nga niveli i kolateralizimit të kredive.

Në mënyrë të përmbledhur faktorët përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë janë grupuar si më poshtë:

*Cilësia e kredisë.* Ndër treguesit kryesorë përcaktues së provigjionimit të humbjeve nga kreditë janë ato të cilat masin cilësinë e portofolit të kredisë. Kështu ndër treguesit kryesorë që përdoren për matjen e cilësisë së kredisë janë norma e kredive të këqija ndaj totalit të kredisë (norma e NPL-së) dhe norma e kredisë ndaj totalit të aktiveve të bankës, ( *Loan\_rate*). Si norma e NPL-së, ashtu edhe raporti i kredisë ndaj totalit të aktiveve janë të lidhura pozitivisht me provigjionimin e humbjeve nga kreditë. Një tjetër variabël që vlerëson cilësinë e kredisë është edhe norma reale e rritjes së kredisë, e cila reflekton nivele më të larta rreziku që bankat marrin në konsideratë. Leaven dhe Majnoni, (2003) dhe Skala, (2014) gjejnë një lidhje negative midis normës reale të rritjes së kredisë dhe provigjionimit të humbjeve nga huatë, e cila lidhet me faktin që provigjionet tentojnë të ulen kur merren në konsideratë kreditë e reja. Ndërsa pjesa tjetër e studimeve gjejnë një lidhje pozitive midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe normës reale të rritjes së kredisë.

*Fitimet ose të ardhurat (para interesave, taksave dhe provigjioneve).* Një tjetër faktor që ndikon në sjelljen prociklike të provigjionimit të humbjeve nga kreditë janë edhe të ardhurat. Nëse bankat përdorin provigjionimet e humbjeve nga huatë për të zbutur luhatshmërinë e të ardhurave, atëherë pritet një lidhje pozitive midis provigjioneve dhe të ardhurave, duke konfirmuar hipotezën e zbutjes së të ardhurave (*income-smoothing hypothesis*). Ashtu siç përmendet edhe në literaturë disa nga arsytet që bankat tentojnë të bëjnë zbutje të fitimeve të tyre janë: përmirësimi i imazhit të bankave, incentivat e taksave, interesat vetjakë të manaxherëve etj. Evidencat empirike të përmendura nga studimet më lart si: Cavallo dhe Majnoni, (2001); Leaven dhe Majnoni, (2003); Bikker dhe Metzmakers, (2005), Bouvatier dhe Lepetit, (2008) konfirmojnë një lidhje pozitive midis fitimit para interesave, taksave dhe provigjioneve dhe vetë provigjionimit të humbjeve nga huatë.

*Norma e kapitalit.* Norma e kapitalit ndaj totalit të aktiveve është një tjetër faktor që merret në konsideratë për të testuar hipotezën e manaxhimit të kapitalit nga ana e



bankave. Kështu një lidhje negative midis normës së kapitalit ndaj totalit të aktiveve dhe provigjionimit të humbjeve nga huatë konfirmon hipotezën e manaxhimit të kapitalit, pra më shumë provigjione kur normat e kapitalit janë të ulta. Një lidhje negative midis normës së kapitalit dhe provigjioneve është gjetur nga Bikker dhe Metzemakers, (2005); Fonseca dhe Gonzales, (2008). Sipas Bikker dhe Metzemakers (2005) një lidhje negative midis normës së kapitalit dhe provigjioneve është e lidhur me faktin që disa banka mbartin më shumë rrezik se të tjerët, duke ndikuar kështu në më shumë humbje dhe provigjione, si dhe në norma më të ulta të kapitalit. Megjithatë sipas Fonseca dhe Gonzales (2008) lidhja midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe kapitalit nuk është shumë e qartë kur bankat veprojnë nën Bazel I.

*Norma reale e rritjes së PBB-së.* Ndër faktorët makroekonomikë që përdoret në literaturë për të përshkruar ciklin e biznesit është norma reale e rritjes së PBB-së. Pjesa më e madhe e studimeve gjejnë një lidhje negative midis provigjionimit të humbjeve nga huatë me ciklin e biznesit, e cila konfirmon përqasjen klasike mbi sjelljen prociklike të tyre. Kështu bankat tentojnë që të ulin provigjionet gjatë periudhave të ekspansionit ekonomik dhe ti rrisin ato gjatë periudhave të rënies ekonomike, Leaven dhe Majnoni, (2003) dhe Bikker dhe Hu, (2002). Megjithatë ekziston edhe një tjetër përqasje, përqasja kundërciklike përmendur nga Borio et.al., (2001), që shprehet për një krijim të rrezikut gjatë periudhave të lulëzimit ekonomik dhe materializimit të tij kryesisht gjatë rënies ekonomike. Bazuar në këtë përqasje provigjionet duhet që të jenë të lidhura pozitivisht me ciklin e biznesit, pra provigjionet të rriten më shumë gjatë periudhave të zgjerimit ekonomik dhe të ulen gjatë periudhave të rënies ekonomike. Ashtu siç e përmendin edhe Bikker dhe Metzemakers, (2005) kjo sjellje kundërciklike e bankave nënkupton që bankat janë larg-pamëse (*forward-looking*) në vlerësimin e rrezikut nga ana e tyre.

Në rastin e Shqipërisë, ky material është ndër materialet e parë që duke përdorur metodat dinamike të vlerësimit në panel, investigon përcaktuesit e provigjionimit të humbjeve nga huatë. Kapitujt në vazhdim do të paraqesin në mënyrë më të detajuar metodologjinë, të dhënat dhe rezultatet e marra për sjelljen e provigjionimit të humbjeve nga huatë të bankave në Shqipëri.

**Tabela 1: Vështrim i përgjithshëm i literaturës.**

Autorët	Zgjedhja	Metoda e vlerësimit	Qëllimi	Rezultatet
Ahmend et.AL, (1999)	113 banka në SHBA, gjatë periudhës 1986-1995 periudhës	Vlerësimi me anë të MZKV-së për pooled time-series cross-sectional	Ky material investigon përdorimin e provigjionimit të humbjeve nga huatë për manaxhimin e kapitalit, të të ardhurave dhe për të sinjalizuar fortësinë financiare	(poz) ndryshimi i detyrimeve per capita i bizneseve të falimentuara peshuar me shpërndarjen gjeografike të kredisë (poz)-ndryshimin në devijimin standart të aktiveve (poz) normën e ndryshimit të raportit të kredive të këqija (neg) norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (neg) fitimet para taksave/totalit të kredisë
Cavallo dhe Majnoli, (2001)	1176 banka, 382 vende ( 10 në G10 dhe 372 vende jo pjesë e G10), 1988-1999	Vlerësimi me anë të MZKV (metodës së katrorëve më të vegjël, OLS) për të dhëna në panel me efekte fikse.	Investigimi i natyrës së lidhjes së fitimeve të bankave me provigjionimin e humbjeve nga huatë dhe faktorët përcaktues të tyre	(poz) Fitimet/totalit të aktiveve (poz) Kredi/totalit të aktiveve (neg) normën e rritjes së kredisë (neg) borxhi publik/PBB-së (neg, insig) PBB për frymë
Leaven dhe Majnoli (2003)	1419 banka, 45 vende të botës, 1988-1999	MZKV për të dhëna në panel dhe GMM nga Arellano dhe Bond(1991)	Analizimi i sjelljes prociklike të provigjioneve të bankave	(poz) Fitimet/totalit të aktiveve (neg) normën e rritjes së kredisë (në kundërshtim me atë që pritet) (neg) norma reale vjetore e rritjes së PBB-së
Bikker dhe Metzmakers (2005)	8000 banka, 29 vende të OECD, të dhëna vjetore, 1991-2001	Vlerësimi me anë të MZKV për të dhëna në panel, të propozuar nga Newey dhe Wests (1987 për korrektimin e heteroskedasticitetit dhe serial correlation)	Investigimi i sjelljes së provigjionimit të bankave dhe lidhja e tyre me ciklin e biznesit	(neg) Norma reale vjetore e rritjes së PBB-së; (poz) Fitimet/totalit të aktiveve; (poz) Norma vjetore e rritjes së kredisë (poz) Kredi/totalit të aktiveve (neg) Kapital/totalit të aktiveve
Anandarajan et al (2006)	50 banka në Australi, nga të cilat 10 janë të listura	Metoda e vlerësimit është MZKV.	Ky material shikon nëse provigjionimi i humbjeve nga huatë është përdorur	poz) normën e ndryshimit të kredisë ndaj totalit të aktiveve

	dhe 40 janë tëpa-listuara, gjatë periudhës 1991-2001,		për zbutjen e të ardhurave, manaxhimin e kapitalit dhe sinjalizimin.	(poz) Fitimet/totalit të aktiveve (poz) Totalit të aktiveve-përafres i madhësisë  (neg) kapitali rregullator aktual përpara rezervave të humbjeve nga huatë ndaj minimumit të kapitalit rregullator. (neg) normën e rritjes së kredisë (poz, insig)norma e rritjes së PBB-së
Fonseca dhe Gonzales, (2008)	1586 banka nga 41 vende, gjatë periudhës 1995-2002	Metoda e GMM e propozuar nga Arellano dhe Bond(1991)	Testimi i hipotezës së income smoothing për vendet në mënyrë individuale dhe impakti i variablave të tjerë sipas specifikave të vendit ( si struktura financiare, mbikëqyrja, rregulloret, mbrojtja e investitorëve etj).	(poz) Fitimet/totalit të aktiveve (poz) Norma vjetore e rritjes së kredisë (neg <sup>3</sup> )Capital adequacy ratio ( kapital/aktivet me rrezik të bankave) (neg)Norma reale vjetore e rritjes së PBB-së
Bouvatier dhe Lepetit (2008)	186 banka Europiane, gjatë periudhës 1992-2004	GMM, diferenca e parë propozuar nga Arellano dhe Bond, (1991), dhe dejivimi vertikal nga Arellano dhe Bower, (1995).	Investigon nëse sjellja e bankave e detyruar nga kufizimet mbi nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe sistemit të provigjionimit ndikon në amplifikimin e fluktacioneve të kredisë.	(poz) NPL ( norma e kredisë të këqija ndaj totalit të kredisë) (poz) ndryshimi vjetor i NPL-së (poz, insig) kredinë/totalin e aktiveve (neg) normën vjetore të rritjes së PBB-së reale (neg) Fitimet/totalit të aktiveve (poz) Totalin e kapitalit/totalit të aktiveve për bankat më pak të mirëkapitalizuara (poz) Norma vjetore e rritjes së Fitimeve të bankave

<sup>3</sup> Fonseca dhe Gonzales, (2008) gjejnë një lidhje negative për Car, për të gjithë bankat e marra në shqyrtim, por gjen një lidhje pozitive kur përjashtohen bankat amerikane. Ky ndryshim tregon që përcaktimet të ndryshme mbi kapitalin rregullator mund të sjellë ndikime të ndryshme midis LLP dhe kapitalit të bankave në vende të ndryshme.

<i>Packer dhe Zhu (2012)</i>	240 banka në 12 vende të Azisë, gjatë periudhës 2000-2009	Vlerësimi me anë të metodës MZKV për të dhënat në panel dhe GMM nga, Arellano dhe Bond(1991).	Vlerësimin empirik të lidhjes midis provigjioneve të bankave dhe fitimeve.	(poz) NPL ratio (poz)Kredi/totalit të aktiveve (neg)Norma vjetore e rritjes së kredisë (Neg)CAR (neg) Norma reale vjetore e rritjes së PPB (poz) Fitimet/totalit të aktiveve
<i>Skala (2014)</i>	2004-2012, 244 banka tregtare nga 11 vende të Europës Qëndrore	Metoda e vlerësimit me anë të MZKV-së për të dhënat në panel.	Analizimi i zbutjes së të ardhurave dhe prociklikaliteti i LLP-së në bankat e Europës Qendrore në kontekst të motive të kujdesshme dhe jo-të kujdesshme manaxhariale.	(poz) Fitimet/totalit të aktiveve (poz) NPL (poz)Kredi / totalit të aktiveve (insig <sup>4</sup> ) equity/totalit të aktiveve (neg)Norma vjetore e rritjes së kredisë (neg) Norma reale vjetore e rritjes së PBB-së
<i>Alessi, Di Collo dhe Lopez (2014)</i>	400 banka në Itali, gjatë periudhës 2006-2012	Metoda e vlerësimit me anë të GMM të propozuar nga, Arellano dhe Bond (1991).	Ky material investigon përcaktuesit e provigjionimit të humbjeve të huasë dhe të normës së mbulimit të bankave në Itali.	(neg) Fitimet/totalit të aktiveve (poz) NPL (poz)kredi/totalit të aktiveve (neg) kapital/totalit të aktiveve (neg,insig) Norma reale vjetore e rritjes së PBB-së

Shënim: (neg) –negative, (poz)-pozitive, (insig)-e parëndësishme.

## 2.4 Përcaktimi kontabël i provigjionimit të humbjeve nga huatë

Duke qenë se fokusi i studimit të këtij punimi shkencor janë përcaktuesit e provigjionimit të humbjeve nga huatë është mjaft e rëndësishme që të kuptohet përjasjet e përcaktimit të tyre. Gaston dhe Song, (2014) nënvizojnë se përcaktimi kontabël i provigjionimit të humbjeve nga huatë, për vendet që kanë patur për qëllimin implementimin e Standarteve Ndërkombëtare të Raporteve Financiare<sup>5</sup>,

<sup>4</sup>Specifikimi bazë i modelit e vlerëson negative por statistikiqsh jo të rëndësishme, mbas krizës lidhja midis kapitalit aksioner dhe LLP vlerësohet negative dhe statistikiqsh e rëndësishme

<sup>5</sup>International Financial Reporting Standards.

(IFRS) është influencuar kryesisht nga dy përjasje kryesore që janë: Praktikën Ndërkombëtare të Kontabilitetit, IAS<sup>6</sup>,<sup>39</sup> dhe Regjimi i Bazelit.

Përjasja e IAS, 39 i mat dëmet nga humbjet bazuar në metodën e skontimit të flukseve të parasë, (*cash flow*). Për aktivet individuale, vlerësimi i dëmeve të humbjeve llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të vlerësuar, të skontuar me normën efektive të interesit të aktivit. Ndërsa në praktikë vlerësimi i dëmeve të humbjeve në nivel grup aktiviteti bëhet duke marrë në konsideratë vlerën historike të humbjeve, të axhustuara me vlerën e të dhënave aktuale të vëzhgueshme për të arritur tek vlera aktuale e flukseve të ardhshme të parasë, (*cash flow*). Vlerësimet për dëmet nga humbjet paraqiten në Pasqyrën e të Ardhurave, ndërsa humbjet e pritshme të kredisë pavarësisht vlerës së tyre nuk paraqiten në Pasqyrën e të Ardhurave. Vlera kontabël e një kredie në bilancin e bankës reduktohet ose menjëherë ose nëpërmjet zërit që quhet “*allowance account*”, në formën e fondit të rezervës.

Kështu përjasja IAS, 39<sup>7</sup> bazohet në një model humbjeje të kredisë së ndodhur më parë, duke bërë që kjo përjasje të limitojë aftësinë e manaxherëve për të krijuar rezerva. Përpara adaptimit të IFRS-së, disa vende të Europës kishin regjime kontabël të tilla që i lejonte ata të akumulonin rezerva, të cilat do të shërbenin si mbulesë kundrejt humbjeve të kredisë, duke minimizuar në këtë mënyrë edhe luhatshmërinë e fitimeve. Përjasja e IAS, 39 bazuar në krijimin e provigjioneve kur humbjet ndodhin, të kombinuar edhe me kufizime për të krijuar rezerva për mbulim (*reserve buffers*) ka kontribuar në reduktimin e manipulimit të fitimeve. Megjithatë nga ana tjetër kjo përjasje është kritikuar se krijimi i vlerësimit i dëmeve nga humbjet (*impairment loss*) bëhet vonë dhe në masë të ulët.

---

<sup>6</sup>IAS 39 është guida aktuale që udhëheq standartet e kontabël në vlerësimin e humbjeve, standart ky që të zëvendësohet deri në 2018 nga IFRS 9, publikuar në 24 Korrik 2014 nga IASC ( *International Accounting Standards Committee*).

<sup>7</sup> IAS 39 është bërë efektive që më 1 Janar të 2001, dhe ka në përbërje të tij 4 komponentë që janë: Recognition and Measurement (njohja dhe matja), Impairment ( dëmi), Hedge accounting ( fshehja e llogarisë) dhe Derecognition ( mos njohja). Fokusi kryesor është trajtimi i atyre aseteve financiare të klasifikuara si “Held to Maturity” dhe “Loans and Receivables”.

Sipas Gaston dhe Song, (2014) principet standarte të IAS, 39 lënë shumë hapësira për gjykim në përcaktimin e nivelit të provigjionimit të humbjeve nga huatë, duke bërë që ky nivel të jetë i pamjaftueshëm ose të mos jetë i përcaktuar qartë. Kështu pavarësisht se IAS, 39 ka identifikuar një numër të caktuar të dhënash, mbi të cilat gjykohet realizimi apo jo i disa objektivave, përsëri kjo përjashtë hapësirë për gjykim mbi një numër të caktuar elementësh kritikë. Këta elementë janë vendimtarë në përcaktimin e objektivave të realizueshëm dhe të parashikimit të vlerës së ardhshme të flukseve, sidomos kur të dhënat janë të kufizuara.

IAS, 39 nga ana tjetër kërkon që ndodhja e një ngjarje ose e shumë ngjarjeve të humbura së bashku me vlerësimin e dëmeve të humbjeve (*impairment losses*) të vlerësohen apo të maten në nivel individual dhe në nivel grupi. Grupimi i aktiveve në nivel grupi bëhet sipas karakteristikave të ngjashme që këto aktive kanë dhe vlerësimi i dëmeve të humbjeve bëhet në nivel grupi. Megjithatë vlerësimi në grup është një hap i parakohshëm pasi në momentin që një humbje lidhet direkt me një kredi individuale ajo kredi largohet nga portofoli. Pavarësisht faktit që formulat apo metodat statistikore janë të dizenuara për vlerësimin e aktiveve në nivel grupi, kjo nuk do të thotë që vlerësimi i dëmeve të humbjeve të devijojë nga principi i ndodhjes së humbjeve. Kështu pavarësisht faktit që IAS, 39 merr në konsideratë humbjet e ndodhura dhe të pa-raportuara ato janë të ndryshme nga humbjet e pritshme të kredisë në të ardhmen që merr në konsideratë përjashta makroprudenciale.

Ndërsa sipas regjimit të Bazelit, përcaktimi i provigjionimit të humbjeve nga huatë mbështetet në përjashtjen e “humbjeve të pritshme”, ku provigjionet e bankave përfshijnë humbjet e identifikuara (provigjionet specifike) dhe humbjet e paidentifikuara (provigjionet e përgjithshme), të cilat ndodhin në të ardhmen, (*Basel Capital Accord I* ose Bazel I).

Provigjionet specifike janë ato provigjione që lidhen me humbjet e ndodhura të kredisë (ose dëmet), ndërsa provigjionet e përgjithshme marrin në konsideratë humbjet, të cilat nuk janë akoma materializuar, por që priten që të ndodhin në të ardhmen. Në 2006, Komiteti i Bazelit, mbi Mbikqyrjen Bankare, BSBC rekomandoi që vlerësimi i dëmeve të mos bazohet vetëm në bazë të disa rregullave dhe formulave,

por theksoi përfshirjen e gjykimit të vetë manaxherëve të bankës në vlerësimin e tyre. Nën Bazel II, kërkesat për llogaritjen e provigjionimit të humbjeve nga huatë kërkojnë gjithashtu inkorporimin e konceptit të falimentit<sup>8</sup>, vonesat dhe elemententë të tjerë indikativë. Megjithatë Bazel II nuk jep një përkufizim të saktë për kredinë e keqe (ose *non-performing loan*), por ka një nivel minimal të ditëve për vonesa në pagesa që është 90 ditë. Ndërsa një kredi quhet e humbur sipas përcaktimit të dhënë në Bazel II, nëse huamarrësi nuk është në gjendje që ti paguajë bankës detyrimet që ka ndaj saj ose kur vonesat në pagesa i kanë kaluar 90 ditë.

Në përcaktimin e dhënë në Basel II, provigjionet e përgjithshme krijohen për të mbuluar humbjet e mundshme, të cilat nuk janë identifikuar akoma. Përgjithësisht humbjet e mundshme llogariten në përqindje të kredisë totale, por mund të llogariten edhe në mënyrë progresive, pra një përqindje më e lartë e provigjione për aktive me rrezik më të lartë, e cila reflekton edhe probabilitetin më të lartë të ndodhjes së humbjeve. Basel II sipas përqsjes IRB (*Internal Ratings Based approach*) shprehet se vlerësimi i humbjeve të pritshme nga kredia është i lidhur me vlerësimin e probabilitetit të falimentimit (*probability of default, PD*) dhe humbjet e përcaktuara nga falimentimi (*Loss Given Default, LGD*) për ekspozimin e kredive që nuk janë të humbura. Ndërsa për ekspozimin e kredive që janë të klasifikuara të humbura, bankat duhet që të përdorin vlerësimet e tyre më të mira për humbjet e pritshme duke marrë në konsideratë edhe humbjet e papritura shtesë gjatë periudhave të rënies ekonomike.

Vlerësimi i provigjioneve është i lidhur direkt me normën e llogaritjes së kapitalit. Nën kushtet e vendosura nga Bazel I, provigjionet e përgjithshme mund të përfshihen në kapitalin e vendosur në Tier II (*Nivelit të dytë*), të cilat janë subjekt i limitit të 1.25 përqind të aktiveve të peshuara me rrezik, dhe kanë për qëllim mbulimin e humbjeve të pritshme që nuk janë ende të identifikuara. Në përqsjen standarte të Basel II për rrezikun e kredisë, provigjionet e përgjithshme mund të përfshihen në kapitalin e vendosur në Tier II, me kusht që vlera e tyre të mos kalojë limitin e 1.25 përqind të aktiveve të peshuara me rrezik. Ndërsa në përqsjen IRB të Basel II, opsioni i përfshirjes në mënyrë eksplicite të provigjioneve të përgjithshme në kapitalin e

---

<sup>8</sup> Edhe tek IFRS falimentimi mund të përfshihet tek humbjet në momentin kur llogariten realizimi i objektiva që ka banka.

vendosur në Tier II nuk ekziston. Në fakt kalimi i provigjioneve totale (llogaritur si shumë e provigjioneve specifike, të përgjithshme, rreziku i vendit, *write-off* etj ) mbi humbjet e pritshme mund të përfshihet në kapitalin e Tier II përkundrejt një maksimumi prej 0.6 përqind të aktiveve të peshuara me rrezik. Krijimi i provigjioneve specifike redukton të ardhurat dhe ka efekt negativ në kapital, por provigjionet specifike nuk përfshihen në kapital sepse ato janë krijuar për të mbuluar humbjet e pritshme. Ndërkohë norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave duhet të pasqyrojë aftësinë e bankave për të mbuluar humbjet e papritura. Nën-provigjionimi është përgjithësisht i vetmi shtrembërim i madh në llogaritjen e kapitalit dhe të normës së mjaftueshmërisë së tij. Në kushte normale, bankat kanë tendencën që të nënvlerësojnë rrezikun e kredisë, të mos bëjnë një klasifikimim të mirë të aktiveve që mund të dëmtohen dhe të shtyjnë për më vonë njohjen e humbjeve, duke shmangur kështu një nivel më të lartë provigjionimi që do të uli performancën dhe të limitojë mundësitë e rifinancimit në një moment të vështirë.

Duke qenë se si përqsasja IAS 39, ashtu edhe përqsasja e Bazelit bëjnë të mundur vlerësimin e provigjionimit të humbjeve nga huatë, është mjaft e rëndësishme që mbikëqyrësit bankarë të kuptojnë diferencat dhe ngjashmëritë që ekzistojnë midis dy përqsasjeve. Për më tepër ata duhet të kenë aftësitë e duhura teknike për të ngushtuar *gap-in* apo diferencat gjatë periudhës së implementimit të dy përqsasjeve.

Ngjashmëria kryesore që ekziston midis dy përqsasjeve është që ato tentojnë të vlerësojnë rrezikun ekzistues të kredisë dhe përpiqen që të masin burimet që ato duhet të heqin mënjanë në mënyrë që të zvogëlojnë dhe të absorbojnë humbjet që rezultojnë nga ai rrezik. Kështu pritet që Komiteti i Bazelit mbi Mbikqyrjen Bankare, (BCBS (2006) dhe Bordi Ndërkombëtar i Llogarive Standarte, IASB, (*International Accounting Standards Board*, 2009) të kenë dhe të ndajnë të dhëna të përbashkëta që kanë të bëjnë: me rrezikun e kredisë, normat historike të humbjeve, karakteristikat e grupeve për të gjykuar për vlerësimin e kredive, të dhënat për të vlerësuar humbjen e kredisë ose për të vlerësuar normat historike të humbjes.

Diferenca kryesore midis këtyre dy përqsasjeve është jo vetëm konceptuale, por edhe operacionale. Kështu nën përqsasjen e IRFS-ë, bankat i masin dëmet nga humbjet



bazuar në humbjet e ndodhura të përcaktuara nga IAS, 39. Ndërsa nën Bazel II, përveç provigjioneve specifike, vlerësimi i humbjeve të kredive është bazuar në konceptin e humbjeve të pritshme, që kërkon vlerësimin e kushteve ekonomike-financiare, si dhe aftësinë paguese të huamarrësve. Megjithatë është e rëndësishme që mbikëqyrësit bankarë të kenë një kuptim të mirë të ngjashmërive dhe të diferencave të dy përjasjeve përse i përket llogaritjeve të provigjionimit të humbjeve nga huatë, diferenca që vijnë që nga terminologjia e përdorur, si “dëmet nga humbjet”, (termi kontabël) dhe “provigjionimi i humbjeve të kredisë” (termi prudencial), (Gaston dhe Song, 2014).

Vlerësimi i dëmeve nga humbjet për qëllime të raportimit financiar synon të sigurojë që bilanci i bankave dhe pasqyra e të ardhurave të jenë të raportuar në mënyrë të drejtë për periudhën fjalë. Duke qenë se kontabiliteti i llogarive ka të bëjë me raportimin mbi të kaluarën (ku janë përditësuar kushtet aktuale) IAS, 39 e përmbush rolin e saj në përpilimin e raportit financiar (Hoogercost,2012) dhe nga ana tjetër ka ndihmuar edhe në uljen e manaxhimit të fitimeve. Megjithatë filozofia kontabël ka patur si qëllim të raportojë vetëm dëmet e humbjeve që vijnë nga eventet e kaluara dhe për mbikëqyrësit financiarë pasqyrimi i kushteve aktuale ka qenë një sfidë më vete. Kështu në përgjigje të kërkesave edhe të mbikëqyrësve, IFRS, 9 ka për qëllim përfshirjen e humbjeve të pritshme të kredive në pasqyrën e të ardhurave.

Nga ana tjetër kërkesa për një provigjionim prudencial kërkon që nën regjimin e Bazel-it, bankat të marrin parasysh jo vetëm rrezikun me një nivel të përshtatshëm të kapitalizimit, por edhe të sigurojnë një sistem financiar të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm. Bazuar në këtë përjasje mbikëqyrësit bankarë duhet që të vlerësojnë efektivitetin e politikave të bankave dhe të praktikave të vlerësimit të rrezikut të kredisë, që të kënaqin kërkesat për një nivel të përshtatshëm të provigjionit të humbjeve nga huatë. Duke qenë se marrja përsipër e rrezikut është në qendër të strukturës së kapitalit të bankave kjo ka bërë që Regjimi i Bazelit të jetë më *forward-looking* (largpamës) duke marrë në konsideratë dhe të paraprijë rreziqet dhe humbjet, të cilat nuk kanë ndodhur por që kanë një probabilitet të caktuar ndodhjeve. Kështu përjasja IRB (*International Ratings Based approach*) e Basel II në mënyrë eksplicite bashkon së bashku konceptin e humbjeve të pritshme me metodologjinë e llogaritjes.

Konkluzioni kryesor që rezulton nga krahasimi i dy përjasjeve është që përjasja e provigjionimit të humbjeve nga huatë bazuar në regjimin e Bazelit tenton të mbajë një nivel më të lartë provigjioni se ato që janë të lejuara nën IAS, 39. Disa nga faktorët që shpjegojnë diferencat që ekzistojnë midis dy përjasjeve lidhet me: (a) sasinë e informacionit që marrin në konsideratë të dy përjasjet, (b) gjykimet e ndryshme që përfshijnë bankat kur aplikojnë IAS 39 dhe (c) mungesën e shqyrtimit në kohë nga auditorët.

Diferencat midis tyre sollën që Komitetit i Bazelit mbi Mbikqyrjen Bankare, (BCBS) në 2009 të ndërmarrë projektin e zëvendësimit të IAS, 39 me IFRS, 9 (publikuar në 2014), ku vlerësimi i humbjeve të kredisë të jetë më *forward-looking* (largpamës) dhe të mos varet vetëm nga ndodhja e ngjarjes së një humbjeje. IFRS 9 nuk përcakton një metodologji për llogaritjen e humbjeve të pritshme, por vlerësimi i tyre bëhet në 2 faza. Gjatë fazës së parë bëhet llogaritja e vlerësimit të humbjeve për gjatë 12 muajve dhe vlerësohet nëse ka një rritje të rëndësishme të rrezikut të kredisë gjatë kësaj periudhe. Ndërsa, në fazën e dytë vlerësimi i humbjeve të pritshme llogaritet për gjithë periudhën e jetës së kredisë. Edhe kjo metodë pavarësisht se është më largpamëse (*forward-looking*) në llogaritjen e vlerësimit të humbjeve, përsëri bazohet në gjykime për llogaritjen e provigjioneve si gjatë 12 muajve të parë të jetës së kredisë, ashtu edhe për gjithë periudhën e jetës së kredisë.

## 2.5 Klasifikimi i kredisë dhe provigjionimi në disa vende të Evropës dhe në Shqipëri.

Një përcaktim më i mirë i provigjionimit të humbjeve nga huatë, kërkon që bankat të kenë një vlerësim sa më të mirë të rrezikut të kredisë, dhe komponentëve përbërës të tij, si falimenti dhe humbjet që rezultojnë nga falimentimi). Ku klasifikimi i kredisë bazohet kryesisht në numrin e ditëve të kaluara për mospagim të kredisë ose/dhe kriteret e tjera për vlerësimin e aftësisë paguese të huamarrësve. Analiza e D'Hulster et. al., (2014) mbi pyetësorin e përgatitur nga Banka Botërore gjatë periudhës 2011-2012, konfirmon se mbi 26<sup>9</sup> vende të Bashkimit Europian dhe të vendeve në zhvillim në Evropë ka rezultuar se pjesa më e madhe e vendeve (72 % e tyre) kanë një sistem

---

<sup>9</sup> Shqipëri, Bosnja-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Çeki, Estoni, Gjeorgji, Hungari, Kosovë, Latvia, Lituani, Maqedoni, Mali i Zi, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Austri, Danimarkë, Francë, Greqi, Itali, Norvegji dhe Suedi.

klasifikimi të aktiveve bazuar kryesisht në 5 klasa kryerore që janë: (a) standarde, (b) në ndjekje (c) nënstandarte (d) të dyshimta dhe (e) të humbura.

Në vazhdim do të paraqesim një analizë mbi mënyrën e klasifikimit të kredisë dhe sistemit të provigjionit të humbjeve nga huatë në disa vende të Evropës dhe në Shqipëri. Analiza jonë bazuar në të dhënat e pyetësorit të Bankës Botërore, është e fokusuar kryesisht tek vendet e rajonit, si dhe në ato vende të zhvilluara, ku kanë origjinën pjesa më e madhe e bankave të huaja në Shqipëri. Konkretisht analiza është fokusuar në këto vende: Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi, Austri, Francë, Greqi dhe Itali.

Tabela 2, e paraqitur në vijim tregon se pjesa më e madhe e vendeve të marrë në analizë, kanë një sistem mbi të cilat bazohet klasifikimi i ndarjes së aktiveve sipas kategorive. Për më tepër *BCBS* ka theksuar gjithmonë e më shumë përdorimin e sistemeve të brendshme të rankimit për një vlerësim sa më të mirë të rrezikut të kredisë, humbjeve të pritshme EL (*expected losses*), si dhe të një vlerësimi sa më të mirë të kërkesave për kapital rregullator. Ndërsa në kolonën e dytë është paraqitur informacioni në lidhjen me mbulimin apo jo të gjithë huamarrësve nga ana e bankave gjatë krijimit të rezervave. Një vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe ekspozimit që kanë bankat ndaj borxhit të qeverisë.

**Tabela 2: Ekzistenca e sistemeve të klasifikimi të aktiveve.**

Vendet	Ekzistenca e një sistemi klasifikimi të aktiveve	Mbulimi i të gjithë huamarrësve
Shqipëria	Po	Jo
Bosnja-Hercegovinia	Po	Po
Kroacia	Po	Po
Kosova	Po	Po
Maqedonia	Po	Po
Mali i Zi	Po	Po
Serbia	Po	Po (0 % peshë, rrezikut të kredisë të qeverisë)
Austri	Po	Po
Francë	Po	Po
Greqi	Jo	Jo
Itali	Po	Po

*Burimi:* D'Hulster et. al., (2014).

Standartet e Bazelit marrin në konsideratë për vlerësimin e kapitalit rregullator edhe ekspozimin ndaj qeverisë, duke vendosur një peshë 0 % për ekspozimin e bankave ndaj letrave të qeverisë në monedhë vendase. Megjithatë në momentin që vihen re vonesa në pagesa atëherë ekspozimi ndaj qeverisë nuk mund të konsiderohet me rrezik 0, duke i vendosur një peshë të caktuar rrezikut ndaj qeverisë.

Klasifikimi i kredisë në kategoritë: nënstandarte, të dyshimtë dhe të humbur bëhet në bazë të gjashtë kritereve (tabela 3) që janë: numri i ditëve të kaluara nga data e kështit të kredisë, vështirësi të rëndësishme financiare të huamarrësit, prishje të kontratës, shmangie të pagesave, falimentim i huamarrësit ose riorganizim financiar, ekzistenca e kolateralit, të garantuesit etj. Bazuar në pyetësin e Bankës Botërore (2011-2012), vlerësohet se numri i minimal i ditëve për klasifikimin e një kredie si kredi nënstandarte varion nga 60 deri 90 ditë, ndërsa kufiri minimal për një kredi të dyshimtë është 90 ditë.

**Tabela 3: Numri i ditëve të vonesave për ta klasifikuar kredinë në kategoritë e mëposhtme.**

	Nën-standart	E dyshimtë	E humbur
<b>Shqipëria</b>	61-90	91-180	>180
<b>Bosnja-Hercegovinia</b>	90-180	181-270	>271
<b>Kroacia</b>	181-270	271-365	>365
<b>Kosova</b>	61-90	91-180	>180
<b>Maqedonia</b>	61-120	121-240	>241
<b>Mali i Zi</b>	91-270	271-364	>365
<b>Serbia</b>	60-90	91-180	>180
<b>Austri</b>			90
<b>Francë</b>		90	
<b>Greqi</b>			
<b>Itali</b>	151		

*Burimi:* D'Hulster et. al., (2014).

Vihet re se pjesa më e madhe e shteteve, (6 nga 7 shtete) përdorin kryesisht si kriter për klasifikimin e kredive në kredi të këqija; numrin e ditëve vonesave, vështirësitë financiare në të cilën ndodhet huamarrësi, si dhe mundësinë e falimentimit të tij.

Një tjetër element që merret në konsideratë në klafikimin e kredive sipas klasave ka të bëjë me ristrukturimin e kredive apo të shtyerjes në kohë të pagesave të kredisë. Një ristrukturim i kredisë kërkon që ajo të shikohet si një kredi me një rrezik të shtuar dhe nuk duhet të klasifikohet si një kredi e rregullt. Zakonisht një kredi quhet e ristrukturuar nëse kemi: a) ndryshim të termave të kontratave dhe b) vështirësi financiare të huamarrësit. Çdo ristrukturim që vjen si rezultat i arsyeve të tjera nuk do të merret parasysh.

Falimentimi i një banke, si dhe pasojat e falimentimit të bankës influencojnë jo vetëm konsumatorët dhe bizneset që kanë vendosur fondet apo që kanë investuar kapitalin e tyre në këto banka, por ka ndikim negativ edhe në tregun e brendshëm, madje në disa raste edhe në tregun ndërkombëtar. Megjithëse vetë rregulloret e bankave nuk mund që të parandalojnë falimentimin, aplikimet e një manaxhimit të mirë të rrezikut kombinuar edhe me mbajtjen e nivelit të përshtatshëm të kapitalit mund të ndikojnë në uljen e ndodhjes së ngjarjeve të tilla.

**Tabela 4: Kriteret e klasifikimit të kredisë si kredi të këqija.**

	Numri i ditëve të kaluara nga data e kështit të kredisë	Vështirësi të rëndësishme financiare të huamarrësit	Prishje të kontratës	Shmangie të pagesave	Falimentim i huamarrësit ose riorganizim financiar	Ekzistenca e kolateralit, të garantuesit
Shqipëria	x	x			x	
Bosnja-Hercegovinia	x	x	x	x	x	x
Kroacia	x	x	x	x	x	x
Kosova	x	x	x	x	x	x
Maqedonia	x					
Mali i Zi	x	x	x	x	x	x
Serbia		x	x		x	
<b>Numri total I shteteve</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>4</b>

Burimi: D'Hulster et. al., (2014).

Mbikqyrësit bankarë për një kohë të gjatë kanë kërkuar që bankat të mbajnë një nivel të caktuar kapitali të nevojshëm për të mbuluar të gjitha rreziqet e mundshme. Në 1988, Komiteti i Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare ranë dakord mbi “*International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards*” të njohur gjerësisht si Dakortësia e Bazelit mbi Kapitalin, (*Basel Capital Accord*). Implementimi i plotë në vitin 1992 bëri që Dakortësia e Bazelit mbi Kapitalin, (*Basel Capital Accord*) të fusi në mekanizmin e bankave, regjimin e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit bazuar në analizën e ndjeshmërisë së rrezikut. Më shumë se një dekadë më vonë, pas evoluimit të sistemit bankar nëpër botë, bëri që Komiteti i Bazelit të ndërmarrë dhe të revizionojë Akordin e vendosur në vitin 1988, për të futur në fuqi Bazel II-shin. Propozimi për ndryshimet e Bazel I dhe kalimi në Bazel II ishte bërë që në vitin 1999, por aplikimi i tij nga shumë vende të botës u bë në fund të vitit 2008. Basell II është një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila rishikoi në detaje procesin e mbikëqyrjes bankare duke bërë që llogaritja e kapitalit minimal të bankave të llogaritet në përputhje me profilin e rrezikut të tyre, si dhe duke inkurajuar disiplinën e tregut nëpërmjet hapjes së informacioneve sekrete.

Vendet anëtare të BCBS, (*Basel Committee on Bank Supervision*) tentuan të adaptonin Bazel II në vitet 2007 dhe 2008, megjithatë janë evidentuar divergjenca për sa i përket bankave dhe grupeve të bankave që aplikuan Bazel II. Mbas publikimit të Bazel II u intensifikuan përpjekjet e vendeve për të aplikuar standardet e vendosura nga Bazel II, pavarësisht faktit që bankat nëpër botë ishin të ndryshme qoftë në përmasa, në sofistikim apo në kompleksitetin që mbartin. Ky diversitet i bankave bëri që strukturat e mbikëqyrjes në vende të ndryshme të aplikonin regjime të ndryshme mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit, por kryesisht pjesa pjesa më e madhe e vendeve u udhëhoqën nga aplikimi i metodave më të thjeshta .

Në vendet jo-anëtare të BCBS, (*Basel Committee on Bank Supervision*) implementimi i Bazel II u ndikua nga disa faktorë. Kështu implementimi i një përqsaje më komplekse dhe më të ndjeshme ndaj rrezikut nuk ishte e përshtatshme bazuar në kapacitetet mbikëqyrëse të vendit, si dhe në strukturën ligjore dhe rregullative të tyre. Kjo pasi zbatimi i Bazel II kërkonte një rregullore të mirë-konsoliduar për kapitalin, një mbikqyrje të kujdesshme dhe një disiplinë të tregut, e cila inkurajon manaxhimin e rrezikut dhe mbështet stabilitetin financiar.

Në dhjetor të 2010, Komiteti i Bazelit mbas krizës së fundit financiare propozoi implementin e Bazel III. Qëllimi i kësaj pakete ishte forcimi i rregullave globale mbi kapitalin dhe likuiditetin të bankave, me qëllim ndërtimin e një sistemi bankar të shëndetshëm për të absorbuar goditjet financiare dhe stresin ekonomik, si dhe reduktimin e rreziqeve nga sektori financiar drejt sektorit real. Nga ana tjetër kjo paketë e re masash do të shërbejë për të përmirësuar manaxhimin e rrezikut dhe qeverisjen e bankave, si dhe për të forcuar sistemin e rezolutës së bankave sistematike ndërkufitare. Një sistem bankar i shëndetshëm dhe i fortë është i domosdoshëm për një rritje ekonomike të qëndrueshme, pasi bankat janë një element i rëndësishëm i procesit të ndërmjetësimit midis investitorëve dhe kursimtarëve.

Kriza e fundit financiare nxorri në pah problematikën e krijuar nga sektori bankar, ku niveli i lartë i kreditimit u shoqërua me rënie të vlerës dhe cilësisë së kapitalit dhe me një pamjaftueshmëri të likuiditetit nga ana e bankave. Kjo bëri që bankat të mos ishin në gjendje që të absorbonin rrezikun e krijuar, duke shkaktuar një humbje të konfidencës të sistemit bankar dhe transmetimit të kësaj pasigurie në pjesën tjetër të sistemit financiar dhe të ekonomisë reale, e cila rezultoi në një kontraktim të likuiditetit dhe të kredisë. Efekti i krizës financiare pati një përhapje të gjerë në shumë vende të botës, shoqëruar me efekte të raundit të dytë, duke bërë që vendet të ndërgjegjësoheshin për shpejtësinë dhe impaktin që kanë krizat financiare në ekonomi.

Kështu për të adresuar çështjet e falimentimit të sistemit bankar në botë, Komiteti i Bazelit mori në konsideratë futjen e një numri të caktuar reformash për të forcuar dhe për ta bërë më të shëndetshëm sistemin bankar, mbështetur në politikat mikroprudenciale dhe ato makroprudenciale. Komiteti i Bazelit vendosi për një forcim të rregullores mbi kapitalin bazuar në tre shtyllat kryesore të Bazel II, reforma këto që synojnë të rrisin cilësinë dhe sasinë e kapitalit rregullator dhe forcojnë mbulimin e rrezikut që rezulton nga struktura e kapitalit. Për më tepër futja e elementëve makroprudencialë ndihmon për të mbajtur rrezikun sistematik që rrjedh nga prociklikaliteti dhe nga ndërlidhjet midis sistemeve financiare. Implementimi i plotë i Basel III nga ana e bankave do të mbarojë në fund të vitit 2019.

## KAPITULLI 3

### METODOLLOGJIA, TË DHËNAT DHE REZULTATET EMPIRIKE

---

#### 3.1. Metodologjia

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të testojë empirikisht faktorët përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë në sektorin bankar shqiptar. Literatura teorike dhe empirike sygjeron që provigjionimi i humbjeve nga huatë përbëhet nga dy komponentë që janë: *komponenti jo-diskrecionar* dhe *komponenti diskrecionar*.

Ashtu siç e përmendëm edhe në fillim, *komponenti jo-diskrecionar* i provigjionimit të humbjeve nga huatë ka për qëllim që të mbulojë humbjet e pritshme dhe rrezikun e kredisë të portofolit të bankës. Në përputhje me Bouvatier dhe Lepetit, (2008) si tregues kryesorë për të përshkruar *komponentin jo-diskrecionar* të provigjionimit të humbjeve nga huatë është marrë: norma e kredive me probleme ndaj totalit të kredisë, ( $NPL_{i,t}$ ) dhe diferenca e parë të raportit të kredive me probleme ( $DNPL_{i,t}$ )<sup>10</sup>. Të dy këta tregues shërbejnë për të matur rrezikun e kredisë së bankave. Teorikisht pritet një lidhje pozitive dhe statistikisht e rëndësishme midis këtyre dy treguesve dhe provigjionimit të humbjeve nga huatë, ( $LLP$ ). Për më tepër kemi përfshirë në modelin bazë si tregues shpjegues edhe raportin e kredive ndaj totalit të aktiveve,  $Loan\_rate_{i,t}$ , i cili shërben për të matur humbjet e pritshme nga huatë. Edhe midis këtij treguesi dhe  $LLP$  (provigjionimit të humbjeve nga huatë) presim një lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme.

*Komponenti diskrecionar* i provigjionimit të humbjeve nga huatë, rezulton nga tre objektiva të ndryshëm manaxheriale që janë: zbutja e të ardhurave (*income smoothing*), manaxhimi i kapitalit dhe sjellja e sinjalizimit.

Sipas teorisë së zbutjes së të ardhurave (*income smoothing*) bankat tentojnë të rrisin (ulin) provigjionimin e humbjeve nga huatë, kur fitimet pritet që të rriten (ulen). Një lidhje pozitive midis fitimeve dhe provigjionimit të humbjeve nga huatë tregon që

---

<sup>10</sup>ku  $(DNPL_{i,t}) = NPL_{i,t} - NPL_{i,t-4}$



bankat përdorin provigjionet për të zbutur të ardhurat. Ndërsa, një lidhje negative midis këtyre dy treguesve tregon për sjellje prociklike të provigjionimit të humbjeve nga huatë. Ashtu si Leaven dhe Majnoni (2003), Biker dhe Metzmakers (2005), Bouvatier dhe Lepetit, (2008), Skala (2014) kemi përdorur fitimet (të ardhurat) para interesave, taksave dhe provigjioneve ndaj totalit të aktiveve ( $EBTP_{i,t}$ ), si tregues për të testuar hipotezën e zbutjes së të ardhurave.

Për më tepër, ashtu si Biker dhe Metzmakers, (2005), Bouvatier dhe Lepetit, (2008) kemi përdorur normën e kapitalit ndaj totalit të aktiveve për të testuar hipotezën e manaxhimit të kapitalit në rastin e bankave në Shqipëri. Bankat me një nivel të ulët të kapitalit mund të përdorin provigjionet për të krijuar një nivel më të lartë rezerve. Një lidhje negative midis normës së kapitalit ndaj totalit të aktiveve dhe provigjionimit të humbjeve nga huatë mbështet hipotezën e manaxhimit të kapitalit. Nga ana tjetër, Ahmed et. al., (1999) pohon që kjo lidhje negative reflekton faktin që bankat që marrin përsipër më shumë rrezik kanë norma më të ulta kapitali. Në mënyrë që të testojmë hipotezën e manaxhimit të kapitalit kemi përdorur devijancën e normës së mjaftueshmërisë së kapitali ndaj 12 përqindëshit, pjestuar me 12 përqind,  $CAP_{i,t}$ . Sa më e lartë të jetë vlera e këtij indeksi aq më e mirë kapitalizuar është banka.

Nga ana tjetër, provigjionimi i humbjeve nga huatë mund të përdoret për të sinjalizuar fortësinë financiare të bankave. Norma e pritshme të rritjes së fitimeve para interesave, taksave dhe provigjioneve është përdorur për të testuar sjelljen sinjalizuese të bankave,  $SIGN^{11}_{i,t}$ . Një lidhje pozitive midis këtij treguesi dhe  $LLP$ -së konfirmon hipotezën që bankat përdorin provigjionimin e humbjeve nga huatë për të sinjalizuar fortësinë e tyre financiare,

Norma reale vjetore e rritjes së PBB-së,  $GDP\_g_{i,t}$  është përfshirë në model për të marrë në konsideratë impaktin makroekonomik në sjelljen e provigjioneve. Një lidhje pozitive midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe normës reale të rritjes së PBB-së tregon për një sjellje kundërciklike të bankave në krijimin e provigjionive. Një sjellje e tillë bën që bankat të përfitojnë nga kushte më të mira ekonomike për të rritur rezervat e tyre të provigjionimit, (Leaven dhe Majnoni, 2003). Ndërsa një lidhje

---

<sup>11</sup>Ku  $SIGN_{i,t} = \frac{(EBTP_{i,t+4} - EBTP_{i,t})}{EBTP_{i,t}}$

negative midis këtyre dy treguesve tregon për sjelljen prociklike të bankave në lidhje me ciklin e biznesit, duke bërë që bankat të krijojnë më shumë provigjione gjatë periudhave të rënies ekonomike.

Për të vlerësuar empirikisht faktorët përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë në rastin e Shqipërisë ne kemi përdorur përqasjen e propozuar nga Bouvatier dhe Lepetit, (2008) dhe Packer dhe Zhu, (2012) të paraqitur si më poshtë:

$$\begin{aligned}
 LLP_{i,t} = & \alpha_0 + \alpha_1 LLP_{i,t-1} + \alpha_2 EBTP_{i,t} + \alpha_3 NPL_{i,t} \\
 & + \alpha_4 DNPL_{i,t} + \alpha_5 Loan_{rate_{i,t}} + \alpha_6 CAP_{i,t} \\
 & + \alpha_7 SIGN_{i,t} + \alpha_8 GDP\_g_{i,t} + u_{i,t}
 \end{aligned} \tag{1}$$

Kështu shkronjat  $i$  dhe  $t$ , përfaqësojnë përkatësisht bankat dhe tremujorin, ndërsa  $u_{i,t}$  përfaqëson termat e gabimit.

Variabli i varur është  $LLP_{i,t}$ , që përfaqëson nivelin e provigjionimit të humbjeve nga huatë për secilin bankë në tremujorin  $t$ , të shprehura si raport ndaj totalit të aktiveve. Për më tepër për të marrë në konsideratë axhustimin dinamik të LLP-së, kemi përfshirë në model si tregues shpjegues edhe variablin e varur LLP me një vonesë kohore.

Ndërsa për të parë më shumë në lidhje me *komponetin jo-diskrecionar* të bankave, ashtu si edhe Leaven dhe Majnoni, (2003), Fonseca dhe Gonzales, (2008), Skala, (2014) kemi modifikuar ekuacionin e parë, duke përfshirë në model normën vjetore të rritjes së kredisë, si më poshtë (ekuacioni 2).

$$\begin{aligned}
 LLP_{i,t} = & \alpha_0 + \alpha_1 LLP_{i,t-1} + \alpha_2 EBTP_{i,t} + \alpha_3 Loan_{g_{i,t}} \\
 & + \alpha_4 Loan_{rate_{i,t}} + \alpha_5 CAP_{i,t} + \alpha_6 SIGN_{i,t} \\
 & + \alpha_7 GDP\_g_{i,t} + u_{i,t}
 \end{aligned} \tag{2}$$

Norma vjetore e rritjes së kredisë përdoret për të parë nivelin e ekspozimit apo të specializimit të secilës nga bankat drejt kreditimit. Ky tregues përdoret për të shpjeguar pjesën jo-diskrecionare të provigjionimit të humbjeve nga huatë. Sipas Fonseca dhe Gonzales, (2008) një lidhje pozitive midis  $LLP_{i,t}$  dhe rritjes vjetore të

kredisë,  $Loan_{i,t}$  tregon që bankat janë larg-pamëse (*forward-looking*) në lidhje me politikat e tyre të krijimit të provigjioneve. Kështu, bankat krijojnë më shumë provigjione gjatë kohës kur kemi një rritje më të madhe të kreditimit, duke i paraprirë në këtë mënyrë rritjes së mëtejshme të kredive të këqija. Ndërsa, sipas Leaven dhe Majnoni, (2003), një lidhje negative e provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe rritjes së kredisë, tregon një politikë jo të kujdesshme të ndjekur nga bankat në lidhje me krijimin e provigjioneve.

Për të vlerësuar ekuacionin 1 dhe 2 jemi mbështetur tek analiza dinamike e të dhënave në panel, Metoda e Përgjithshme e Momenteve, (*Generalized Method of Moments*, GMM) më konkretisht, modelin e diferencës së parë të propozuar nga Arellano-Bond, (1991).

Metoda *GMM* paraqet një vlerësim alternativ për të dhënat në panel dhe është një metodë më efiçente përkundrejt metodave të tjera në prezencën e heteroskedasticitetit dhe korrelacionit serial. Për më tepër metoda e *GMM*-së rekomandohet të aplikohet dhe jep rezultate më efiçente sesa vlerësimi i paneleve me efekte fikse dhe rastësore, nëse nuk plotësohet kushte i ekzogjenitetit të plotë për treguesit shpjegues. Ky kusht nënkupton që vlerat e treguesve të pavaruar mund të jenë të korreluar me vlerat e kaluara dhe mundësisht me vlerat aktuale të gabimeve.

Vlerësimet e paneleve dinamikë propozuar nga Arellano dhe Bond, (1991) dhe Arellano-Bover,(1995) dhe Blundell-Bond, (1998) janë dizenuar për situata në të cilin kemi: (1) një numër të vogël  $T$ , dhe një panel të madh,  $N$  që nënkupton një numër të paktë të kohës dhe shumë agjentë (banka, individë, firma); (2) një lidhje lineare funksionale; (3) ku në anën e majtë të ekuacionit kemi prezencën me vonesë kohore të treguesit të varur; (4) ku treguesit shpjegues ose të pavarur nuk janë plotësisht ekzogjenë, që do të thotë që vlerat e tyre mund të jenë të korreluara me vlerat e kaluara të tyre dhe mundësisht me vlerat aktuale të termave të gabimeve; (5) kemi efekte fikse individuale dhe (6) kur kemi heteroskedasticitet dhe autokorrelacion brenda njësisive (apo individëve) por jo ndërmjet tyre.

Vlerësimi i Arellano-Bond fillon duke bërë transformimin e të gjithë regresevë, zakonisht duke i diferencuar dhe përdor Metodën e Përgjithshme të Momenteve (*GMM-Genelazed Method of Moments*) të Hansen, (1982) e quajtur Diferenca e

GMM. Ndërsa vlerësimi i marrë nga Arellano-Bover, (1995) dhe Blundell-Bond, (1998) e përmirëson metodën e propozuar nga Arellano dhe Bond, (1991) duke bërë një supozim shtesë, që diferenca e parë e variablave instrumentale janë të pakorreluar me efektet fikse. Kjo mënyrë vlerësimi lejon përfshirjen e më shumë instrumentave, të cilit përmirësojnë ndjeshëm eficiencën e këtyre vlerësimeve. Kështu kjo metodë bazohet në krijimin e një sistemi me dy ekuacione, ekuacioni bazë dhe ekuacioni i transformuar, i njohur edhe si *Sistemi GMM*. Në mënyrë të përgjithshme, një model dinamik me efekte fikse ka formën e mëposhtme:

$$y_{i,t} = \alpha y_{i,t-1} + X'_{it}\beta + \eta_i + \varepsilon_{i,t} \quad (3)$$

Ku  $\eta_i$  përfaqëson efektin fiks,  $X'_{it}$  është një vektor me  $(K - 1) \times 1$  tregues ekzogjenë dhe  $\varepsilon_{i,t} \sim N(0, \sigma_\varepsilon^2)$  ka shpërndarje rastësore (*random*). Ne supozojmë që:

$$\begin{aligned} \sigma_\varepsilon^2 &\geq 0 \\ E[\varepsilon_{i,t}, \varepsilon_{j,s}] &= 0 \quad \text{ku } i \neq j \text{ ose } t \neq s \\ E[\eta_t, \varepsilon_{j,t}] &= 0, \text{ për cdo } i, j, t \\ E[x_{i,t}, \varepsilon_{j,s}] &= 0, \text{ për cdo } i, j, t, s \end{aligned} \quad (4)$$

Modeli i paraqitur në ekuacionin 3, ka në përbërjen e tij, variablin e varur me një vonesë kohore. Vlerësimi i këtij ekuacioni me anë të metodës së katrorëve më të vegjël me efekte fikse gjeneron vlerësime të njëanshme të koeficientëve, sidomos kur dimensionimi kohor i panelit është i vogël Nickell, (1984).

Anderson dhe Hsiao, (1981) propozuan vlerësimin e ekuacionit 3 me anë të treguesve instrumentale. Kështu për të hequr efektet fikse, autorët e lartpërmendur diferencuan ekuacion 3 duke marrë ekuacionin 5 si më poshtë:

$$(y_{i,t} - y_{i,t-1}) = \gamma(y_{i,t-1} - y_{i,t-2}) + (x_{i,t} - x_{i,t-1})'\beta + (\varepsilon_{i,t} - \varepsilon_{i,t-1}) \quad (5)$$

Në ekuacionin e diferencuar, termi i gabimit  $(\varepsilon_{i,t} - \varepsilon_{i,t-1})$  është i korreluar me një nga variablat e pavarur  $(y_{i,t-1} - y_{i,t-2})$ . Anderson dhe Hsiao, (1981) rekomandojnë

përdorimim e  $(y_{i,t-1} - y_{i,t-2})$  ose të  $y_{i,t-2}$  ose të  $(y_{i,t-2} - y_{i,t-3})$  si variabla instrumentale, të cilat janë të pakorreluar me termin e gabimit të paraqitur në ekuacionin 3, por të korreluar me  $(y_{i,t-1} - y_{i,t-2})$ . Arellano dhe Bond (1991) dhe Kiviet (1995) kanë konfirmuar superioritetin që ka përdorimi i variablave (në nivel) me vonesë kohore si variabla instrumentale. Në një panel me dimensionet  $N \times T$ , vlerësimi i marrë nga Anderson-Hsiao, (AH) paraqitet si më poshtë:

$$\delta_{AH} = (Z'X)^{-1}Z'Y \quad (6)$$

Ku  $Z$  është matrica e instrumentave, me përmasat  $K \times N(T-2)$ ,  $X$  është matrica e variablave shpjegues me përmasat  $K \times N(T-2)$  dhe  $Y$  është vektori i variablës të varur me përmasat  $N(T-2) \times 1$ . Le të jetë  $\Delta y_{it} = y_{it} - y_{it-1}$ , paraqitja matricore e vlerësimit AH do të jepej si më poshtë:

$$Z_t = \begin{bmatrix} y_{i,1} & \Delta x_{i,3} \\ \vdots & \vdots \\ y_{i,T-2} & \Delta x_{i,T} \end{bmatrix} \quad X_t = \begin{bmatrix} \Delta y_{i,2} & \Delta x_{i,3} \\ \vdots & \vdots \\ \Delta y_{i,T-1} & \Delta x_{i,T} \end{bmatrix} \quad Y_i = \begin{bmatrix} \Delta y_{i,3} \\ \vdots \\ \Delta y_{i,T} \end{bmatrix} \quad (7)$$

$$Z = \begin{bmatrix} Z_1 \\ \vdots \\ Z_N \end{bmatrix} \quad X = \begin{bmatrix} X_1 \\ \vdots \\ X_N \end{bmatrix} \quad Y = \begin{bmatrix} Y_1 \\ \vdots \\ Y_N \end{bmatrix} \quad (8)$$

Vlerësimi i Anderson-Hsiao(AH) mund të konsiderohet si një rast i veçantë i vlerësimit  $GMM$ , që ashtu si vlerësimi AH eliminon efektet fikse të ekuacionit duke diferencuar ekuacionin (2) për të marrë ekuacionin 5. Por në ndryshimin nga vlerësimi AH, procedura e vlerësimit e  $GMM$  është më efektive pasi vë në përdorim informacionin nga momente të tjera, pra si variabla instrumentale përdoret jo vetëm variabli i varur dhe vonesat kohore të tij, por edhe vonesat kohore të variablave shpjegues. Në mënyrë matricore, vlerësimi i marrë nga  $GMM$  paraqitet si më poshtë:

$$\delta_{GMM} = (X'Z^*A_NZ^{*'})^{-1}X'Z^*A_NZ^{*'}Y \quad (9)$$

Ku  $X$  dhe  $Y$  janë përcaktuar si më lart, ku  $Z_i^*$  është një bllok diagonal matrice, ku blloku i  $s^{të}$  jepet nga  $(y_{i1} \dots y_{is} x_{i1} \dots x_{i(s+1)})$  për cdo  $s=1, \dots, T-2$ , atëherë  $Z^* = (Z_1^*, \dots, Z_T^*)'$ . Duke qenë se kemi dy mundësi zgjedhjeje për  $A_N$  na bën që të kemi dy vlerësime për  $GMM$ . Vlerësimi me një-hap përcaktohet duke përdorur :

$$A_N = \left( \frac{1}{N} \sum_i^N Z_t^{*'} H Z_t^* \right)^{-1} \quad (10)$$

Ku  $H$  është një matricë katrore  $T-2$  me dyshat që janë në diagonalen kryesore, minus 1 që janë në nëndiagonalen e parë, dhe zero në pjesën tjetër. Ndërsa një  $GMM$  me dy-hapa përcaktohet nga një matricë  $A_N$  si më poshtë:

$$A_N = \left( \frac{1}{N} \sum_i^N Z_t^{*'} \Delta \hat{\epsilon}_i \Delta \hat{\epsilon}_i' Z_t^* \right)^{-1} \quad (11)$$

Ku  $\Delta \hat{\epsilon}_i = (\Delta \hat{\epsilon}_{i3}, \dots, \Delta \hat{\epsilon}_{iT})$  janë gabimet e marra nga një vlerësim konsistent i  $GMM$  –së me një-hap të  $\Delta y_i$ .

### 3.2 Fakte të stilizuara mbi sistemin bankar në Shqipëri

Para vitit 1990, ekonomia shqiptare ishte një ekonomi plotësisht e centralizuar. Sistemi bankar shqiptar ishte bazuar vetëm në një nivel dhe përbëhej nga; Banka e Shtetit Shqiptar, Banka e Kursimeve dhe Banka Agrare. Banka e Shtetit Shqiptar ishte autoriteti i vetëm monetar dhe huadhënës, Banka e Kursimeve mblidhte depozita dhe Banka Agrare jepte fonde sektorit agro-kulturor.

Cani dhe Hadëri, (2002) duke analizuar sektorin bankar në Shqipëri kanë evidentuar se para vitit 1990, ky sektor ofronte një numër të kufizuar produktesh dhe shërbimesh bankare, nuk kishte praktika të mirëfillta të vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe të manaxhimit të tij, si dhe kishte mungesa të përvojës në praktikat ndërkombëtare dhe bashkëkohore të qeverisjes dhe manaxhimit bankar. Këto mungesa ishin si këmbana alarmi për sistemin financiar në Shqipëri, i cili mbas rënies së komunizmit në fillim të

vitet 1990 pësoi ndryshime të rëndësishme me qëllim sigurimin e stabilitetit makraekonomik të vendit.

Ibrahimi dhe Salko, (2001) evidentojnë se hapat e parë të rëndësishëm që u ndërmorën për reformin e sistemit financiar ishte implementimi me dy nivele i sistemit bankar. Ku krijimi i Bankës së Shqipërisë, si autoriteti i vetëm monetar në përputhje me të gjitha standartet ndërkombëtare u vendos me anë të ligjit numër 7559, “Mbi Bankën e Shqipërisë” dhe u përpilua ligji “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”. Sektori bankar megjithëse në fillimet e veta ka vepruar në një mjedis jo mirë të konsoliduar, ka pasur një tendencë rritjeje që nga viti 1992. Në vitin 1994, sistemi bankar shqiptar ishte i përbërë nga vetëm 6 banka me një vlerë aktivesh afërsisht 146,2 milion dollarë amerikanë, që përbënin 79 % të totalit të PBB-së.

Në fund të vitit 1996 Banka e Shqipërisë liçensoi edhe pesë banka të tjera, kur për herë të parë vihet re prezenca e bankave të huaja në sistemin bankar shqiptar. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, sistemi financiar vuante nga një sërë problemesh ligjore dhe rregullative të trashëguara nga regjimi i kaluar. Ishte pikërisht kriza e vitit 1997, shkaktuar nga falimentimi i skemave piramidale, e cila nxorri në pah problematikat e mësipërme, të cilat rënduan aspektin ekonomik dhe social të vendit. Viti 1998 mund të konsiderohet si një vit, ku u bënë ndryshime të rëndësishme cilësore në përmirësimin e përqaqjes rregullative të mbikëqyrjes bankave, si dhe në ekzaminimin e bankave apo të degëve të bankave të huaja që vepronin në Shqipëri. Ndryshime këto që erdhën në linjë edhe me zhvillimet e sektorit bankar në Shqipëri, por gjithashtu edhe në linjë me principet bazë mbi një mbikëqyrje efektive të Komitetit të Bazelit publikuar në shtator të vitit 1997. Në këto kushte ligji “Mbi Bankën e Shqipërisë” dhe “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë” pësoi ndryshime të rëndësishme, që kishin si qëllim rritjen e pavarësisë së Bankës së Shqipërisë, si autoriteti i vetëm monetar dhe mbikëqyrës, por njëkohësisht dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit bankar.

Gjatë vitit 2003, sektori bankar përjetoi ndryshime të rëndësishme që u shoqëruan me hyrjen e dy bankave të reja, si dhe me fillimin e procesit të privatizimit të bankës më të madhe të vendit. Privatizimi i ish-Bankës së Kursimeve në 2004, i shoqëruar edhe

me implementimin e reformave të ndryshme strukturore, sollti rritjen e prezencës së bankave të huaja, në rritje të produktivitetit dhe të konkurrencës në sektorin bankar, duke e kthyer atë në burimin kryesor të fondeve në ekonomi.

Deri në fund të vitit 2014, bankat në Shqipëri kanë vepruar nën regjimin e Bazel I, ndërsa që nga 1 janar i vitit 2015, me hyrjen në fuqi të rregullores “Për raportin e mjaftueshmerisë së kapitalit”, bankat do të operojnë nën rregullat e vendosura sipas përjasjes standarte të Bazel II. Me anë të këtij akti të ri bankat e sistemit synojnë përshtatjen e metodave standarde për rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional, me qëllim adresimin më të mirë të nevojave bankave për kapital dhe monitorimin e mëtejshëm të këtyre rreziqeve. Tre shtyllat kryesore në të cilat mbështetet Bazel II dhe implementimi i tij në Shqipëri janë:

*Shtylla e 1* është e lidhur me kriteret minimale të kapitalit që çdo bankë duhet të mbajë për të mbuluar ekspozimet ndaj rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut dhe atij operacional. *Shtylla e 2* merret me rishikimet e mbikëqyrjes që ka si qëllim sigurimin e nivelit të mjaftueshëm të kapitalit për të mbuluar të gjithë rrezikut. Ndërsa *Shtylla e 3* lidhet me disiplinën e tregut, si dhe detajon nivelet minimale të deklarimit të informacionit ndaj publikut.

Nëpërmjet *Shtyllës së Parë*, asaj të përcaktimit të kapitalit, është vendosur që bankat duhet ta mbajnë nivelin e kapitalit sa 12 % të totali të aktiveve të peshuara me rrezik, me qëllim që të mbulojë rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe atë operacional. Banka e Shqipërisë do të implementojë përjasjen standarte të Bazel II, ku peshimi i rrezikut bëhet sipas tipeve të ndryshme të aktiveve në mënyrë që të theksohet sensitiviteti i rrezikut krahasuar me atë të Basel I. Një ndër shqetësimet kryesore në këtë fazë ka të bëjë me Agjensitë e Ratingut, si dhe me konsiderimin e letrave me vlerë të qeverisë jo me rrezik zero, por me një peshë rreziku nga 0-150 %. Përsa kohë që rreziku i borxhit të qeverisë nuk është i rankuar, atëherë pjesa më e madhe e kësaj kategorie të borxhit do të vlerësohet 100 %. Kjo do të çojë bankat në një situatë që do të rrisë kapitalin e rialokuar me qëllim që të përmbushë kërkesat për normën e mjaftueshmërisë së kapitalit. Ndërsa rreziku i tregut, që nënkupton mbajtjen e një niveli të kapitalit rregullator për të mbuluar këtë rrezik paraqet sfidë për të ardhmen.



Kjo pasi sistemi financiar në Shqipëri është i zotëruar nga bankat dhe mungon një treg kapitali, ku të bëhet e mundur shitja dhe blerja e letrave me vlerë përveç atyre të qeverisë. Gjithashtu mospërpuethshmëria e Standartave Ndërkombëtare të Kontabiliteti me ato të Standarteve Aktuale Kombëtare përbën një çështje që duhet të marrë në konsideratë në të ardhmen për shkak të mungesës së ekspertizës në sektorin financiar në Shqipëri.

*Shtylla e Dytë*, që ka të bëjë me procesin e rishikimit të mbikëqyrjes synon që bankat ta mbajnë kapitalin të paktën në nivelin e kapitalit rregullator. Gjithashtu bankave u kërkohet që të marrin masa për forcimin e manaxhimit më të mirë të rrezikut ose të praktikave të tjera, duke bërë që ata të performojnë ushtrime të rezistencës ndaj rrezikut apo goditjeve të tjera reale apo financiare, me qëllim që të sigurohet mbajtja e një niveli të caktuar të kapitalit rezervë nga ana e bankave.

*Shtylla e 3* vendos disa kërkesa mbi hapjen e tregut, që i lejon të gjithë pjesëmarrësit në treg që të aksesojnë pjesë kyç të informacionit që kanë bëjnë me kapitalin, ekspozimin e rrezikut, procesin e vlerësimit të rrezikut, si dhe normën e mjaftueshmërisë së kapitalit. Ekspozimi i referohet në këtë mënyrë informacionit të vlefshëm publik mbi aktivitetin e kompanisë, procesin e vlerësimit të rrezikut dhe mjedisit. Kështu hapja apo ekspozimi përfshin si informacion cilësor, ashtu edhe informacion sasior. Për shembull pasqyrat financiare të institucioneve, si bilanci dhe pasqyra e të ardhurave japin një informacion të plotë sasior mbi kompanitë. Ndërsa informacioni cilësor përfshin informacion kryesisht mbi modelin e biznesit të kompanive, strategjinë e manaxhimit etj. Hapja e informacionit shërben si një mënyrë për të zgjidhur problemet që rezultojnë nga asimetria e informacionit.

Për bankat në Shqipëri, përcaktimi i nivelit të provigjionimit të humbjeve nga huatë bëhet mbi bazën e rregullores “*Mbi administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e huaja të bankave*”, Nr.62 miratuar nga Banka e Shqipërisë më datë 14/09/2011. Klasifikimi i kredisë nga bankat, bëhet të paktën një herë në tre muaj sipas kategorive në: kredi standarte, kredi në ndjekje, kredi nënstandarte, kredi të dyshimta dhe kredi të humbura. Klasifikimi sipas këtyre kategorive bëhet në bazë të gjendjes financiare të kredimarrësit dhe flukseve hyrëse të tij, shumës së përdorur të kredisë, si dhe të afatit të vonesave të pagesave. Kredia quhet kredi me probleme nëse

klasifikohet në tre kategoritë e fundit të klasifikimit të kredive pra kredi nënstandarte, kredi e dyshimtë dhe kredi e humbur, ndërsa kufiri minimal i shlyerjes së pagesave është 61 deri në 90 ditë.

Në varësi të kategorive të klasifikimit, bankat krijojnë fondet përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela 5: Fondet rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë.**

Klasifikimi i kredisë	Fondet rezervë të krijuara
a) kategoria “standarde”	1 (një) për qind
b) kategoria “në ndjekje”	5 (pesë) për qind
c) kategoria “nënstandarde”	jo më pak se 20 (njëzet) për qind
d) kategoria “e dyshimtë”	jo më pak se 50 (pesëdhjetë) për qind
e) kategoria “e humbur”	100 (njëqind) për qind

*Burimi:* Banka e Shqipërisë, (2015).

Për kreditë e klasifikuara në shkronjat “a” dhe “b”, norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë do të përcaktohet njëllor si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kredinë me probleme, norma e aplikuar mbi interesin e përlllogaritur do të jetë 100 % (njëqind për qind) për çdo kategori.

Bankat, bazuar në madhësinë e humbjeve të llogaritura sipas standardeve të kontabilitetit, klasifikojnë aktivet e tjera si më poshtë:

- a) “standarde ose të rregullta”, kur madhësia e humbjeve të llogaritura është deri në 5% (pesë për qind) të ekspozimit;
- b) “të dyshimta ose me probleme”, kur madhësia e humbjeve të llogaritura është më e madhe se 5% (pesë për qind) e ekspozimit.
- c)

Gjithashtu bankat krijojnë fonde rezervë për mbulimin në mënyrë të plotë të humbjeve nga zhvlerësimi i aktiveve të tjera

Në vazhdim do të paraqesim një përmbledhje të zhvillimeve kryesore të aktivitetit bankar shqiptar gjatë periudhës 2004-2014.

Sistemi financiar në Shqipëri është një sistem relativisht i ri, i cili ka shfaqur një dinamikë të lartë në 20 vitet e fundit, sikurse edhe në shumë vende të tjera në Evropës Qendrore-Juglindore, që erdhën nga një ekonomi e centralizuar. Këto dinamika janë shfaqur si në drejtim të thellimit të ndërmjetësimit financiar, nëpërmjet ofrimit të produkteve të shumta dhe të sofistikuara, si edhe me rritjen e prezencës së aktorëve të rinj në treg, duke ndikuar në rritjen e eficiencës dhe prezencës së sektorit financiar në ekonomi mbas vitit 1992.

Në tabelën e mëposhtme është prezantuar pesha<sup>12</sup> e segmenteve përbërës të sistemit financiar në Shqipëri gjatë periudhës 2004-2014. Vihet re se vlera e aktiveve të sistemit financiar si përqindje ndaj PBB-së është rritur dukshëm nga viti 2004 në vitin 2014. Evidentohet dominanca e sistemit bankar, si burimi më i rëndësishëm i ndërmjetësimit financiar. Kështu aktivet e bankave të shprehura në përqindje ndaj PBB-së kanë pësuar një tendencë rritëse nga 55% në fillim të vitit 2004, në 90 % të PBB-së në fund të vitit 2014. Ndërsa, segmentët e tjerë të sektorit financiar si: fondet e pensionit, shoqëritë e sigurimit, apo fondet e investimeve zënë një peshë shumë të ulët. Aktivet totale të tyre përbëjnë afërsisht 10 % të PBB-së në fund të vitit 2014. Megjithatë gjatë tre viteve të fundit vihet re një rritje e ndjeshme e aktiveve të fondeve të investimit, ku pas krizës së fundit financiare po shërbejnë si një mënyrë alternative e diversifikimit të portofolit të agjentëve ekonomikë, të cilët janë në kërkim të normave të larta të kthimit të interesit.

---

<sup>12</sup>Pesha për secilin segment është llogaritur si raport i aktiveve të secilit segment ndaj PBB-së.

**Tabela 6: Pesha e segmenteve të sistemit financiar si përqindje të PBB-së.**


Sistemi financiar	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Sistemi bankar	56.8	60.9	70.8	75.9	76.7	77.5	80.9	84.7	89.6	90.5	89.6
Institucioneve jo-banka				1.5	1.7	2.2	2.7	2.5	2.7	2.5	2.6
SHKK-të dhe unionet e tyre				0.6	0.7	0.8	0.8	0.7	0.8	0.8	0.7
Shoqëri sigurimi				1.4	1.4	1.5	1.4	1.5	1.6	1.6	1.6
Fonde pensioni				-	-	0.01	0.01	0.01	0.02	0.03	0.04
Fonde investimit									1.1	3.7	4.7

Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).

Rritja e sektorit financiar në ekonomi, ka qenë e shpejtë deri para krizës së vitit 2008, ndërsa mbas kësaj periudhe vihet re se rritja e tij ka qenë në linjë me politikat e bankave për një aktivitet të kujdesshëm dhe më konservator, si dhe në përputhje me ecurinë e aktivitetit të ekonomisë shqiptare. Zhvillime këto që konfirmohen edhe nga kontributi i vlerës së shtuar që ka dhënë sektori financiar në ekonomi, (Figura 1).


Kontributi më i lartë i këtij sektori ka qenë ndjeshëm më lartë kryesisht në vitit 2007 dhe 2008. Ndërsa mbas viti 2008, vihet re një rënie e këtij kontributi duke shënuar vlera më të moderuara. Në figurën 1 është paraqitur vetëm kontributi direkt i vlerës së shtuar të sektorit financiar në rritjen ekonomike, por ky sektor kontributin në ekonomi e ka ndjeshëm më të lartë nëpërmjet ndikimit indirekt dhe financimit që ai iu bën sektorëve të tjerë të ekonomisë, duke u rritur aftësinë e tyre prodhuese dhe eficiencën. Kështu si tregues i përafërt i këtij ndikimi është raporti i kredisë ndaj PBB-së, i cili në fund të vitit 2014 ishte në nivelin e 40 %, duke u pozicionur ndjeshëm mbi nivelin 10 %, që përbënte në fillim të vitit 2004, (Figura 2).

**Figura 1: Kontributi i sektorit financiar në PBB.**



Burimi: Instat, (2015).

**Figura 2: Ecuria e raportit të kredisë ndaj PBB-së.**



Burimi: Instat, Banka e Shqipërisë (2015).

Pavarësisht sukseseve gjatë këtyre vite, sistemi financiar vijon të karakterizohet nga nevoja për thellim të mëtejshëm të ndërmjetësimi financiar. Raporti i kreditimit ndaj PBB-së mbetet në nivele të ulta si në krahasim me vendet e rajonit, ashtu edhe me vendet e zhvilluara, duke konfirmuar domosdoshmërinë e rritjes së ndërmjetësimi financiar dhe prezencën e sektorit bankar në ekonomi. Po kështu aktiviteti financiar

vijon të mbështetet në nivele të larta euroizimi duke kufizuar edhe efikasitetin e politikave monetare dhe makroekonomike në vend.

Ashtu siç e përmendëm edhe në fillim, industria bankare në Shqipëri ka përjetuar zhvillime të rëndësishme mbas vitit 2004, ku hyrja e bankave të huaj me reputacion ndërkombëtar ka ndihmuar rrënjësisht në konsolidimin e sistemit bankar. Në përgjithësi prezenca e bankave të huaja vlerësohet të ketë qenë pozitive për sistemin bankar, duke ndikuar pozitivisht në efincencën dhe stabilitetin financiar/ bankar në vend.

Në fund të 2014, sistemi bankar përbehet prej 16 banka universale kryesisht me pronësi të huaj (Tabela 7). Bazuar në origjinën e tyre, vihet re që bankat me origjinë nga Bashkimi Europian zënë pjesën më të madhe të strukturës së kapitalit të sistemit bankar. Burimi kryesor i fondeve të bankave janë depozitat, të cilat përfaqësojnë 82% të totalit të pasiveve. Ndërkohë nga ana e aktivitetit, përpara krizës së vitit 2008 tendenca ka qenë në rritje të investimeve në kredi dhe në rënie të investimeve në letra me vlerë. Kjo dinamikë ndryshoi mbas krizës financiare, periudhë e cila u karakterizua nga një rritje e ngadaltë e portofolit të kredisë dhe rritje e përshpejtuar e investimeve në jorezidentë. Duke ofruar kështu një strukturë të balancuar në anën e investimeve të bankave. Totali i aktiveve përfaqëson 91% të PBB-së duke mbajtur një trend të moderuar rritjeje edhe në periudhën e pas krizës. Bankat në Shqipëri duke qenë universale, bën që veprimtaria e tyre financiare të mbështet kryesisht nga kursimet e individëve nga njëra anë, dhe ndërmjetësimi apo kanalizimi i këtyre fondeve drejt financimit të sektorit privat dhe atij publik.

Treguesit e ndërmjetësimit bankar, të shprehura në raport me shtrirjen gjeografike apo në raport me popullsinë (Tabela 7) tregojnë se sektori bankar ka përjetuar zgjerim të shpejtë deri në vitin 2008, para fillimit të transmetimit të pasojave të krizës financiare në ekonominë shqiptare. Kështu numri i degëve të bankave të sistemit është rritur me shumë se dyfish nga 250 në vitin 2005, në 511 degë në 2008. Paralelisht edhe numri i të punësuarve në sektorin bankar është rritur nga 3.5 mijë në 2005 në 6.5 mijë në 2008. Që nga ai vit, këto tregues shfaqen kryesisht të qëndrueshme në linjë dhe me politikë konservatore të bankave për të financuar dhe për të marrë përsipër më shumë rrezik, si dhe me dobësi ciklike të ekonomisë shqiptare

**Tabela 7: Sistemi bankar në Shqipëri.**

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Numri total i bankave	16	17	17	16	16	16	16	16	16	16	16
Bankat me kapital privat shqiptare	2	3	3	2	2	2	2	2	2	2	2
Bankat me kapital të huaj	14	14	14	15	14	14	14	14	14	14	14
Numri i degëve	0	250	294	399	511	524	529	534	538	529	499
Numri i popullsisë për bankë		176,647	175,412	184,875	183,500	182,438	181,688	181,375	181,188	181,000	180,813
Numri i të punësuarve nga sektori bankar		3,479	4,189	5,155	6,493	6,404	6,384	6,714	6,836	6,686	6,819

*Burimi:* Banka e Shqipërisë, (2015).

Të dhënat mbi përqendrimin dhe konkurrencën e sistemit bankar janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Kështu vihet re një ulje e peshës së dy bankave dhe tre bankave të mëdha, nga viti 2004 në vitin 2014, përkatësisht nga 45 dhe 56 % të totalit të aktiveve, në 58.3 dhe 68.3 në fund të 2004. Pothuasje të njëjtën tendencë, shfaq edhe indeksi Herfindal, megjithëse vihet re një rritje e moderuar e tij gjatë viteve të fundit përsëri konkludojmë që niveli i përqendrimit ka mbetur në nivele të qëndrueshme. Ndërsa, si tregues të konkurrencës, kemi marrë zhvillimet e marzhit të normës së interesit matur si diferencë e normës së kredisë në lekë dhe euro me normën përkatëse të depozitave. Gjatë periudhës së marrë në shqyrtim, vihet re një rënie e marzhit, si në euro ashtu edhe në lekë që tregon për një rritje të konkurrencës në sistemin bankar.

**Tabela 8: Përqëndrimi dhe konkurrenca.**

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Pesha e dy bankave të mëdha në % ndaj totalit të aktiveve	58.35	53.1	48.4	45.33	43.05	42.87	43.4	46.39	46.92	45.13	45.25
Pesha e tre bankave të mëdha në % ndaj totalit të aktiveve	68.32	64.33	61.3	55.95	55.32	55.86	56	57.7	57.6	56.14	56.44
Indeksi Herfindal për totalin e aktiveve të bankave	0.26	0.21	0.17	0.16	0.15	0.15	0.14	0.15	0.15	0.14	0.14
Marzhi i normës së interesit në lekë	8.71	9.04	8.59	9.01	6.66	7.7	6.75	5.89	6.22	6.45	6.27
Marzhi i normës së interesit në euro	6.46	5.95	5.37	5.68	4.18	6.1	4.66	4.95	4.75	5.72	5.65

*Burimi:* Banka e Shqipërisë, (2015).

Krahas mbulimit gjeografik, bankat janë kujdesur vazhdimisht të ofrojnë dhe produkte inovative financiare kryesisht në fushën e pagesave, si në drejtim të prezantimit të teknologjisë më të fundit të shërbimeve bankare, ashtu edhe në përfeksionimin dhe rritjen e sigurisë së produkteve ekzistuese. Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur ecurinë e treguesve të pagesave në vitet e fundit, ku roli i bankave të huaja ka qënë thelbësor duke rritur edhe konkurrencën në sektorin bankar. Veçanërisht pas krizës së fundit, duket sikur bankat kanë shtuar përpjekjet për rritjen e produkteve financiare të mjeteve të pagesave, si një mundësi për të rritur të ardhurat e tyre në kushtet e ngadalësimit të aktivitetit tradicional të tyre, të kreditimit.



**Tabela 9: Ecuria e numrit të transaksioneve per instrumentat e pagesave të sektorit bankar.**

Numër transaksionesh (në mijë)	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
<b>Transferta krediti sipas tipit të instrumentit</b>								
1-transfertë kreditit në formë letre	5,583	5,662	5,981	6,362	6,612	6,408	7,515	7,645
2-transfertë krediti në formë jo-letër	88	136	162	187	236	323	1,249	1,404
<i>a-Internet banking</i>	88	136	162	187	236	323	802	934
<i>b-Telefonebanking</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>c-Mobile banking</i>	-	-	-	-	-	-	25	28
<i>d- kompjuter banking</i>	-	-	-	-	-	-	269	222
<b>Pagesa të iniciuara nga klientët me kartë</b>	291	403	527	750	1,107	1,497	2,124	2,482
1- pagesat me karta funksion debiti	188	253	322	458	656	865	1,212	1,490
2- pagesat me karta funksion krediti	103	150	205	292	451	632	912	991
<b>Debitimi direkt</b>	350	754	800	864	976	720	571	673
<b>Pagesa me para elektronike</b>	-	-	-	-	-	-	-	156
<b>Çeçet</b>	99	73	69	62	63	49	44	47

Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).


Sistemi bankar shqiptar shfaqet i mirë-kapitalizuar dhe ka siguruar fitime pozitive. Kështu norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (Figura 3) për të gjithë sistemin gjatë periudhës 2004-2008 rezulton në nivelin e 20 %, e cila është afërsisht 2 herë më i lartë se minimumi i normës miratuar nga Banka e Shqipërisë (12 %). Ndërsa mbas krizës financiare vëmë re një ulje të kësaj norme, mesatarisht në nivelin e 16 %, por gjithsesi afërsisht 4 pikë përqindje më i lartë se vlera minimale e kërkuar për kapitalin rregulator. Pavarësisht nivelit të lartë të kapitalit që kanë bankat, zhvillimet ndërkombëtare mbas krizës së vitit 2008, nxorren në pah vështirësitë që patën bankat

për të siguar kapital shtesë, ndikuar nga kostoja më e lartë e tij dhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare. Në veçanti kjo u pasqyrua në bankat në Shqipëri, të cilat dominohen nga bankat me kapital të huaj. Këto vështirësi u reflektuan në reduktimin e aktivitetve bankare, të cilat shoqërohen me shtimin e kapitalit, ku më e dukshme ishte aktiviteti kreditues.

Në këto kushte, në maj të vitit 2013, Banka e Shqipërisë me qëllim adresimin e këtij fenomeni mori një paketë masash makroprudenciale, të cilat kërkonin të lehtësonin kërkesat për kapital dhe kostot për të. Kështu u ulën kërkesat për kapital shtesë, për bankat, të cilat arrinin një nivel të caktuar të rritjes së kredisë, për më tepër edhe ristrukturimi i kredisë do të shoqërohej me norma më të ulta të kapitalit. Ndërsa bankat të cilat do të investonin jashtë do të penalizoheshin nëpërmjet kërkesave më të larta për kapital.

Një tjetër fenomen që u vë re, në fondet e vet bankave dhe në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte edhe vendosja e kërkesave rregullative të ndryshme për grupe të caktuara bankash. Kështu mbas krizës greke të vitit 2011 dhe peshës relativisht të rëndësishme që përbënin bankat greke në sektorin bankar shqiptar, u vendos që për këto grup bankash të kërkohet një nivel minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit, më i lartë se sa 12% i përcaktuar për gjithë sistemin.


**Figura 3: Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (%).**



Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).

Në terma të performancës bankat janë karakterizuar nga fitime pozitive, matur si nga kthyeshmëria nga aktivet, ashtu edhe nga kthyeshmëria nga fondet e veta (Figura 4). Kështu gjatë periudhës 2004-2008, kthyeshmëria nga fondet e veta është mesatarisht në nivelin e 20 %, ndërsa kthyeshmëria nga aktivet është në nivelin e 1.4 %. Këto zhvillime pozitive në treguesit e përfitueshmërisë së kësaj periudhe lidhet me veprimtarinë në rritje ndërmjetësuese të bankave, normave dhe marzheve të larta të interesit dhe ndërmjetësimit, konkurrueshmërisë relativisht të ulët për përcaktimin e interesit të kredisë veçanërisht në segmente të caktuara dhe performancës së mirë makroekonomike ku kërkesa nga sektori privat ishte e lartë. Viti 2009 tregon për një rënie të menjëhershme dhe drastike të të dy treguesve. Gjatë periudhës 2009-2014, kthyeshmëria nga fondet e veta e sistemit bankar është në nivelin e 5.4 %, ndërsa kthyeshmëria nga aktivet është në nivelin e 0.5 %. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë rënie të ndjeshme të treguesve të përfitueshmërisë së bankave lidhen drejtpërsëdrejti me performancën e ekonomisë shqiptare, reduktimin e kërksesës së sektorit financiar për financim dhe si rrjedhojë rënie të aktivitetin ndërmjetësues, rritje të kostove të bankave për manaxhimin e kredive me probleme etj.

**Figura 4: Kthyeshmëria nga fondet e veta dhe aktivet (%).**




Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).

Pasivët e sektorit bankar kanë pasur një tendencë rritëse gjatë periudhës 2004-2008, me një mesatare rreth 18 % në vit. Ndërsa mbas krizës financiare vihet re një rënie e menjëhershme e tyre, duke arritur një mesatare rreth 5 %, pra tre herë më e ulët


(Figura 6). Financimi i aktivitetit bankar është mbështetur dhe vazhdon të mbështetet nga depozitat, të cilat përbëjnë 82 % të totalit të pasive. Mbas krizës së fundit financiare vihet re një rënie e ritmit të rritjes së tyre, duke shfaqur gjithashtu edhe një kontribut më të ulët në rritjen e totalit të pasiveve. Për më tepër gjatë kësaj periudhe vihet re edhe një rënie e zërit “Veprimeve me thesarin dhe ndërbankare” në fund të vitit 2014.

**Figura 5: Ecuria e pasiveve ndër vite (milion lekë).**



Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).

**Figura 6: Kontributi në rritjen vjetore të pasiveve.**



Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).


Ashtu siç është përmendur edhe në fillim, aktiviteti i sistemit bankar është financuar nga depozitat, të cilat përbëjnë 82 % e totalit të aktiveve, ndërsa janë sa dyfishi i vlerës së kredisë. Para krizës së fundit financiare vihet re një rritje e lartë e normës vjetore të rritjes së depozitave që është në konsistencë me thellimin e sistemit financiar në Shqipëri, si dhe me faktin që vendosja e depozitave në sistemin bankar ishte e vetmja mundësi investimi e individëve. Ndërsa mbas krizës së vitit 2008, vihet re një tërheqje e depozitave për shkat të perceptimit të një rreziku më të lartë. Megjithatë për shkak të masave të ndërmarra, si nga banka qendrore ashtu edhe nga qeveria, kjo tërheqje e depozitave ishte e përkohshme, duke bërë që depozitat të rikthehen në sistem brenda 2 viteve. Gjatë 5 viteve të fundit vihet re një rritje e moderuar e depozitave, në linjë me krijimin e parasë në ekonomi dhe me futjen e instrumentave të rinj financiarë, kryesisht në tregun e sigurimeve.

Në lidhje me strukturën e tyre (Figura 7 A, B), depozitat në monedhën vendase përbëjnë pjesën më të madhe të totalit të depozitave, megjithatë gjatë viteve të fundit vihet re një rritje e depozitave në monedhën e huaj, duke arritur nivelin e 48 % të totalit të depozitave në fund të vitit 2014. Pjesa më e lartë e depozitave në monedhë të huaj reflekton nivelin e lartë të eurorizimit në ekonominë shqiptare, që ka ardhur edhe si rezultat i faktorëve psikologjikë dhe kursimit në monedhë të huaj, ku depozitat në euro përbëjnë 86 % të totalit të depozitave. Kjo normë e lartë e depozitave në euro ka ardhur edhe si rezultat i dërgesave të larta të emigrantëve, që kanë qenë një nga burimet kryesore të kursimeve në monedhë të huaj.


Pjesa më e madhe e depozitave vjen kryesisht nga individët, që përfaqësojnë mesatarisht 86 % të totalit të depozitave, në fund të 2014. Pjesa e depozitave të sistemit bankar janë edhe depozitat e bizneseve, të cilat në fund të 2014, përbëjnë 12 % të totalit të depozitave. Ndërsa, pjesa tjetër e depozitave përbëhet nga depozitat e institucione të tjera publike dhe private, që i mbajnë këto fonde për qëllime të likuiditetit. Kjo strukturë aktuale e depozitave, bën që burimet e fondeve të bankave në Shqipëri të konsiderohen të qëndrueshme, me një elasticitet të ulët ndaj normës së interesit dhe një varësi më të lartë nga besimi i publikut të gjerë. Ishte pikërisht cënimi i këtij faktori që udhëhoqi kryesisht brishtësinë e sistemit financiar edhe gjatë krizës së fundit financiare.

**Figura 7: Struktura e depozitave sipas monedhës dhe agjentëve**

A.




B.



Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).


Gjatë periudhës 2004-2014, sektori bankar ka shfaqur një rritje të aktivitetit të tij matur në terma të rritjes së aktiveve, (Figura 8). Kështu nga 400 milion lekë që ka qenë totali i aktiveve të sistemit bankar në fillim të vitit 2004, në afërsisht 1 milion e 300 mijë lekë, në fund të vitit 2014. Veprimet me klientët bruto, që përfaqësojnë kredinë e dhënë nga sektori bankar drejt subjekteve rezidente dhe jorezidente pa përfshirjen e interesave të përlllogaritura, është zëri më i madh në totalin e aktiveve, ndjekur më pas nga veprimet me thesarin dhe veprimet me letrat me vlerë. Kriza e fundit financiare globale ka ndikuar ndjeshëm në uljen e ritmit të rritjes, si të totalit të aktiveve ashtu edhe të zërave përbërës së tij. Më evident ky fakt duket tek figura 9, e cila paraqet kontributin e secilit zë të aktiveve gjatë periudhës 2004-2014. Gjatë periudhës 2004-2008 vihet re kontributi pozitiv që ka dhënë kredia nga sektori bankar, ndërsa periudha 2009-2014, karakterizohet nga norma shumë më të ulta të rritjes të kredisë dhe të zërave të tjerë.

**Figura 8: Ecuria e aktiveve ndër vite (milion lekë).**



Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).

**Figura 9: Kontributi në rritjen vjetore të aktiveve.**




Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).

Në figurën 10 paraqitet më e detajuar ecuria e kredisë për ekonominë gjatë horizontit kohor 2004-2014. Të dhënat tregojnë që kreditimi është një ndër aktivitetet kryesore të sistemit bankar, ku vihet re një trend më i shpejtë rritjeje gjatë periudhës 2004-2008, me një normë vjetore rritjeje mesatarisht 50 %. Ndërsa, pas krizës financiare vihet një re një rënie e normave të rritjes së kreditimit, duke arritur në nivelet më të ulta madje duke shënuar edhe normave negative rritjeje. Ndarja sipas sektorëve, tregon që kredia për biznese përbën mesatarisht (gjatë periudhës 2004-2014) 65 % të totalit të kredisë, ndërsa kredia për individët përbën mesatarisht 32 % të totalit të kredisë.



**Figura 10: Kredia për ekonominë në milion lekë.**




Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).

Figura 11 paraqet kontributin e kredisë për biznese dhe individë në normën vjetore të rritjes së kredisë. Gjatë periudhës 2004-2008, vihet re një kontribut pothuajse konstat i kredisë për individët, ndërsa gjatë viteve 2009-2014 vihet re një rënie drastike, madje edhe negative e saj.


Ndërsa kredia për biznese, duket se ka udhëhequr tërësisht sjelljen e kredisë totale, si gjatë periudhës së rritjes së ndërmjetësimit financiar, ashtu edhe gjatë periudhës pas krizës globale. Vitet 2010-2014 tregojnë për një rënie të theksuar të ritmit të rritjes së kredisë, ku gjatë periudhës 2013-2014 shënohen edhe vlera negative të kontributit nga kredia për biznese. Duket se vetëm kontributi i kredisë për individë gjatë kësaj periudhe ka qenë ai që ndikuar në mbajtjen e kreditimit në norma mjaft të ulta rritjeje.

**Figura 11: Kontributi në normën vjetore të rritjes së kredisë (%).**



Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).

**Figura 12: Ecuria e kredisë me probleme (%).**




Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).

Cilësia e portofolit të kredisë, matur nga raporti i kredive me probleme, ka qenë e ulët para fillimit të krizës, por mbas vitit 2008 vihet re një rritje e 5-fishtë e saj, duke arritur në nivelin maksimal në 24.9 % (Figura 12). Fundi i tremujorit të katërt të vitit

2014 shënoi një rënie të normës së kredisë me probleme, si rezultat edhe i masave makroprudenciale të marra nga banka qendrore. Megjithatë vlerësohet se rreziku i kredisë, matur nga norma e kredive me probleme, është në nivele të konsiderueshme. Ky fakt bën që cilësia e kredisë është dhe mbetet një nga shqetësimet kryesore të Bankës së Shqipërisë pasi vë në rrezik stabilitetin financiar të vendit.

Megjithatë vlerësohet se mbulimi me provigjione i kredisë me probleme shprehur në përqindje ndaj totalit të kredisë me probleme është në nivele të kënaqshme dhe ka ardhur duke u rritur me kalimin e viteve. Kështu siç paraqitet në figurën 13, nga 5 % të totalit të kredisë me probleme që ka qenë në fillim të vitit 2009, mbulimi me provigjione ka arritur në nivelin e 16 % në fund të vitit 2014.

**Figura 13: Provigjionimi i humbjeve nga huatë si përqindje ndaj kredisë me probleme.**



Burimi: Banka e Shqipërisë, (2015).

Zhvillimet në sektorin bankar tregojnë që një ndër shqetësimet kryesore është rritja e plogësht e kreditimit, e ndikuar si nga faktorët e ofertës ashtu edhe nga faktorët e kërkesës. Faktorët kryesorë të ofertës që kanë sjellë një ulje të volumit të kredisë ndaj sektorit privat janë: (i) kufizimet që bankat mëma, (kryesisht ato me origjinë nga Bashkimi Europian), si dhe kërkesat nga autoritetet e Eurozonës u kanë bërë bankave në Shqipëri; (ii) niveli i lartë i kredive me probleme, i cili ka rënduar bilancet e

bankave dhe e ka bërë më të vështirë shpërndarjen e fondeve të vlefshme në ekonomi; (iii) si dhe struktura afatshkurtër e buimeve të financimit, që ka dëmtuar deri diku aftësinë e bankave për të kredi me afate të gjata maturimi. Ndërsa, nga ana e kërkesës, kufizimet në kredi janë të lidhura me performancën ekonomike të vendit, ku prodhimi aktual vazhdon të mbetet poshtë nivelit potencial të prodhimit, si dhe me pritshmëritë pesimiste si të biznesit ashtu edhe familjeve në lidhje me performancën e ardhshme të rritjes ekonomike të vendit.

### 3.3 Rezultatet empirike

Për vlerësimin e faktorëve përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë të bankave në Shqipëri, jemi bazuar në përjasjen e propozuar nga Bouvatier dhe Lepetit, (2008); Packer dhe Zhu, (2012) paraqitur në ekuacionin 1.

#### 3.3.1. Të Dhënat


Të dhënat e përdorura për vlerësimin e ekuacionit 1, janë marrë nga bilancet dhe pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të bankave që operojnë në Shqipëri. Burimi kryesor i të dhënave është databaza e Bankës së Shqipërisë, ndërsa të dhënat makroekonomikë janë marrë nga Instituti i Statistikës, Instat. Paneli i të dhënave përfshin 15 banka, 13 prej të cilave janë banka me kapital të huaj dhe 2 janë banka me kapital vendas. Përjashtimi i një banke nga sistemi është bërë pasi vlerat e treguesve kryesorë të saj paraqiteshin si *outlier*. Periudha e vlerësimit përfshin vitet 2004-2014, periudhë gjatë së cilës sistemi bankar pësoi ndryshime të rëndësishme. Kështu vihet re një thellim akoma më shumë i ndërmjetësimit financiar, një element mjaft i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit, sidomos në rastin e një vendi në zhvillim si Shqipëria. Për më tepër gjatë kësaj periudhe nuk kemi ndryshime të standarteve kontabël të llogarive kombëtare.

Gjatë viteve 2004-2014, sektori real dhe ai bankar në Shqipëri paraqet disa zhvillime të rëndësishme, të diktuara jo vetëm nga karakteristikat e brendshme të ekonomisë, por edhe nga faktorët e jashtëm. Kriza e fundit financiare globale pa dyshim që ka ndikuar këta sektorë, pasojat e të cilës vazhdojnë ende edhe në ditët e sotme.

Një vështrim i përgjithshëm mbi të dhënat e aktivitetit ekonomik të vendit, matur me anë të normës reale të rritjes së prodhimit të brendshëm bruto, PBB-ja tregon që

aktiviteti ekonomik nga viti 2004 deri në vitin 2008 luhet mesatarisht në nivelin e 6.4 %. Ashtu si shumë vende në mbarë botën edhe Shqipëria vuajti pasojat e krizës më të fundit financiare, e cila shkaktoi një ndalësim të rritjes ekonomike, duke arritur mesatarisht në nivelin e 2.4 % në terma të rritjes vjetore të PBB-së gjatë periudhës 2009-2014 (Figura 14).

**Figura 14: Norma reale tremujore e vjetorizuar e prodhimit të brendshëm bruto.**



Burimi: Instat, (2015).

Sektori bankar nga ana tjetër shfaq rënie të menjëhershëm të kreditimit, i cili vazhdon akoma të jetë në nivele shumë të ulta. Tabela më poshtë, (Tabela 10) paraqet në mënyrë të përmbledhur statistikat përshkruese të të dhënave kryesore që ne kemi përdorur për vlerësimin e ekuacionit tonë bazë dhe të modeleve alternative. Të dhënat janë të dhëna në nivel banke, për 15 banka të sistemit gjatë periudhës 2004-2014, të paraqitura në terma të mesatares, maksimumit, minimumit dhe të devijimit standart. Pjesa më e madhe e të dhënave janë shprehur si raport ndaj totalit të aktiveve, përveç **DNPL** dhe **SIGN**.

Ashtu siç e përmendëm edhe më sipër, të dhënat për bankat në mënyrë individuale tregojnë që kreditimi është një aktivitet i rëndësishëm i bankave në Shqipëri. Të dhënat tregojnë që kreditimi zë një peshë të rëndësishme në aktivet e bankave, mesatarisht kreditimi përbën 45 % e totalit të aktiveve dhe me një vlerë maksimale prej 96 %. Provigjionimi i humbjeve nga huatë matur në raport ndaj totalit të aktiveve

mesatarisht është në nivelin e 0.5 % dhe me vlerë maksimale 0.6 %. Ndërsa rezervat e provigjionimit të humbjeve nga huatë ndaj totalit të aktiveve janë mesatarisht në nivelin e 3.1 % dhe me një vlerë maksimale 23 %. Bankat në Shqipëri kanë qenë gjithmonë të mirëkapitalizuara dhe kanë siguruar fitime pozitive. Ky fakt reflektohet nga një normë mesatare e mjaftueshmërisë së kapitalit, **Car\_ratio** në nivelin e 36 % dhe me një normë fitimi para taksave, interesave dhe provigjioneve mesatarisht në nivelin e 0.6 %.

**Tabela 10: Statistika përshkruese të treguesve kryesorë.**

<b>Të dhënat</b>	<b>Përkufizimi</b>	<b>Nr.</b>	<b>Mes.</b>	<b>Std.Dev</b>	<b>Min.</b>	<b>Maks.</b>
<b>LLP</b>	<i>Provigjionimi i humbjeve nga huatë në raport ndaj të totalit të aktiveve.</i>	660	0.00561	0.01092	-0.03453	0.06086
<b>LLR</b>	<i>Rezervat e provigjionimit të humbjeve ndaj totalit të aktiveve.</i>	660	0.03448	0.04617	0	0.23061
<b>EBTP</b>	<i>Fitimet para, interesave, taksave dhe provigjioneve në raport ndaj totali të aktiveve.</i>	660	0.00616	0.01535	-0.07209	0.18050
<b>SIGN</b>	<i>Norma e pritshme të rritjes së fitimeve para interesave, taksave dhe provigjioneve.</i>	600	0.30231	7.66683	-27.2946	159.074
<b>NPL</b>	<i>Raporti i kredive të këqija ndaj totalit të kredisë.</i>	658	0.11664	0.13183	0	1
<b>DNPL</b>	<i>Diferenca e parë e raportit të kredive të këqija.</i>	598	0.02048	0.09714	-0.9999	1
<b>Loan_rate</b>	<i>Totali i kredisë si raport ndaj totalit të aktiveve.</i>	660	0.45369	0.20537	0	0.9615
<b>CAP</b>	<i>Kapitali(Tier I+Tier II) total si raport ndaj totalit të aktiveve</i>	660	0.32297	0.31464	0.04417	1.53144
<b>Car_ratio</b>	<i>Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit–kapitali total ndaj aktiveve të peshuar me rrezik</i>	660	0.36667	0.54157	0.0414	3.951
<b>GDP_g</b>	<i>Norma vjetore e rritjes së PBB-së.</i>	660	0.04113	0.03354	-0.03	0.11

*Burimi:* Banka e Shqipërisë, INSTAT, llogaritje të autorit. (2015).

*Shënim;* **Mes** është mesatarja e thjeshtë, **Maks** është vlera maksimale, **Min** është vlera minimale, **Std** është devijimi standard dhe **Nr** është numri i vëzhgimeve.

Ndërsa matrica e korrelacioneve (Tabela 11) paraqet një vështrim të përgjithshëm mbi lidhjet që mund të vëzhgohen midis variablave kryesorë. Kështu evidentohet një

korrelacion pozitiv midis provigjionimit të humbjeve nga huatë me fitimet para taksave, interesave dhe provigjioneve, me normën e kredive të këqija dhe diferencën e parë të saj, si dhe me normën e kredisë ndaj totalit të aktiveve. Ndërsa gjendet një korrelacion negativ midis provigjionimit të humbjeve nga huatë me aktivitetin ekonomik të vendit, matur nëpërmjet normës reale të PBB-së, si dhe me normën e kapitalit, normën e pritshme të fitimit dhe rritjes së vjetorizuar të kredisë.

**Tabela 11: Matrica e korrelacionit.**

	<i>LLP</i>	<i>GDP_G</i>	<i>Loan_rate</i>	<i>EBTP</i>	<i>SIGN</i>	<i>CAP</i>	<i>NPL</i>	<i>DNPL</i>	<i>Loan_g</i>
<i>LLP</i>	1.000								
<i>GDP_G</i>	-0.1662	1.000							
<i>Loan_rate</i>	0.4779	-0.1262	1.000						
<i>EBTP</i>	0.3220	0.0535	0.2463	1.000					
<i>SIGN</i>	-0.0590	0.0427	-0.1118	-0.0215	1.000				
<i>CAP</i>	-0.1841	0.0162	-0.5123	-0.4871	0.0964	1.000			
<i>NPL</i>	0.1982	-0.3294	0.1411	-0.0759	-0.0482	-0.0891	1.000		
<i>DNPL</i>	0.1350	-0.0373	0.2878	0.1449	-0.0220	-0.2646	-0.355	1.000	
<i>Loan_g</i>	-0.002	0.0504	-0.0314	-0.268	-0.009	0.0321	-0.093	-0.012	1.000

Burimi: Banka e Shqipërisë, Instat, llogaritje të autorit, (2015).

Fillimisht për të marrë rezultate sa më të qëndrueshme dhe të paanshme janë performuar testet e rrënjës njësi (*unit root test*) për seritë që kemi marrë në shqyrtim. Literatura sygjeron një numër të caktuar testesh për të testuar rrënjën njësi (*unit root*) të serive si; testi Levin–Lin–Chu,(2002); testi Harris–Tzavalis, (1999); testi Breitung, (2000); testi Breitung and Das, (2005); testi Im–Pesaran–Shin, (2003); dhe testi i Fisher-it, (Choi 2001). Pjesa më e madhe e këtyre testeve kanë si hipotezë bazë që i gjithë paneli ka një rrënjë njësi (*unit root*), ndërsa testi Hadri, (2000) dhe testi Lagrange multiplier, (LM) test kanë si hipotezë bazë që i gjithë paneli është i qëndrueshëm apo stacionar. Pjesa më e madhe e testeve performohet kryesisht për një databazë paneli të balancuar, ndërsa testi Im–Pesaran–Shin dhe testi i Fisher-it

përdoren kryesisht për panele të pabalancuara. Duke qenë se paneli që është marrë në konsideratë është një panel i pabalancuar, janë performuar këto dy teste. Një përmbledhje e detajuar e testeve të performuar është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Rezultatet e marra tregojnë për hedhjen poshtë të hipotezës bazë që seritë kanë rrënjë njësi, duke konfirmuar që të gjitha seritë janë stacionare ose të qëndrueshme.

**Tabela 12: Testi i rrënjës njësi (*unit root*).**

	Testi i Fisher bazuar tek ADF <i>H<sub>0</sub></i> : i gjithë paneli ka një rrënjë njësi ( <i>unit root</i> )	Testi i Fisher bazuar tek PP <i>H<sub>0</sub></i> : i gjithë paneli ka një rrënjë njësi ( <i>unit root</i> )	Testi i Im-Pasaran-Shin test <i>H<sub>0</sub></i> : i gjithë paneli ka një rrënjë njësi ( <i>unit root</i> )
<b>LLP</b>	218.56*** (0.000)	131.18*** (0.000)	-7.82*** (0.000)
<b>EBTP</b>	155.71*** (0.000)	147.39*** (0.000)	-10.95*** (0.000)
<b>NPL</b>	80.63*** (0.000)	41.33*** (0.000)	-3.54*** (0.000)
<b>Loan_rate</b>	100.4*** (0.000)	33.06 (0.42)	-2.71*** (0.000)
<b>DNPL</b>	497.85*** (0.000)	546.02*** (0.000)	-14.48*** (0.000)
<b>Loan_growth</b>	263.3*** (0.000)	151.93*** (0.000)	-9.3*** (0.000)
<b>CAP</b>	191.18*** (0.000)	224.71*** (0.000)	-7.99*** (0.000)
<b>Car_gap</b>	294.07*** (0.000)	266.05*** (0.000)	-7.31*** (0.000)
<b>GDG_g</b>	163.9*** (0.000)	241.47*** (0.000)	-11.05*** (0.000)
<b>SING</b>	628.05*** (0.000)	761.3*** (0.000)	-16.98*** (0.000)

*Burimi:* Banka e Shqipërisë, INSTAT, llogaritje të autorit, (2015).

### 3.3.2. Rezultatet e modelit bazë

Bazuar në metodologjinë e prezantuar më sipër në këtë material janë analizuar përcaktuesit e provigjionimit të humbjeve nga huatë në Shqipëri. Analiza empirike është bazuar në vlerësimet e Metodës së Përgjithshme së Momenteve (*GMM*) duke përdorur diferencën e parë të propozuar nga Arellano dhe Bond, (1991). Variablat janë në diferencë të parë për të kontrolluar për efektet specifike të pavëzhguara të bankave. Rezultatet e ekuacionit 1 janë paraqitur në tabelën 13, kolona e parë.



**Tabela 13: Përcaktuesit e provigjionimit të humbjeve nga huatë të bankave në Shqipëri.**

Variablat shpjegues	Variabli endogjen: $LLP_{i,t}$ ,	
	Specifikimi (1) Vlerësimi me dy etapa i Arellano-Bond	Specifikimi (2) Vlerësimi me dy etapa i Arellano-Bond
$LLP_{i,t-1}$	0.3967*** (0.003)	0.4986*** (0.008)
$NPL_{i,t}$	0.0156*** (0.000)	
$DNPL_{i,t}$	0.0111*** (0.000)	
$Loan\_rate_{i,t}$	0.0163** (0.010)	0.014** (0.010)
$EBTP_{i,t}$	0.1616*** (0.000)	0.2079*** (0.000)
$CAP_{i,t}$	0.0002 (0.720)	0.0004 (0.425)
$SIGN_{i,t}$	-0.000005 (0.828)	-0.000019 (0.845)
$GDP\_g_{i,t}$	-0.0195** (0.016)	-0.0242*** (0.001)
$Loan\_g_{i,t}$		0.00007*** (0.000)
Numri i vëzhgimeve.	540	523
Numri i bankave	15	15

*Shënim:* vlerat e probabilitetit janë paraqitur në kllapa, ku \*, \*\* dhe \*\*\* përfaqësojnë nivelin e rëndësisë përkatësisht në 90 %, 95 % dhe 99 %. Variablat shpjegues me vonesë kohore janë përdorur si variabla instrumentale për ekuacionin e diferencuar.

Rezultatet e marra tregojnë për një lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë,  $LLP$  dhe termit me vonesë kohore të tij, që tregon për sjelljen axhustuese të provigjionimit të humbjeve nga huatë.

Ashtu siç edhe pritej është gjetur një lidhje pozitive dhe statistikisht e rëndësishme midis normës së kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë,  $NPL_{i,t}$  dhe diferencën e normës së kredisë me probleme  $DNPL_{i,t}$  me provigjionimin e humbjeve nga huatë,  $LLP$ . Pra bankat në Shqipëri kanë rritur më shumë nivelin e provigjionimit të humbjeve nga huatë kur kanë norma më të larta të kredisë me probleme dhe presin rritje të kredisë me probleme në të ardhmen.

Rezultatet konfirmojnë një lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme midis raportit të totalit të kredisë  $Loan\_rate_{i,t}$  dhe provigjionimit të humbjeve të huasë. Pra bankat rrisin më shumë provigjionet kur vërejnë një rritje të raportit të kredisë ndaj totalit të aktiveve. Ky rezultat sipas Fonseca dhe Gonzales, (2008) tregon që bankat kanë shfaqur disa elementë larg-pamës (*forward-looking*) të provigjionimit të humbjeve nga huatë.

Përveç variablave, të cilët përafrojnë sjelljen jo-diskrecionare të provigjionimit të humbjeve nga huatë, është parë se si  $LLP$  ndikohet nga *komponeti diskrecionarë*. Kjo gjë është bërë nëpërmjet testimit të hipotezës së zbutjes së të ardhurave (*income smoothing*), hipotezës së manaxhimit të kapitalit dhe hipotezës së sinjalizimit.

Kështu për të parë nëse bankat kanë përdorur provigjionimin e humbjeve nga huatë si mjet për të zbutur të ardhurat interesohemi për lidhjen midis  $LLP$  dhe fitimit para taksave, interesave dhe provigjioneve,  $EBTP_{i,t}$ . Vlerësimet evidentojnë për një koeficient pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm para treguesit  $EBTP_{i,t}$ . Ky rezultat tregon se bankat kanë rritur më shumë provigjionet kur kanë patur fitime të larta, si dhe kanë krijuar më pak provigjione kur fitimet e tyre kanë qenë të ulta. Rezultat ky që konfirmon se bankat në Shqipëri kanë bërë zbutje të të ardhurave (ose *income smoothing*), pra ato kanë përdor  $LLP$ , si një mjet për të menaxhuar fitimet.

Gjithashtu është testuar hipoteza e manaxhimit të kapitalit, duke parë lidhjen që ekziston midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Një lidhje negative midis këtyre dy variablave tregon që bankat në kushtet e rënies së kapitalit kanë përdorur provigjionet si mjet për të arritur nivelin e kërkuar të kapitalit. Vlerësimet e marra nga ekuacioni 1, paraqitur në tabelën 13, (kolona e parë), tregojnë për një lidhje pozitive por statistikisht të parëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe  $CAP$ , që paraqet normën e mjaftueshmërisë së kapitalit. Ky rezultat tregon që bankat nuk e kanë përdorur provigjionimin e humbjeve nga huatë si mjet për të përmbushur kriteret e kapitalit të vendosur nga autoriteti monetar. Një shpjegim i këtij rezultati ka të bëjë me faktin që bankat në Shqipëri kanë patur nivele të konsiderueshme të kapitalit, i cili ka shërbyer si mburojë edhe gjatë goditjeve të marra nga kriza e fundit financiare globale.

Gjithashtu është parë edhe lidhja që ekziston midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe normës së pritshme të rritjes së fitimeve para interesave, taksave dhe provigjioneve për të testuar hipotezën e sinjalizimit, (*signaling*). Kështu jemi të interesuar për koeficientin para variablit, **SIGN**. Vlerësimet e marra nga teknika e Arellano-Bond, (1991) konfirmojnë për një lidhje negative dhe statistikisht të parëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe normës së pritshme të rritjes së fitimeve të bankave. Ky rezultat tregon që nuk ka evidencë të përdorimit të provigjionimit të humbjeve nga huatë nga bankat në Shqipëri për të sinjalizuar fortësinë e tyre financiare.

Në linjë me pritshmëritë teorike, është gjetur një lidhje negative dhe statistikisht e rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve dhe huasë, **LLP** dhe normës reale të rritjes së PBB-së, **GDP\_G**. Ky rezultat tregon për sjelljen prociklike të provigjionimit të humbjeve nga huatë me ciklin e biznesit në Shqipëri. Bankat kanë krijuar më pak provigjione gjatë fazave të gjallërimit ekonomik dhe kanë krijuar më shumë provigjione gjatë periudhave me rënie ekonomike. Rezultatet e marra empirike janë në linjë edhe më punime të tjera teorike si ato të; Leaven dhe Majnoni, (2003), Bikker dhe Metzmakers, (2005), Fonseca dhe Gonzales, (2008), Skala, (2014). Ky rezultat tregon që bankat në Shqipëri nuk duket se kanë krijuar rezerva të mjaftueshme gjatë pikave të larta të ciklit ekonomik, duke konfirmuar që politikat e tyre të provigjionimit të humbjeve nga huatë janë prapa vepruese (*backward-looking*). Megjithatë kjo sjellje prociklike e bankave venitet pak nga lidhja pozitive që rezultoi midis **LLP** dhe fitimeve para taksave, interesave dhe provigjioneve (Bikker dhe Metzmakers, 2005), pasi bankat duket se janë sjellë në mënyrë të kujdesshme për sa i përket manaxhimit të të ardhurave.

Në kolonën e dytë të tabelës 13, janë paraqitur rezultatet e marra nga vlerësimi i ekuacionit të dytë. Kështu për të parë më shumë në lidhje me sjelljen *jo-diskrecionare* të provigjionimit të humbjeve nga huatë, në model është përfshirë norma vjetore e rritjes së kredisë. Ashtu siç edhe pritej, është gjetur një lidhje pozitive dhe statistikisht e rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe normës vjetore të rritjes së kredisë, **Loan\_g<sub>i,t</sub>**. Ky rezultat tregon faktin që një nivel më i lartë i rritjes së kredisë përkthehet në nivel më të lartë të rrezikut, duke bërë që bankat të rrisin në këtë mënyrë provigjionet. Pra bankat duket që kanë qenë më alerte ndaj normës

vjetore të rritjes së kredisë, se sa ndaj normës së kredive me probleme dhe pritshmëritë në lidhje me to. Ky rezultat lidhet edhe me mënyrën e vlerësimit të rrezikut nga ana e bankave, të cilët i kanë kushtuar më shumë vëmendje rritjes së kredisë përkundrejt informacionit të marrë nga normave e kredive të këqija dhe e pritshmërive mbi to.

Ashtu si edhe në modelin e parë, vlerësimet konfirmojmë që bankat kanë bërë zbutje të të ardhurave (*income-smoothing*), si dhe konfirmojnë sjelljen prociklike midis **LLP** dhe rritjes ekonomike, pra bankat rrisin akoma më shumë provigjionet kur vërehet një rënie të aktivitetit ekonomik dhe anasjelltas. Për më tepër nuk gjenden evidenca që bankat kanë përdorur provigjionimin e humbjeve nga huatë për të manaxhuar kapitalin apo fitimet, duke treguar që provigjionet e bankave në Shqipëri janë udhëhequr kryesisht nga faktorët *jo-diskrecionarë* dhe faktorët makroekonomik.

Për të testuar nëse vlerësimet e marra nga metoda e *GMM* janë korrekte, është parë nëse modeli është specifikuar saktë apo jo, me anë të testit të Sargan, si dhe duke testuar për prezencën e autokorrelacionit në termin e dytë autoregresiv, AR(2). Rezultat e këtyre testeve për të dy specifikimet e modelit janë paraqitur përkatësisht në tabelën 14 dhe 15. Rezultatet e testeve tregojnë se nuk mund të hedhet poshtë hipotezën zero tek testi Sargan, që tregon që modelet janë specifikuar në mënyrë të saktë. Gjithashtu rezultatet e testit të autokorrelacionit të Arellano-Bond, tregon që autokorrelacioni nuk përbën një shqetësim për rezultatet e marra.

**Tabela 14: Rezultatet e testit Sargan.**

Testi Sargan mbi identifikimin e kufizimeve	Specifikimi (1)	Specifikimi (2)
H0:kufizimet e identifikimit janë të vlefshme	Prob> chi2 = 1.0000	Prob> chi2= 1.0000

**Tabela 15: Rezultatet e testit Arellano-Bond të autokorrelacionit.**

Testi i Arellano-Bond për autokorrelacion zero të diferencës së parë të gabimeve, H0: jo autocorrelation		
	Specifikimi (1)	Specifikimi (2)
Rendi i 1-vlera e p	-2.5347 *** (0.0113)	-2.0112** (0.0443)
Rendi i 2-vlera e p	0.63957 (0.5225)	-1.6605 (0.0986)

### 3.3.3. Rezultate të tjera

Analiza e rezultateve është pasuruar akoma më shumë duke testuar nëse disa karakteristika të veçanta të bankave ndikojnë apo jo në sjelljen e tyre ndaj provigjionimit të humbjeve nga huatë, kryesisht në prociklikalitetin dhe zbutjen e të ardhurave. Kështu si Bouavatier dhe Lepetit, (2008); Packer dhe Zhu, (2012) është parë se si madhësia e bankave dhe niveli i kapitalizimit të tyre ndikon në zbutjen e të ardhurave dhe prociklikalitetin e provigjionimit të bankave. Kjo gjë është bërë nëpërmjet pasurimit të modelit bazë me disa tregues ndërveprues që gjenerohen nga ndërveprimi i treguesit cilësor me treguesin e të ardhurave dhe të rritjes ekonomike. Rezultatet e marra nga shtimi i treguesve ndërveprues janë paraqitur në tabelën 16.

Ashtu si Ahmed et. al., (1999) dhe Packer dhe Zhu, (2012) fillimisht kemi parë se si madhësia e bankave ndikon në sjelljen e provigjionimit të bankave ndaj huasë. Kështu ndarja e bankave në të mëdha apo të vogla është bërë nëpërmjet një variabli cilësor. Ky variabël që e kemi quajtur *Madhësia* merr vlerën 1 për bankat e cilësuar banka të mëdha dhe 0 për bankat e vogla. Ndarja e bankave është bërë nëpërmjet vendosjes së një kufiri midis bankave. Kështu si kufi kemi përdorur, percentilen e 75 të vlerës logaritmike të aktiveve të bankave. Çdo bankë që ka vlerën e aktiveve më të madhe se ky kufi konsiderohet bankë e madhe, përndryshe klasifikohet si bankë e vogël. Përveç këtij treguesi cilësor në model kemi përfshirë edhe dy tregues të tjerë; *Madhësia\*EBTP\_ratio* dhe *Madhësia\*GDP\_G* që kanë rezultuar nga ndërveprimi midis variablit cilësor, **Madhësia** dhe të ardhurave para interesave, taksave dhe provigjioneve dhe rritjes reale të PBB-së, **GDP\_G**. Këto tregues cilësor na shërbejnë për të parë nëse ka diferenca në sjellje midis bankave të mëdha dhe bankave të vogla.

**Tabela 16: Impakti i karakteristikave të bankave në LLP.**

Variablat shpjegues	Variabli endogjen: $LLP_{i,t}$ , Modele me variabla cilësorë		
	Specifikimi (1) Vlerësimi me dy etapa i Arellano-Bond	Specifikimi (2) Vlerësimi me dy etapa i Arellano- Bond	Specifikimi (3) Vlerësimi me dy etapa i Arellano-Bond
$LLP_{i,t-1}$	0.38395*** (0.006)	0.4563 (0.163)	0.2949 (0.218)
$NPL_{i,t}$	0.01826*** (0.000)	0.01555*** (0.001)	0.01860*** (0.000)
$DNPL_{i,t}$	0.01257*** (0.000)	0.01257*** (0.000)	0.01161*** (0.000)
$Loan\_rate_{i,t}$	0.01568** (0.080)	0.01242*** (0.009)	0.01764** (0.047)
$EBTP_{i,t}$	0.16025*** (0.000)	0.12085*** (0.018)	0.31661*** (0.000)
$CAP_{i,t}$	0.000135 (0.805)	0.00014 (0.789)	0.00011 (0.832)
$SIGN_{i,t}$	-0.00001 (0.667)	-0.00001 (0.979)	-0.00001 (0.579)
$GDP\_g_{i,t}$	-0.01911*** (0.022)	-0.02371*** (0.028)	-0.02331** (0.064)
<i>Madhësia (intercept dummy)</i>	-0.0032*** (0.001)	-0.0048*** (0.002)	NA
<i>Madhësia*EBTP (slope dummy)</i>	NA	0.1316** (0.021)	NA
<i>Madhësia*GDP_G (slope dummy)</i>	NA	0.1295 (0.516)	NA
<i>High_Kapitali*EBT P (slope dummy)</i>			-0.2002*** (0.002)
<i>High_Kapitali*GDP _G (slope dummy)</i>			0.01989** (0.075)
Numri i vëzhgimeve.	540	540	540
Numri i bankave	15	15	15

*Shënim:* Vlerat e probabilitetit janë paraqitur në kllapa, ku \*, \*\*dhe \*\*\* përfaqësojnë nivelin e rëndësisë përkatësisht në 90 %, 95 % dhe 99 %. Variablat shpjegues me vonesë kohore janë përdorur si variabla instrumentale për ekuacionin e diferencuar.

Në kolonën e parë, të tabelës 16 është parë nëse ka diferencë në sjellje midis provigjionimit të humbjeve nga huatë midis bankave të mëdha dhe të vogla, nëpërmjet përfshirjes së treguesit **Madhësia**. Rezultatet e marra tregojnë që treguesi cilësor, **Madhësia** ka rezultuar statistikisht i rëndësishëm dhe negativ. Kjo tregon që *ceteris paribus* bankat e mëdha kanë krijuar më pak provigjione se bankat e vogla.

Për të analizuar më tej diferencat midis bankave të mëdha dhe të vogla në model janë përfshirë dhe dy variabla cilësore për pjerrësinë, përkatësisht **Madhësia\*EBTP\_ratio**, **Madhësia\*GDP\_G**. Këto variabla cilësore shikojnë diferencën që ekziston midis sjelljes së bankave të mëdha dhe bankave të vogla në lidhje me zbutjen e të ardhurave dhe rritjen ekonomike. Rezultatet e paraqitura në kolonën e dytë të tabelës 16, tregojnë që bankat e mëdha më së shumti i kanë përdorur provigjionet e humbjeve nga huatë për të manaxhuar të ardhurat se sa për të zvogëluar prociklikalitetin ndaj rritjes ekonomike. Lidhja midis LLP dhe treguesit, **Madhësia\*GDP\_G** ka rezultuar pozitive por statistikisht e parëndësishme.

Ashtu si Packer dhe Zhu,(2012) duke marrë në konsideratë lidhjen që ka midis kapitalit të bankave dhe provigjionimit të humbjeve nga huatë, është testuar hipoteza e manaxhimit të kapitalit. Fillimisht është krijuar një variabël cilësor **High\_Kapitali**, që merr vlerën 1 për bankat që kanë një nivel të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, më të madh se 16.5 % dhe 0 përndryshe. Bankat që kanë një normë të mjaftueshmërisë së kapitalit më të madh se 16.5 % quhen banka të mirëkapitalizuara, ndërsa ato me normë më të ulët të mjaftueshmërisë të kapitalit quhen më pak të mirëkapitalizuara. Si vlerë kufi është zgjedhur mediana e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit duke marrë parasysh faktin që bankat kanë patur gjithmonë vlera të normës së kapitalit më të larta se norma minimale e kërkuar nga autoriteti rregullator. Ky variabël cilësor duke ndërvepruar me normën e të ardhurave para interesave, taksave dhe provigjioneve dhe me rritjen ekonomike reale shërbejnë për të parë diferencat që ekzistojnë midis këtyre dy grupeve të bankave. Vlerësimet e marra janë paraqitur në tabelën 16, (kolona e 3). Rezultatet tregojnë për një lidhje negative dhe statistikisht të rëndësishme midis **LLP** dhe **High\_Kapitali\*EBTP**, duke konfirmuar faktin që bankat e mirëkapitalizuara nuk kanë bërë zbutje të të ardhurave. Ndërkohë që gjendet një lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme midis **LLP** dhe treguesit ndërveprues **High\_Kapitali\*GDP\_G**. Ky rezultat tregon që bankat e

mirëkapitalizuara ndryshe nga bankat më pak të mirëkapitalizuara janë më shumë larg-pamëse (*forward-looking*), duke bërë që të krijojnë më shumë provigjione kur normat e rritjes reale ekonomike janë më të larta dhe anasjelltas.

Ashtu si shumë vende në mbarë botën, edhe Shqipëria vuajti pasojat e krizës financiare globale, e cila solli një ngadalësim të aktivitetit ekonomik, me afërsisht 4 pikë përqindjeje. Një ulje të theksuar pësoi gjithashtu edhe norma vjetore e rritjes së kredisë, duke shënuar madje vlera rritjeje shumë afër 0, si dhe është vënë re edhe një dyfishim i normës së kredisë me probleme. Kështu duke patur parasysh impaktin e krizës financiare është investiguar nëse kriza financiare globale ka kontribuar akoma më shumë në ciklikalitetin e sjelljes së provigjionimit të humbjeve nga huatë në rastin e bankave në Shqipëri.

Ashtu si edhe Packer dhe Zhu, (2012) është krijuar një variabël cilësor, të quajtur **Dum\_cris**, i cili merr vlerën 1 gjatë periudhës së krizës globale financiare, 2008T4-2010T3. Ky variabël ndërvepron si me normën reale të rritjes së PBB-së, **GDP\_g**, ashtu edhe me treguesin e të ardhuravepara taksave, interesave dhe provigjioneve, **EBTP<sub>i,t</sub>**. Vlerësimet e marra nëpërmjet teknikës së Arellano-Bond, (1991) janë paraqitur në tabelën 17, specifikimi i 1 dhe 2.

Fillimisht është parë nëse kriza financiare ka patur ndikim apo jo në sjelljen e bankave ndaj provigjionimit të humbjeve nga huatë. Rezultatet e paraqitur në specifikimin 1, tregojnë që gjatë periudhës së krizës financiare globale, bankat kanë krijuar më shumë provigjione se në periudhën përpara dhe pas krizës. Për më tepër është parë nëse kjo krizë financiare e ka thelluar apo jo sjelljen prociklike të provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe zbutjen e të ardhurave. Dy nga koeficientët për të cilat interesohemi janë pikërisht ato përpara treguesve **Dum\_cris\*EBTP<sub>i,t</sub>** dhe **Dum\_cris\*GDP\_g**. Koeficientët para dy treguesve interaktivë kanë rezultuar të dy negativë, por statistikisht të parëndësishëm. Vlerësimet empirike tregojnë që kriza financiare globale ka vazhduar të kontribuojë në prociklikalitetin e provigjionimit të humbjeve nga huatë, rezultat ky i konfirmuar nga shenja negative, por ka rezultuar statistikisht i parëndësishëm. Gjithashtu bankat nuk kanë bërë zbutje të të ardhurave gjatë periudhës së krizës financiare globale, konfirmuar nga shenja negative dhe e parëndësishme para treguesit **Dum\_cris\*EBTP<sub>i,t</sub>**.



**Tabela 17: Impakti i krizës financiare në LLP.**

Variablat shpjegues	Variabli endogjen: $LLP_{i,t}$ , Modele me variabla cilësorë	
	Specifikimi (1) Vlerësimi me dy etapa i Arellano-Bond	Specifikimi (2) Vlerësimi me dy etapa i Arellano-Bond
$LLP_{i,t-1}$	0.3475 (0.152)	0.3968*** (0.005)
$NPL_{i,t}$	0.0166*** (0.000)	0.0181*** (0.000)
$DNPL_{i,t}$	0.0115*** (0.000)	0.0133*** (0.000)
$Loan\_rate_{i,t}$	0.0123 (0.235)	0.0123 (0.235)
$EBTP_{i,t}$	0.1651*** (0.000)	0.1848*** (0.000)
$CAP_{i,t}$	0.0001 (0.773)	0.0002 (0.773)
$SIGN_{i,t}$	-0.00008 (0.748)	-0.00003 (0.748)
$GDP\_g_{i,t}$	-0.0180*** (0.029)	-0.0314 (0.137)
$Dum\_cris$	0.0007** (0.055)	NA
$Dum\_cris * EBTP$ (slope dummy)	NA	-0.5415 (0.363)
$Dum\_cris * GDP\_G$ (slope dummy)	NA	-0.0124 (0.152)
Numri i vëzhgimeve.	540	540
Numri i bankave	15	15

*Shënim:* Vlerat e probabilitetit janë paraqitur në kllapa, ku \*, \*\*dhe \*\*\* përfaqësojnë nivelin e rëndësisë përkatësisht në 90 %, 95 % dhe 99 %. Variablat shpjegues me vonesë kohore janë përdorur si variabla instrumentale për ekuacionin e diferencuar.

### 3.3.4. Testimi i qëndrueshmërisë së rezultateve

Për të siguruar që rezultatet të jenë sa më të qëndrueshme kemi përdorur edhe tregues të tjerë alternativë për rritjen ekonomike dhe normën e kapitalit. Kështu në vend të normës reale të rritjes së PBB-së, kemi përdorur treguesin e output gap-it matur si diferencë midis normës reale të rritjes së PBB-së dhe mesatares historike të tij. Rezultatet e gjetura të paraqitur në tabelën 16, (kolona e parë) konfirmojnë edhe një herë lidhjen negative dhe statistikisht të rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve dhe huasë dhe *output gap-it*. Pra gjatë fazave të gjallërimit ekonomik bankat krijojnë më pak provigjione dhe i rrisin më shumë ato gjatë rënies ekonomike,

duke nënvizuar kështu natyrën prociklike të provigjioneve. Ndërkohë që rezultatet e tjera midis treguesit të varur **LLP** dhe treguesve të tjerë rikonfirmohen si në tabelën 18.

Gjithashtu në vend të normës së kapitalit ndaj totalit të aktiveve, ashtu si Fonseca dhe Gonzales, (2008) kemi përdorur *gap-in* e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit llogaritur si diferencë midis normës së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe mesatares së saj. Arsyeja e zgjedhjes së këtij treguesi lidhet me faktin që bankat në Shqipëri kanë qenë gjithmonë të mirëkapitalizuara, me norma kapitali mbi minimalen e kërkuar nga Banka e Shqipërisë. Në tabelën 18, (kolona e dytë) janë paraqitur rezultatet e marra, të cilat konfirmojnë që edhe midis **LLP** dhe *gap-it* të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit gjejmë një lidhje pozitive, por statistikisht të parëndësishme. Këto rezultate konfirmojnë edhe njëherë që bankat nuk e kanë përdorur **LLP** si mjet për të manaxhuar kapitalin. Ndërsa rikonfirmohen të njëjtat rezultate midis **LLP** dhe të gjithë treguesve të tjerë, si në modelin bazë të paraqitur në tabelën 13.

Të gjitha modelet e prezantuar janë vlerësuar me anë të metodës së *GMM-së*, si dhe të gjithë i plotësojnë kushtet e vlerësimit me anë të kësaj metode. Kjo përkthehet në modele të identifikuar saktë dhe me mbetje të pakorreluara, konfirmuar si nga testi Sargan ashtu edhe nga testi i Arellano-Bond për autokorrelacionin.

**Tabela 18: Rezultatet nga tregues alternativë të rritjes ekonomike dhe kapitalit.**

Variablat shpjegues	Variabli endogjen: $LLP_{i,t}$ ,	
	Specifikimi (1) Vlerësimi me dy etapa i Arellano-Bond	Specifikimi (2) Vlerësimi me dy etapa i Arellano-Bond
$LLP_{i,t-1}$	0.3967*** (0.003)	0.3967*** (0.003)
$NPL_{i,t}$	0.0156*** (0.000)	0.0156*** (0.000)
$DNPL_{i,t}$	0.0111*** (0.000)	0.0111*** (0.000)
$Loan\_rate_{i,t}$	0.0163** (0.010)	0.0163** (0.010)
$EBTP_{i,t}$	0.1616*** (0.000)	0.1616*** (0.000)
$CAP_{i,t}$	(0.000018) (0.720)	
$Car\_gap_{i,t}$		(0.000016) (0.720)
$SIGN_{i,t}$	-0.000019 (0.845)	-0.0000045 (0.828)
$GDP\_g_{i,t}$		-0.01952** (0.016)
$GDP\_gap_{i,t}$	-0.0195** (0.016)	
Testi Sargan mbi identifikimin e kufizimeve		
H0:kufizimet e identifikimit janë të vlefshme	Prob> chi2 = 1.0000	Prob> chi2= 1.0000
Testi i Arellano-Bond për autokorrelacion zero të diferencës së parë të gabimeve		
Rendi i 1-vlera e p	0.0113***	0.0113***
Rendi i 2-vlera e p	0.0826*	0.0826*
Numri i vëzhgimeve.	540	540
Numri i bankave	15	15

*Shënim:* Vlerat e probabilitetit janë paraqitur në kllapa, ku \*, \*\*dhe \*\*\* përfaqësojnë nivelin e rëndësisë përkatësisht në 90 %, 95 % dhe 99 %. Variablat shpjegues me vonesë kohore janë përdorur si variabla instrumentale për ekuacionin e diferencuar.

## KAPITULLI 4

### KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

---

Kriza e fundit financiare theksoi edhe njëherë nevojën për të kufizuar prociklikalitetin e sistemit financiar dhe marrjen e masave të caktuara për të adresuar këtë problem. Ku ndër masat kryesore ishte orientimi i politikave drejt politikave makroprudenciale, të cilat jo vetëm që do të zbusin efektet e shkaktuara nga krizat financiare, por edhe do të parandalojnë dhe ti manaxhojnë më së miri ato në të ardhmen. Komiteti i Bazelit mbi Mbikqyrjen Bankare në 2009 mori një sërë hapash të rëndësishëm rregullativë me qëllim uljen e prociklikalitetin të sistemit financiar, ndryshime këto që u fokusuan në axhustimin e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në mënyrë kundërciklike dhe drejt praktikave dinamike të provigjionimit. Qëllimi kryesor i këtyre politikave makroprudenciale është zbehja e efektit prociklik të sistemit financiar me qëllimin sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit financiar.

Ashtu si e kemi përmendur edhe në fillim, kapitali dhe provigjionimi i humbjeve nga huatë duhet të shërbejnë si absorbues të goditjeve që vijnë si nga brenda, ashtu edhe nga jashtë sistemit financiar. Rezervat e humbjeve nga huatë dhe veçanërisht provigjionimi i përgjithshëm i humbjeve nga huatë ka për qëllim që të mbulojë humbjet e pritshme. Nga ana tjetër kapitali rregullator ka për qëllim të absorbojë humbjet e papritura, që ndodhen me një probabilitet të ulët ndodhjeve. Duke u nisur nga funksioni që ka si kapitali rregullator dhe provigjionimi i humbjeve nga huatë, përcaktimi i saktë i humbjeve aktuale dhe të pritshme luan një funksion të rëndësishëm në politikat që ndjekin bankat. Kështu bankat, të cilat përdorin provigjionimin e humbjeve nga huatë për të mbuluar humbjet e pritshme të matura saktësisht dhe që adaptojnë skema provigjionimi që janë *forward-looking* kjo bën që ato banka të ndikohen më pak nga luhatsmëritë e ciklit të biznesit, si dhe të mos ulin kreditimin si rezultat i kufizimeve të kapitalit. Ky material nëpërmjet investigimit të ciklikalitetit të provigjionimit të humbjeve nga huatë në Shqipëri gjatë periudhës 2004-2014, ka për qëllim që të ndihmojë vendimmarrësit në zgjedhjen e politikave të duhura makroprudenciale.

Bazuar në metodologjinë e Bouvateri dhe Lepetit, (2008), Packer dhe Zhu, (2012) materiali investigon se cilët faktorë udhëheqin sjelljen e provigjionimit të humbjeve nga huatë të bankave në Shqipëri gjatë periudhës 2004-2014. Për më tepër vlerëson se si karakteristikat e bankave dhe kriza e fundit financiare kanë ndikuar në sjelljen e bankave ndaj provigjionimit të humbjeve nga huatë.

Rezultatet e marra nga vlerësimi i paneleve dinamike të Arellano dhe Bond, (1991) mbi të dhënat individuale të bankave në Shqipëri tregojnë që sjellja e provigjionimit të këtyre bankave udhëhiqet më së shumti nga *komponenti jo-diskrecionar* dhe nga faktori makroekonomik.

Kështu në linjë me pritshmëritë është gjetur një lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe treguesve përafres të rrezikut të kredisë, që janë norma e kredive me probleme ndaj totalit të kredisë dhe diferenca e normës së kredisë me probleme. Ky rezultat tregon që bankat rrisin më shumë provigjionet kur kanë një rrezik aktual të lartë të kredisë dhe presin një rrezik të lartë të ardhshëm të kredisë. Për më tepër është gjetur një lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë me raportin e kredive ndaj totalit të aktiveve, që tregon për disa elementë *forward-looking* të sjelljes së bankave në lidhje me provigjionimin e humbjeve nga huatë.

Ne kemi testuar gjithashtu nëse bankat në Shqipëri kanë përdorur provigjionimin e humbjeve nga huatë si një mjet për të manaxhuar të ardhurat, kapitalin dhe për sinjalizuar fortësinë financiare. Evidencat empirike tregojnë për një lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve nga huatë dhe fitimit para taksave, interesave dhe provigjioneve. Ky rezultat tregon se bankat kanë rritur më shumë provigjionet kur kanë patur fitime të larta, si dhe kanë krijuar më pak provigjione kur fitimet e tyre kanë qenë të ulta. Rezultat ky që konfirmon që bankat në Shqipëri kanë përdorur *LLP*, si një mjet për të menaxhuar fitimet, duke konfirmuar hipotezën e zbutjes së të ardhurave (ose *income smoothing*).

Ndërkohë që rezultatet empirike nuk konfirmojnë as hipotezën e manaxhimit të kapitalit, as hipotezën e sinjalizimit. Ky rezultat shpjegohet nga niveli i bollshëm i kapitalit që kanë bankat në Shqipëri, duke i bërë ata immune nga goditjet e ndryshme që mund të pësoi sistemi financiar.

Në linjë me pritshmëritë teorike rezultatet e këtij materiali evidentojnë një lidhje negative dhe statistikisht të rëndësishme midis provigjionimit të humbjeve dhe huasë dhe normës reale të rritjes së PBB-së, duke treguar ekzistencës e ciklikitetit të sjelljes së provigjioneve me ciklin e biznesit. Ky rezultat konfirmon që politikat aktuale të provigjionimi të humbjeve nga huatë nga ana e bankave në Shqipëri janë *backward-looking*, pra ato nuk duket se kanë krijuar rezerva të mjaftueshme gjatë pikave të larta të ciklit ekonomik për të përballuar materializimin e rrezikut në kushte e rënies ekonomike. Megjithatë duhet të themi se sjellja prociklike e bankave zbehet pak nga lidhja pozitive që rezultoi midis *LLP*-së dhe fitimeve para taksave, interesave dhe provigjioneve, që tregon se bankat janë sjellë në mënyrë të kujdeshme, për ti bërë ballë ditëve të këqija që mund të vijnë (Bikker dhe Metzmakers, 2005).

Ne kemi parë gjithashtu se si madhësia dhe niveli i kapitalizimit të bankave ndikon në skemat e provigjionimit të humbjeve nga huatë. Rezultatet empirike tregojnë që bankat e mëdha mbajnë një nivel më të ulët provigjionesh në krahasim me bankat e vogla dhe për më tepër (bankat e mëdha) i kanë përdorur provigjionet për të menaxhuar të ardhurat, se për të zvogëluar prociklikitetin ndaj rritjes ekonomike. Evidencat empirike tregojnë që bankat e mirëkapitalizuara sillen në mënyrë kundërciklike dhe nuk kanë bërë zbutje të të ardhurave përkundrejt bankave më pak të mirëkapitalizuara.

Duke qenë se periudha që ne analizojmë përfshin edhe krizën e fundit financiare globale, ne kemi testuar impaktin e saj në sjelljen e bankave ndaj provigjionimit të humbjeve nga huatë. Rezultatet e marra tregojnë që gjatë periudhës së krizës financiare bankat kanë krijuar më shumë provigjione se sa gjatë periudhës para saj. Gjithashtu bankat nuk kanë bërë zbutje të të ardhurave dhe gjejmë se është zbehur lidhja prociklike e provigjionimit të humbjeve nga huatë me rritjen ekonomike, e cila ka rezultuar negative por statistikisht e parëndësishme.

Evidenca empirike e prezantuar në këtë material tregon që modeli i provigjionimi të humbjeve nga huatë në rastin e Shqipërisë është *backward-looking*. Kjo nënkupton që bankat në Shqipëri duhet të jenë më larg-pamëse (*forward-looking*) në politikat e tyre të provigjionimit të humbjeve nga huatë, duke bërë që politikat e tyre të provigjionit të jenë kundërciklike. Bankat kështu duhet të krijojnë provigjione para se humbja e

kredisë të ndodhë, duke ndikuar në këtë mënyrë që bankat të jenë më efektive në uljen e rrezikut të kredisë.

Kështu nga pikë pamja makroprudenciale, adaptimi i skemave dinamike të provigjionimit të humbjeve nga huatë ndihmon për të zbutur efektin prociklik të sistemit bankar. Identifikimi i hershëm i humbjeve dhe mbulimi i tyre me anë të provigjionimit të humbjeve nga huatë, i mundëson bankat që të krijojnë rezerva për humbjet nga huatë, të cilat do ti përdorin kryesisht gjatë pë riudhave të rënies ekonomike. Kjo natyrë kundërciklike e provigjioneve siguron kështu një qëndrueshmëri më të mirë financiare si të bankave në mënyrë individuale, ashtu edhe të sistemit bankar në tërësi. Pra provigjionimi i humbjeve nga huatë shërben si një mjet i rëndësishëm për të zbutur natyrën prociklike të sistemit financiar.

Propozimet për skema *forward-looking* të provigjionimit të humbjeve nga huatë kanë qenë në fakt subjekt i dy kritikave të ndryshme. Shqetësimi i parë lidhet me faktin që kjo skemë provigjionimi i krijon më shumë hapësirë bankave për të zbutur në mënyrë artificiale fitimin, duke e bërë më të vështirë për investitorët vlerësimin mbi pozicionin e vërtetë të bankës. Një shqetësim më se i drejtë pasi bankat përdorin gjykimin për vlerësimin e humbjeve të pritshme. Publikimi nga ana e bankave për mënyrën e llogaritjes së provigjionimit të humbjeve nga huatë shërben për ta zvogëluar këtë shqetësim në sytë e investitorëve. Shqetësimi i dytë lidhet me faktin që skemat e provigjionimit të humbjeve nga huatë në vend që ta ulin luhatshmërinë e fitimeve të bankave, ato mund ta rrisin akoma më shumë. Ky fakt mund të rezultojë nga luhatshmëria e normave të interesit të tregut, që përdoren për të skontuar flukset e ardhshme të aktiveve dhe pasiveve të bilance të bankave.

Megjithatë adaptimi i skemave *forward-looking* të provigjionimit të humbjeve nga huatë jo domosdoshmërisht do të thotë ndryshimin e plotë të rregullave kontabël. E rëndësishme është që nëpërmjet kësaj përqsaje bankat të axhustojë vlerën e huasë me vlerat e pritshme të humbjeve nga huatë, pra të krijojnë më shumë provigjione gjatë periudhave të gjallërimit ekonomik kur rreziku apo humbjet e pritshme rriten dhe të krijojnë më pak provigjione gjatë periudhave të rënies ekonomike. Në këtë mënyrë bankat janë të gjendje që të sillen në mënyrë më të kujdesshme duke zbehur efektin prociklik të sistemit financiar.

Një adaptim më i mirë i skemave largpamëse të provigjionimit të humbjeve nga huatë kërkon gjithashtu një vlerësim të mirë të rrezikut të kredisë, të humbjeve aktuale dhe të pritshme nga kreditimi, si nga banka qendrore ashtu edhe nga bankat e nivelit të dytë. Një veprim i tillë do të sjellë një përmirësim të statistikave financiare dhe të mjeteve për të vlerësuar krijimin e rrezikut sistemik që janë elementë të rëndësishëm për krijimin e një strukturë të fortë makroprudenciale.

Nëpërmjet investigimit të faktorëve përcaktues të provigjionimit të humbjeve nga huatë, ky material synon të kontribuojë nëpërmjet evidencave empirike për rastin e bankave në Shqipëri, megjithatë duhet të pranojmë se analiza jonë vuan nga disa kufizime.

Së pari, si kufizim të modelit përmendim të dhënat e sistemit bankar dhe ato të aktivitetit ekonomik. Ky punim merr në konsideratë vitet 2004-2014, që përfshin vetëm një cikël të plotë financiar. Kjo periudhë përkon me një periudhë ndryshimesh dhe maturimi të tregut bankar në Shqipëri, por njëkohësisht përfshin edhe periudhën e krizës financiare. Ndryshimet apo masat makroprudenciale e marra nga Banka e Shqipërisë gjatë kësaj periudhe nuk janë përfshirë në vlerësimet dhe në analizën tonë empirike. Gjithashtu edhe të dhënat tremujore të PBB-së, kanë qenë dhe janë subjekt i revizionimeve të shumta, për më tepër që ka patur ndryshime metodologjike në 2010, që nuk janë pasqyruar ende nga Instat për seritë nga viti 2004 deri në 2008.

Tjetër kufizim i modelit, është mos marrja parasysh e nivelit të kolateralizimit të kredisë për secilën nga bankat. Një karakteristikë e tregut të kredisë në Shqipëri është se bankat për të qenë sa më të mbrojtura ndaj goditjeve të ndryshme kërkojnë që vlera e kolateralit të jetë më e madhe se vlera e kredisë. Kështu sjellja e provigjionimit të humbjeve nga huatë e bankave është e ndikuar edhe nga ky element, mos përfshirja e të cilët mund ta kufizojë disi modelin tonë.

Në këtë material kemi analizuar vetëm dimension kohor të provigjionimit të humbjeve nga huatë, me interes do të ishte edhe analizimi i dimensionit ndër-sektorial. Kështu si pjesë e kërkimeve të mëtejshme do të ishte e domosdoshme edhe vlerësimi i efektit të provigjionimit të humbjeve nga huatë në ofertën e kredisë bankare. Ndryshimet rregullative mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit janë futur në fuqi në 1 janar të 2015, prandaj do të ishte me interes që në të ardhmen të



vlerësohej impakti që do të ketë ky ndryshimin në sjelljen e bankave ndaj provigjionimit të humbjeve nga huatë.

## Referenca

Ahmed, A., Takeda, C., and Thomas, Sh., (1999), "Bank Loan Loss Provisions: A Reexamination of Capital Management, Earnings Management and Signaling Effects." *Journal of Accounting and Economics*, Volume 28, Issue 1: 1-25, [http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=84188](http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=84188)

Aiyar, Sh., Calomiris, Ch.W., and Wieladek, T., (2014). "How Does Credit Supply Respond to Monetary Policy and Bank Minimum Capital Requirements?," *Bank of England WP No.508*.  
<http://www.bankofengland.co.uk/research/Pages/workingpapers/2014/wp508.aspx>

Alessi, M., Di Colli, S., and Lopez, J.G. (2014) "Loan Loss Provisioning and Relationship Banking in Italy: Practices and Empirical Evidence" *Journal of Entrepreneurial and Organizational Diversity*, Vol 3, 111-129. [http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=2450081##](http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2450081##)

Allen, F., and Gale, D., (1994). "Limited Market Participation and Volatility of Asset Prices," *American Economic Review*, 84(4), pp. 933-55.

Allen, F., and Gale, D., (2000) "Financial Contagion," *Journal of Political Economy*, 108 (1), pp. 1-33.  
<http://finance.wharton.upenn.edu/~allenf/download/Vita/contagion.pdf>

Allen, F., and Gale, D., (2007), "Understanding Financial Crises", Clarendon Lectures in Finance (Oxford, UK: Oxford University Press). [file:///D:/Download/Allen\\_Gale\\_Understanding\\_Financial\\_Crises\\_2007.pdf](file:///D:/Download/Allen_Gale_Understanding_Financial_Crises_2007.pdf)

Allen, W.A. and Wood, G., (2006), "Defining and achieving financial stability," *Journal of Financial Stability*, Volume 2(2), pp 152-172.  
<http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S1572308906000209>

Anandarajan, A., Hasan, I., and McCarthy., C. (2006). "The use of loan loss provisions for capital management, earnings management and signalling by Australian banks", *Bank of Finland Research Discussion Papers*, 23. [http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=1019949](http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=1019949)

Anderson, T. W., and Hsiao, C., (1981), "Estimation of Dynamic Models with Error Components", *Journal of the American Statistical Association*, 76, 598-606.

Arellano, M., and Bond.,S (1991). "Some tests of specification for panel data: Monte Carlo "evidence and an application to employment equations." *The Review of Econometric Studies* 58: 277-297, [http://www.jstor.org/stable/2297968?seq=1#page\\_scan\\_tab\\_contents](http://www.jstor.org/stable/2297968?seq=1#page_scan_tab_contents)

Arellano, M., and Bover, O., (1995). “Another look at the instrumental variables estimation of error components models”, *Journal of Econometrics* Vol 68.

Ayuso, J., Perez, D., and Saurina, J. (2004). “Are Capital Buffers Pro-cyclical? Evidence from Spanish Panel Data”. *Journal of Financial Intermediation*, Vol 13, <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S1042957303000445>

Bank of England (2009), “The role of macroprudential policy – discussion paper”, <http://www.bankofengland.co.uk/publications/other/financialstability/roleofmacroprudentialpolicy091121.pdf>

Basel Committee on Banking Supervision (2009), “Strengthening the resilience of the banking sector-consultative document”, <http://www.bis.org/publ/bcbs164.pdf>

Basel Committee on Banking Supervision (BCBS) and Financial Stability Board (FSB), 2013, “Global systemically important banks: updated assessment methodology and the higher loss absorbency requirement,” July, <http://www.bis.org/publ/bcbs255.pdf>

Basel Committee on Banking Supervision (BCBS), 2010, “Assessing the Macroeconomic Impact of the Transition to Stronger Capital and Liquidity Requirements – Final Report”, December. <http://www.bis.org/publ/othp12.pdf>

Basel Committee on Banking Supervision (BCBS), 2010a, “Countercyclical Capital Buffer Proposal, Consultative Document”, Bank for International Settlements, Basel.

Basel Committee on Banking Supervision (BCBS), 2010b. “An assessment of the long-term economic impact of the new regulatory framework (of stronger capital and liquidity requirements).” <http://www.bis.org/publ/bcbs173.pdf>

Basel Committee on Banking Supervision (BCBS), 2011, “Basel III: A Global Regulatory Framework for More Resilient Banks an Basel Committee on Banking Supervision (BCBS), and Banking Systems,” <http://www.bis.org/publ/bcbs189.htm>

Beatty, A., and Liao, S., (2009). Regulatory Capital Ratios, Loan Loss Provisioning and Pro-cyclicality, *Working Paper for seminar at Indiana University and University of Missouri*.

Beaver, W., Eger, C., Ryan, S., and Wolfson, M., (1989), “Financial reporting and the structure of bank share prices”. *Journal of Accounting Research* 27, 157–178.

Beaver, W.H. and Engel, E., (1996), “Discretionary behavior with respect to allowances for loan losses and the behavior of security prices”. *Journal of Accounting and Economics* 22, 177-206.

Bebchuk, L., and Goldstein, I., (2011), “Self-Fulfilling Market Freezes,” *Review of Financial Studies*, 24(11), pp. 3519–55 <http://rfs.oxfordjournals.org/content/24/11/3519.short>

Berger, A.N and Udell, G.F., (2003). “The institutional memory hypothesis and the procyclicality of bank lending behaviour”, *BIS Working Paper No.125*. <http://www.bis.org/publ/work125.pdf>

Bernanke, B.S., and Blider, A.S. (1988). “Credit, Money And Agregate Demande”, *The American Economic Review*, Vol 78. [http://www.jstor.org/stable/1818164?seq=1#page\\_scan\\_tab\\_contents](http://www.jstor.org/stable/1818164?seq=1#page_scan_tab_contents)

Bernanke, B.S., and Gertler, M. (1995). “Inside the black box: The credit channel of Monetary policy transmission”. *Journal of Economic Perspectives*, Vol 9(4). <http://pubs.aeaweb.org/doi/pdfplus/10.1257/jep.9.4.27>

Bhat, V., (1996), “Banks and income smoothing- An empirical analysis”. *Applied Financial Economics* 6, 505–510. <http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/096031096333953?journalCode=rafe20>

Bikker, J. A., and Metzmakers, P. A. J. (2005), “Bank Provisioning Behavior And Procyclicality”, *Journal of International Financial Market, Institutions and Money*, <http://ejournal.narotama.ac.id/files/Bank%20provisioning%20behaviour%20and%20procyclicality.pdf>

Bikker, J.A., and Hu, H., (2002), “Cyclical Patterns in Profits, Provisioning and Lending of Banks”, *DNB Staff Reports*, [http://www.dnb.nl/binaries/ot039\\_tcm46-146052.pdf](http://www.dnb.nl/binaries/ot039_tcm46-146052.pdf)

Blundell, R., and Bond, S., (1998). “Initial conditions and moment restrictions in dynamic panel data models”. *Journal of Econometrics* 87, <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0304407698000098>

Borio, C., (2003). “Towards a macroprudential framework for financial supervision and regulation?”. *BIS Papers*, <http://www.bis.org/publ/work128.pdf>

Borio, C., (2009). “The macroprudential approach to regulation and supervision”. <http://www.voxeu.org/article/we-are-all-macroprudentialists-now>

Borio, C., and Lowe, Ph., (2001). “To provision or not to provision”. *BIS Quarterly Review*, [http://www.bis.org/publ/r\\_qt0109e.pdf](http://www.bis.org/publ/r_qt0109e.pdf)

Borio, C., Furfine, C., and Lowe, P., (2001). “Procyclicality of the financial system and financial stability: issues and options”, *BIS Papers*, <http://www.bis.org/publ/bppdf/bispap01a.pdf>

Borio, C., and Drehman, M., (2009). “Assessing the risk of crises-revisited”, *BIS Quarterly Review, March*, [http://www.bis.org/publ/qtrpdf/r\\_qt0903e.pdf](http://www.bis.org/publ/qtrpdf/r_qt0903e.pdf)

Bouvatier, V., and Lepetit, L., (2008). “Banks’ procyclical behavior: Does provisioning matter?”, *Journal of International Financial Markets, Institutions, and Money, Vol.18*. <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S1042443107000388>

Brunnermeier, M., Crocket, A., Goodhart, C., Hellwig, M., Persaud, A., and Shin, H., (2009). “The Fundamental Principles of Financial Regulation”, *Geneva Report on the World Economy, No.11*. <http://www.princeton.edu/~markus/research/papers/Geneva11.pdf>

Bruno, V., and Shin, H.S. (2014), “Assessing Macroprudential Policies: Case of South Korea,” *Scandinavian Journal of Economics*, 116 (1), pp. 128-157.

Cani, Sh., and Hadëri, S., (2002), “Sistemi Financiar Shqiptar në tranzicion: Progres apo Brishtësi? *Banka e Shqipërisë*, Konferenca “Banka e Shqipërisë në dekadën e dytë të tranzicionit”. [http://www.bankofalbania.org/web/pub/cani\\_haderi\\_ang\\_203\\_1.pdf](http://www.bankofalbania.org/web/pub/cani_haderi_ang_203_1.pdf)

Cavallo, M., and Majnoni, G. (2001), “Do Banks Provision for Bad Loans in Good Times? Empirical Evidence and Policy Implications”, *World Bank Policy Research Paper, No.2619* [http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=632687&rec=1&srcabs=2508461&alg=5&pos=9](http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=632687&rec=1&srcabs=2508461&alg=5&pos=9)

Cerutti, E., Claessens, S., and Leaven, L., (2015). “The use and effectiveness of macroprudential policies; New evidence”, *IMF working Paper 15/16*. <https://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2015/wp1561.pdf>

Cerutti, E., Claessens, S., and Ratnovski, L.,(2014). “Global Liquidity and Drivers of Cross-border Bank Flows,” *IMF working Paper*, 14/69.<http://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2014/wp1469.pdf>

Claessens, S., Ghosh,S., and Mihet,R.,(2013). “Macro-Prudential Policies to Mitigate Financial System Vulnerabilities,” *Journal of International Money and Finance*, 39<http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S026156061300096X>

Classen, S., (2014) “An overview of Macroprudential Policy Tools”, *IMF Working Papers*, WP1/2,<http://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2014/wp14214.pdf>

Collins, J.H. Shackelford, D.A and Wahlen, J.M (1995), “Bank differences in the coordination of regulatory capital, earnings and taxes.” *Journal of Accounting Research* 33(2), 263 292.  
[https://www.jstor.org/stable/2491488?seq=1#page\\_scan\\_tab\\_contents](https://www.jstor.org/stable/2491488?seq=1#page_scan_tab_contents)

Copeland, R. M. (1968), "Income Smoothing." *Empirical Research in Accounting: Selected Studies*, 101-116.

Crowe, Ch.,Dell’Ariccia,G., W., Igan,D., and Rabanal,P.,(2011). “How to Deal with Real Estate Booms,” *IMF Staff Discussion Note* 11/02.<http://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2011/wp1191.pdf>

D’Hulster, K., Salomao-Garzia, V., and Letelier, R., (2014). “Loan classification and provisioning: Current practices in 26 countries”, *World Bank Group Working paper* 9281,  
<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/21109/928310WP0P143704Box385375B00PUBLIC0.pdf;jsessionid=D1F10315B3F49907B56354CD06FC6F85?sequence=1>

Dassatti., C. and Peydro,J-L., (2014). “Macroprudential and Monetary Policy: Loan-Level Evidence from Reserve Requirements,”[http://crei.cat/people/peydra/peydra\\_dassati.pdf](http://crei.cat/people/peydra/peydra_dassati.pdf)

De Mooij, R.A.,. (2011) “Tax Biases to Debt Finance: Assessing the Problem, Finding Solutions,” *IMF Staff Discussion Note* 11/11.<http://www.imf.org/external/pubs/ft/sdn/2011/sdn1111.pdf>

Dell’Ariccia, G., Igan, D.,Laeven, L., and Tong,H., with Bakker, B., and Vandenbussche, J.,(2012). “Policies for Macrofinancial Stability: How to Deal with

Credit Booms,” *IMF Staff Discussion Note* 12/06. <http://www.imf.org/external/pubs/ft/sdn/2012/sdn1206.pdf>

Diamond, D. W., and Rajan, R.G (2011), “Fear of Fire Sales, Illiquidity Seeking, and the Credit Freezes,” *Quarterly Journal of Economics*, 126(2), 557–91. <http://qje.oxfordjournals.org/content/126/2/557.short>

Esty, B., (1997), “Organizational Form and Risk-taking in the Savings and Loan Industry.” *Journal of Financial Economics*. 44, pp. 25-55

Financial Stability Board (2009). “Guidance To Assess The Systemic Importance Of Financial Institutions, Markets And Instruments: Initial Considerations”, *Report to G20 Finance Ministers and Governors*, [http://www.financialstabilityboard.org/publications/r\\_091107c.pdf](http://www.financialstabilityboard.org/publications/r_091107c.pdf)

Financial Stability Forum (2009). “Report Of The Financial Stability Forum On Addressing Procyclicality In The Financial System”, [http://www.financialstabilityboard.org/publications/r\\_0904a.pdf](http://www.financialstabilityboard.org/publications/r_0904a.pdf)

Fonseca, A., and Gonzalez, F., (2008). “Cross-country determinants of bank income smoothing by managing loan loss provisions.” *Journal of Banking & Finance*. Volume 32 Issue 2, 2008. [http://econpapers.repec.org/article/eejbfina/v\\_3a32\\_3ay\\_3a2008\\_3ai\\_3a2\\_3ap\\_3a217-228.htm](http://econpapers.repec.org/article/eejbfina/v_3a32_3ay_3a2008_3ai_3a2_3ap_3a217-228.htm)

Gaston, E., and Song, I.V., (2014).” Supervisory Roles in Loan Loss Provisioning in Countries Implementing IFRS”, *IMF Working Paper*, 14/170, <http://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2014/wp14170.pdf>

Goldstein, I., Ozdenoren, E., and Yuan, K., (2013), “Trading Frenzies and Their Impact on Real Investment,” *Journal of Financial Economics*, 109(2), pp. 566-582. <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0304405X13000913>

Gorton, G., and Rosen, R., (1995). “Corporate control, portfolio choice, and the decline of banking”, *Journal of Finance* 50, pp 1377-420, <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1540-6261.1995.tb05183.x/abstract>

Greenawalt, M.B. and Sinkye, J. JR. (1988), “Bank loan loss provisions and the income smoothing hypothesis: An empirical analysis, 1976–1984”, *Journal of Financial Services Research* 1, 301–318. [http://link.springer.com/article/10.1007%2F978-1-4020-0235-2\\_1#page-1](http://link.springer.com/article/10.1007%2F978-1-4020-0235-2_1#page-1)

Guttentag, J. M. and Herring, R.J., (1984). “Credit Rationing and Financial Disorder”, *Journal of Finance*, 39(5), pp 1359-1382. <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1540-6261.1984.tb04912.x/abstract>

Guttentag, J.M., and Herring, R.J., (1986). “Disaster Myopia in International Banking” *Essays in International Finance*, No. 164, International Finance Section, Princeton University. [https://www.princeton.edu/~ies/IES\\_Essays/E164.pdf](https://www.princeton.edu/~ies/IES_Essays/E164.pdf)

Hansen, L. P. (1982), "Large Sample Properties of Generalized Method of Moments Estimators", *Econometrica*, 50, 1029-1054,

[http://faculty.chicagobooth.edu/john.cochrane/teaching/35904\\_asset\\_pricing/Hansen%20econometrica%20GMM.pdf](http://faculty.chicagobooth.edu/john.cochrane/teaching/35904_asset_pricing/Hansen%20econometrica%20GMM.pdf)

Healy, P. M. (1985), "The Effects of Bonus Schemes on Accounting Decisions." *Journal of Accounting and Economics* 7, 85-107. [http://econ.au.dk/fileadmin/Economics\\_Business/Education/Summer\\_University\\_2012/6308\\_Advanced\\_Financial\\_Accounting/Advanced\\_Financial\\_Accounting/4/Healy\\_JAE\\_1985.pdf](http://econ.au.dk/fileadmin/Economics_Business/Education/Summer_University_2012/6308_Advanced_Financial_Accounting/Advanced_Financial_Accounting/4/Healy_JAE_1985.pdf)

Hoogervorst, H., (2012), "The Imprecise World of Accounting," speech at *IAAER Conference (Amsterdam)*, <http://www.ifrs.org/Alerts/Conference/Pages/HH-speech-Amsterdam-June-2012.aspx>

Ibrahimi, F., and Salko, D.,(2001), "Sistemi Financiar në Shqipëri", Banka e Shqipërisë, *Konferenca e II e Bankës së Shqipërisë*, [https://www.bankofalbania.org/web/pub/cani\\_haderi\\_ang\\_203\\_1.pdf](https://www.bankofalbania.org/web/pub/cani_haderi_ang_203_1.pdf)

Igan, D., and Kang,H.,(2011) "Do Loan-to-Value and Debt-to-Income Limits Work? Evidence from Korea," *IMF Working paper* 11/297 <https://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2011/wp11297.pdf>

IMF, 2013a, "The Interaction of Monetary and Macroprudential Policies," *IMF Policy Paper*, January. <http://www.imf.org/external/np/pp/eng/2013/012913.pdf>

IMF, 2013b, "The Interaction of Monetary and Macroprudential Policies—Background Paper," *IMF Policy Paper*, January, <https://www.imf.org/external/np/pp/eng/2013/012713.pdf>

IMF, 2014a, "Selected Issues paper on Israel," February. *IMF Country Report* 14/48.

IMF, 2014b, "How Big is the Implicit Subsidy for Banks Seen as Too-Important-to-Fail" *Global Financial Stability Report*, Chapter 3, World Economic and Financial Surveys, April.

Jiménez, G., Ongena, S., Peydro, J.L., and Saurina, J.,(2012) "Macroprudential Policy, Countercyclical Bank Capital Buffers and Credit Supply: Evidence from the Spanish Dynamic Provisioning Experiments," *National Bank of Belgium WP No 231* <https://www.nbb.be/doc/ts/publications/wp/wp231en.pdf>

Jimenez, J., and Saurina, J. (2005), "Collateral, type of lender and relationship banking as determinants of credit risk", *Journal of Banking and Finance*, Vol 28, <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0378426603002346>

Jokipii, T., and Milne, A. (2008). "The Cyclical Behavior Of European Bank Capital Buffers". *Journal of Banking and Finance*, 32, <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0378426607003688>

Keeton, W.R. (1999). "Does faster loan growth lead to higher loan losses"? Federal Reserve Bank of Kansas City, Economic Review. <https://www.kansascityfed.org/PUBLICAT/ECONREV/PDF/2q99keet.pdf>



Kiviet, J.F. (1995), "On bias, inconsistency, and efficiency of various estimators in dynamic panel data models". *Journal of Econometrics* 68: 53-78.

Kuttner, K.N., and Shim, I., (2013). "Can non-interest rate policies stabilise housing markets? Evidence from a panel of 57 economies," *BIS Working Papers No 433*. <http://www.bis.org/publ/work433.pdf>

Laeven, L., and Majnoni, G. (2003). "Loan loss provisioning and economic slowdowns: too much, too late?", *Journal of Financial Intermediation*, Vol 12, <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S1042957303000160>

Lambert, R. A. (1984), "Income Smoothing as Rational Equilibrium Behavior." *The Accounting Review*, 604-618.

Lim, Cheng H., Francesco, C., Costa, A., Kongsamut, P., Otani, A., Saiyid, M., Wezel, T., and Wu, X., (2011), "Macroprudential Policy: What Instruments and How Are They Used? Lessons from Country Experiences", *IMF Working Paper 11/238*. <http://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2011/wp11238.pdf>

Liu, C.C., Ryan, S.G., and Wahlen, J.M., (1997). "Differential valuation implications of loan loss provisions across banks and fiscal quarters". *The Accounting Review* 72, 133-146.

Lobo, G.J., and Yang, D.H., (2001), "Bank managers. Heterogeneous decisions on discretionary loan loss provisions", *Review of Quantitative Finance and Accounting* 16, 223-250.

Ma, C. K. (1988) "Loan loss reserve and income smoothing: The experience in the US banking industry." *Journal of Business Finance and Accounting* 15, 487-497

Nickell, S. J. (1984), "An Investigation of the Determinants of Manufacturing Employment in the United Kingdom", *Review of Economic Studies*, 51, 529-557.

Osiński, J., Seal, K., and Hoogduin, L., (2013). "Macroprudential and Microprudential Policies: Towards Cohabitation", *IMF Staff Discussion Note 13/05*. <http://www.imf.org/external/pubs/ft/sdn/2013/sdn1305.pdf>

Packer, F., and Zhu, H., (2012). "Loan loss provisioning practices of Asian banks". *BIS Working Papers No. 375* <http://www.bis.org/publ/work375.pdf>

Perotti, E., and Suarez, J (2011), "A Pigouvian Approach to Liquidity Regulation," *International Journal of Central Banking*, 7(4), 3-41 <http://www.ijcb.org/journal/ijcb11q4a1.htm>

Rajan, R.G., (1994), "Why bank credit policies fluctuate: a theory and some evidence", *The Quarterly Journal of Economics*, <http://faculty.chicagobooth.edu/raghuram.rajan/research/papers/fluct.pdf>

Ramcharan,R., and Rajan,R., (2014), “Financial Fire Sales: Evidence from Bank Failures,” *Finance and Economics Discussion Series*, 2014-67, Federal Reserve Board. <http://www.federalreserve.gov/pubs/feds/2014/201467/201467pap.pdf>

Rodman, D., (2006). “How to Do xtabond2:An Introduction to “Difference” and “System” GMM in Stata”. *Center for Global Development, WP No 103*.<https://ideas.repec.org/p/cgd/wpaper/103.html>

Saunders, A., E. Strock, and N. G. Travlos, (1990), “Ownership structure, deregulation, and bank risk taking,” *Journal of Finance* 45, 643-654.

Saurina, J., (2009) “Loan loss provisions in Spain. A working macro prudential tool”, *Estabilidad Financiera*, 17, *Bank of Spain*.  
<http://www.bde.es/f/webbde/Secciones/Publicaciones/InformesBoletinesRevistas/RevistaEstabilidadFinanciera/09/Noviembre/ief01117.pdf>

Skala, D., (2014), “Income smoothing and procyclicality of loan loss provisions in Central European banks”,  
[http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=2426144](http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2426144)

Shin, H.S. (2010). “Non-Core Liabilities Tax as a Tool for Prudential Regulation,” Policy Mimeo. <http://www.princeton.edu/~hsshin/www/NonCoreLiabilitiesTax.pdf>

Shleifer, A., and Vishny, R., (1992). “Liquidation Values and Debt Capacity: A Market Equilibrium Approach,” *Journal of Finance*, 47:4,pp. pp. 1343–66.  
<http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1540-6261.1992.tb04661.x/abstract>

Van den Heuvel, S., (2002), “Does bank capital matter for monetary transmission?” *Federal Reserve Bank of New York, Economic Policy Review*,  
<https://www.newyorkfed.org/medialibrary/media/research/epr/02v08n1/0205vand.pdf>

Whalen, J.M., (1994), “The nature of information in commercial bank loan loss disclosures”. *The Accounting Review* 69, 455.478.  
[http://www.jstor.org/stable/248234?seq=1#page\\_scan\\_tab\\_contents](http://www.jstor.org/stable/248234?seq=1#page_scan_tab_contents)

Wong, Eric, Tom Fong, Ka-fai Li and Henry Choi, 2011, “Loan-to-Value Ratio as a Macroprudential Tools—Hong-Kong’s Experience and Cross-Country Evidence,” *HKMA Working Paper*, 01/2011 (Hong Kong: Hong Kong Monetary Authority).

Zhang, L., and Zoli,E.,(2014), “Leaning Against the Wind: Macroprudential Policy in Asia,” *IMF Working Paper 14/22*  
<https://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2014/wp1422.pdf>

**Aneks 1**

**Tabela 19: Pikëpamja Makroprudenciale përkundrejt Pikëpamjes Mikroprudenciale.**

	<b>Pikëpamja Makroprudenciale</b>	<b>Pikëpamja Mikroprudenciale</b>
<i>Objektivi i përafërt</i>	Kufizimi i stresit financiar në tërësi	Kufizimi i stresit financiar të institucioneve në mënyrë individuale
<i>Objektivi final</i>	Shmangia e kostove makroekonomike të lidhura me paqëndrueshmërinë financiare	Mbrojtja e konsumatorëve (investitorëve/depozituesve)
<i>Karakteristikat e rrezikut</i>	Endogjen (i varur nga sjellja kolektive)	Ekzogjen (i pavaruar nga sjellja e agjentëve individualë)
<i>Korrelacioni dhe ekspozimi i përbashkët midis institucioneve</i>	I rëndësishëm	I pavend
<i>Kalibrimi i kontrolleve prudenciale</i>	Në terma të rrezikut të gjerë sistemit; <i>top-down</i>	Në terma të rreziqeve individuale të institucioneve; <i>bottom-up</i>

*Burimi:* Borio, (2003).

**Tabela 20: Politikat makroprudenciale dhe instrumentat makroprudencialë.**

Politikat Makroprudenciale					
	<i>Kufizime të lidhura me huamarrësin, mjetin ose aktivitetin</i>	<i>Kufizime në bilancet e sektorit financiar (aktive, pasive)</i>	<i>Kërkesat për kapital, provigjionimi, mbingarkesa, shtesa)</i>	<i>Taskimi, ose vendosja e taksës</i>	<i>Të tjera (që përfshijnë infrastrukturën institucionale)</i>
<i>Faza ekspansioniste</i>	Kapak/limit/rregulla të ndryshueshme në kohë për: -DTI, LTI, LTV -margins, hair-cuts -rritjen e kredisë	Kapak/limite të ndryshueshme në kohë për: -mospërputhje (monedhë e huaj, interesa) -kërkesat për rezervë	Kërkesa kundërciklike të kapitalit, kufizime të levës financiare, provigjionime të përgjithshme (dinamike)	Taksa/taksimi i një aktivispecif dhe/ose pasivi	Mbajtja e llogarive (si për shembull rregulla të ndryshme të tregut), ndryshime të kompesimit, disiplinës së tregut dhe qeverisjes.
<i>Faza kontraktues e; shitjet e flakta, credit crunch</i>	Axhustimet të provigjionimit specifik të humbjeve nga huatë, margins ose hair-cuts (për shembull nëpërmjet ciklit dinamik)	Limite të likuiditetit (si për shembull norma neto e fondeve, norma e mbulimit të likuiditetit.	Kërkesa kundërciklike të kapitalit, kufizime të levës financiare, provigjionime të përgjithshme (dinamike)	Taksa/taksimi i një pasivi jobazë	Produkte të standartizuara -OTC përkundrejt on exchange -Siguri neto (likuiditet nga banka qendrore/thesari, mbështetje fiskale
<i>Përhapja ose shock propagation nga insitucionet financiare sistemike</i>	Kufizimet të ndryshme në kompozimin e aktiveve, aktiviteve (si përshembull rregulli Volcker, Vickers)	Limite – specifike institucione në ekspozimet financiare (dy palëshe, masa të tjera mbi bilancet e bankave	Shtesa mbi kapitalin të lidhura me rrezikun sistematik	Taksa të cilat variojnë sipas eksternaliteve (përmasa, network-u)	-Struktura institucionale, -Zgjidhjet -ndryshimit të informacionit, zbulimit.

*Burimi:* Claessens, Ghosh and Mihet, (2013),

*Shënim:* drejtkëndëshat blu-tregojnë forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit financiar; drejtkëndëshat gri-tregojnë për zvogëlimin (minimizimin) e ciklit; drejtkëndëshat mavi –tregojnë eliminimin e fazës zhvilluese të ciklit.

**Tabela 21: Përmbledhje e instrumentave makroprudencialë globalë.**

Instrumenti	Akronimi	Përkufizimi
<i>Loan-to-Value Ratio</i>  (Kufi mbi normën e vlerës së kredisë)	<i>LTV</i>	Kufizon nivelet e larta të kredisë në sektorin e pasurive të patundshme duke imponuar ose inkurajuar vendosjen e një limiti të caktuar ose duke përcaktuar pesha të caktuar të rrezikut.
<i>Debt-to-Income Ratio</i>  (Norma e borxhit ndaj të ardhurave)	<i>DTI</i>	Kufizon nivelin e borxhit të individëve (ose familjeve) duke imponuar ose inkurajuar vendosjen e një limiti.
<i>Dynamic Loan-Loss Provisioning/ Time Varying</i> (Provigjionimi dinamik i humbjeve nga huatë)	<i>DP</i>	Kërkoheq që bankat të krijojnë ose të mbajnë më shumë provigjione të humbjeve nga huatë gjatë periudhave të rritjes ekonomike.
<i>General Countercyclical capital buffer/requirement</i>  (Masa të përgjithshme kundërciklike)	<i>CTC</i>	Kërkoheq që bankat të mbajnë në nivel më të lartë kapitali gjatë periudhave të rritjes ekonomike.
<i>Leverage ratio</i>  (Norma e levës financiare)	<i>LEV</i>	Kufizon bankat për mbajtjen e një niveli të caktuar minimal të normës së levës financiare.
<i>Capital Surcharges on SIFIs (important financial Institutions)</i>  (Shtesa të kapitalit tek institucionet financiare me rëndësi sistemike)	<i>SIFI</i>	Kërkoheq që Institucionet Financiare më rëndësi sistemike (SIFI) të mbajnë një nivel më të lartë të nivelit të kapitalit sesa tëinstitucioneve e tjera financiare.
<i>Limits on Interbank Exposures</i>  (Limete në ekspozimin ndërbankar)	<i>INTER</i>	Kufizim i atyre fraksioneve të pasivit të bankave që mbahet nga sektori banker.
<i>Concentration Limits</i>  (Limete të përqëndrimit)	<i>CONC</i>	Kufizohet fraksioni i aktiveve që mbahet nga një numër i caktuar huamarrësish.
<i>Limits on Foreign Currency Loans</i>  (Limete në kredinë në monedhë të huaj)	<i>FC</i>	Redukton luhatshmërinë e rrezikut nga ekspozimi në monedhë të huaj.
<i>Reserve Requirement Ratios</i>  (Norma mbi rezervën e detyrueshme)	<i>RR</i>	Kufizime të normës së rritjes së kredisë, që mund të përdoret për të kufizuar edhe normën e rritjes së kredisë në valutë të huaj.
<i>Limits on Domestic Currency Loans</i>  (Kufizime në kredinë në monedhën vendase)	<i>CG</i>	Kufizim i drejtpërdrejtë i normës së rritjes së kredisë.
<i>Levy/tax on financial institution</i>  (Taksa mbi institucionet financiare)	<i>Tax</i>	Taksa mbi të ardhurat e institucioneve financiare.
<i>FX and/or Countercyclical Reserve Requirements</i> (Kërkesa kundërciklike mbi rezervën e detyrueshme)	<i>RR_REV</i>	Vendosjen e kufijve mbi normën e rritjes së kredisë në monedhë të huaj si dhe masat kundërciklike mbi kërkesat për rezervë.

Burimi: Cerutti et al, (2015).

